

GAZETA UNIVERSITARE

UNIVERSITETI I TETOVËS
SEMESTRI DIMËROR 2018 - 2019





UNIVERSITETI YNË
ARDHMËRIA JONË

GAZETA UNIVERSITARE

UNIVERSITETI I TETOVËS
SEMESTRI DIMËROR 2018 - 2019

Universiteti i Tetovës
Rruga e Ilindenit pn, 1200 Tetovë, Republika e Maqedonisë
Tel: +389 44 356 500
Fax: +389 44 334 222
e-mail: international@unite.edu.mk

Botues: Universiteti i Tetovës

Rektor: Prof.Dr.Vullnet Ameti

Prorektor për arsim: Prof. Dr. Reshat Qahili

Prorektor për bashkëpunim ndërkombëtar: Prof. Dr. Arbër Çeliku

Prorektor për financa: Prof. Dr. Alifeta Selimi

Prorektor për shkencë: Prof. Dr. Hazir Pollozhani

Sekretar i përgjithshëm: Jur. dipl. Adem Beadini

Përgatiti: Zyra për informim

Përgjegjës: Selam Sulejmani

Gazetarë: Hamit Hajrullai, Ismet Jonuzi-Krosi, Adrijana Velija, Miftar Emini

Lektorë: Abdulla Mehmeti, Nertila Sinani

Përkthyes të gjuhës angleze: Bashkim Halili, Hatixhe Halimi

Faqosja dhe dizajni: Salajdin Salihi

Fotograf: Dritan Abdiji



NË UT U SHËNUA 4 KORRIKU, DITA E PAVARËSISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

5.7.2018. Parlamenti Studentor i Universitetit të Tetovës, në bashkëpunim me Fakultetin e Kulturës Fizike të Universitetit tonë, sot organizuan disa aktivitete sportive, për nder të 242-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kryetarja e Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, zonjusha Donika Kamberi tha se përmes këtyre aktiviteteve sportive edhe Universiteti i Tetovës u bashkëngjitet festimeve për nder të 4 Korrikut, Ditës së Pavarësisë së SHBA-ve, aleatëve më besnikë të popullit shqiptar. “Parlamenti Studentor, në bashkëpunim me Fakultetin e Kulturës Fizike, menduan që këtë ditë ta festojnë në mënyrë të veçantë, gjegjësisht të organizojnë një lojë sportive në beach volley për nder të kësaj dite. Vlen të theksohet fakti që UT më mirë se askush tjetër i është përshtatur konceptit “bulding bridge” apo “ndërtimi i urave” në të cilin faktori ndërkombëtar është thirrur gjithmonë” tha

Donika Kamberi, kryetare e Parlamentit Studentor. Profesoresha e Fakultetit të Kulturës Fizike, Doc. Dr. Laureta Abazi, tha se në çdo përvjetor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës studentët luajnë lojëra të ndryshme, ndërsa këtë vit ata kanë përzgjedhur që të zhvillojnë disa ndeshje në beach volley. “Fakulteti i Kulturës Fizike, ashtu si vitin e kaluar edhe sivjet mori përsipër që të bëjë aktivitete sportive për Pavarësinë e Amerikës. Këto aktivitete ndër vite i kemi realizuar në terrenet e hapura të Universitetit, të cilat i kemi në dispozicion. Për dallim nga vitet e kaluara, kur kemi realizuar ndeshje në futboll të vogël dhe në basketboll, këtë vit organizuam ndeshje në beach volley” theksoi Doc. Dr. Laureta Abazi. Në lojërat e beach volleyt morën pjesë dy ekipe të vajzave dhe dy të meshkujve, ndërsa për pjesëmarrësit në këto gara u ndanë edhe certifikata dhe trofe.



REKTORI I UT-SË PROF. DR. VULLNET AMETI: ADEM DEMAÇI AUTORITETI MONUMENTAL I KOMBIT SHQIPTAR, SENDËRTUESI I PAVARËSISË SË KOSOVËS

29.7.2018. Me marrjen e lajmit të hidhur, kumtit për ndarjen nga jeta të atdhetarit, patriotit, veprimtarit të çështjes shqiptare Adem Demaçit, më lejoni që në emër të Universitetit të Tetovës, t'ju shpreh ngushëllimet vëlazërore institucioneve të Republikës së Kosovës, presidencës, qeverisë, kuvendit, Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Universitetit të Prishtinës, institucioneve arsimore – shkencore për të cilat Baca Adem sakrifkoi deri në vetëmohim, familjes së nderuar Demaçi, bashkëpunëtorëve, miqve dhe bashkëkombësve tanë.

Adem Demaçi, humanisti dhe sendërtuesi i ideve universale demokratike, do të kujtohet nga mbarë kombi për sakrificat sublime për arsimin, kulturën dhe shkencën shqiptare, do të mbetet përjetësisht në kujtesën tonë kolektive si simboli i sakrificave mbinjerëzore nën persekutimin komunist, intelektual vizionar e qytetari

fisnik, që gjithë jetën dhe veprimtarinë e tij e vendosi në shërbim të idealeve të mëdha për kauzën tonë kombëtare. Si atdhetar i rangut më të lartë, ai do të mbetet një personalitet i rrallë dhe i jashtëzakonshëm, me virtyte të larta morale dhe njerëzore. Roli dhe rëndësia historike e tij është përjetësuar në historinë më të re të popullit shqiptar.

Vepra dhe autoriteti monumental, ka në themele dashurinë për atdhe dhe bashkim kombëtar, gatishmërinë për t'u flijuar dhe përpjekjet titanike për liri.

Qoftë i përjetshëm kujtimi për simbolin e rezistencës kombëtare, Nderin e kombit – Adem Demaçin.

Prof. Dr. Vullnet Ameti

Rektor i Universitetit të Tetovës



NË UNIVERSITETIN E TETOVËS FILLOI AFATI I PARË I REGJISTRIMIT

27.8.2018. Në Universitetin e Tetovës, sot filloi procesi i regjistrimit të studentëve të rinj për vitin akademik 2018/2019. Prorektori për Arsim në Universitetin e Tetovës, Prof. Dr. Reshat Qahili tha se këtë vit UT në të gjitha 13 njësitë akademike do të pranojë mbi 3300 studentë të rinj. “Nga dita e sotme e deri ditën e premte në Universitetin e Tetovës do të organizohet afati i parë i regjistrimit të studentëve. Sipas konkursit të shpallur për regjistrimin e studentëve të rinj, për këtë vit akademik, parashihet që në 60 programet studimore, përkatësisht në 13 fakultete, të regjistrohen mbi 3300 studentë të rinj” – tha Prof. Dr. Reshat Qahili.

Ai po ashtu shtoi se këtë vit është aplikuar edhe sistemi online për regjistrim. “Dua të theksoj se për herë të parë këtë vit e kemi aplikuar edhe sistemin



online të regjistrimit dhe në bazë të evidencës që kemi ne si Universitet jemi mjaft të kënaqur me interesimin që kanë treguar deri më tani maturantët e kësaj gjenerate. Rezultatet preliminare të afatit të parë të regjistrimit do të shpallen ditën e hënë, pra

javën që vjen, më 3 shtator 2018” u shpreh Prorektori për Arsim i UT-së, Prof. Dr. Reshat Qahili.

Afati i parë i regjistrimit do të realizohet nga dita e sotme (27. 8.2018) deri më 31 gusht. Pas përmbylljes së afatit të parë, bazuar në konkursin e shpallur për regjistrim, Universiteti i Tetovës, për të gjitha vendet e paplotësuara nëpër programet studimore të 13 fakulteteve, do ta organizojë edhe afatin e dytë të regjistrimit, i cili është paraparë të realizohet nga 12 deri më 14 shtator.



NË UT PREJ 11 DERI MË 14 SHTATOR DO TË ZHVILLOHET AFATI I DYTË I REGJISTRIMIT

10.9.2018. Në Universitetin e Tetovës, prej 11 deri më 14 shtator do të zhvillohet afati i dytë i regjistrimit të studentëve të rinj për vitin akademik 2018/2019. Pas përfundimit me sukses të afatit të parë, Universiteti i Tetovës, ka shpallur konkurs për plotësimin e vendeve të lira në programet studimore të 13 fakulteteve.

Sipas konkursit të shpallur për realizimin e afatit të dytë për regjistrimin e studentëve të rinj, aplikimi, seleksionimi, rangimi dhe regjistrimi i kandidatëve në kategoritë e caktuara në afatin e dytë dhe të tretë do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Konkursin për regjistrim të studentëve në ciklin e parë të studimeve në Universitetin e Tetovës. Kandidatët të cilët arrijnë më pak se 40 pikë nga numri i përgjithshëm i pikëve, do të pranohen vetëm nëse mbeten vende të lira në kategoritë e caktuara me konkurs, për të cilët do të vendosë komisioni qendror. Kandidatët të cilët do të aplikojnë për regjistrim, fillimisht duhet ta plotësojnë formularin online në ueb faqen e Universitetit: www.unite.edu.mk.

Po ashtu, kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente: Fletaplikimin (merret në administratë gjatë dorëzimit të dokumenteve); Dëftesat origjinale nga shkollimi i mesëm; Diplomën për kryerjen e shkollës së mesme; Certifikatën nga libri amë i të lindurve; si dhe Certifikatën e nënshtetësisë.





NË UT U PROMOVUA LIBRI NYJET MULTIETNIKE MAQEDONASE – BETEJA PËR NJË OSE MË TEPËR SHOQËRI

19.9.2018. Në Universitetin e Tetovës sot u bë promovimi i librit “Nyjet multietnike maqedonase – beteja për një ose më tepër shoqëri” i autorit Prof. Dr. Petar Atanasov, aktualisht zëvendësministër i Arsimit dhe Shkencës i Republikës së Maqedonisë. Ky libër është rezultat i punës shumëvjeçare hulumtuese në lëmin e sociologjisë, etnicitetit, grupeve etnike dhe modeleve multikulturore të bashkekzistimit, më së shpeshti për rastin e Republikës së Maqedonisë. Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Arbër Çeliku, tha se tema që ka trajtuar autori është shumë aktuale pasi që vetë Maqedonia është një vend i theksuar shumetnik. “Në vendin tonë për shekuj me radhë kanë jetuar bashkërisht maqedonasit, shqiptarët, turqit, serbët, bullgarët, romët, vllahët. Ne vërtet flasim gjuhë të ndryshme, mbase edhe kemi kultivuar nuanca të ndryshme kulturore dhe jetësore, por në thelb, ndajmë një korpus të përbashkët vlerash njerëzore, të cilin vetëm se, në rrethanat e sotme të kthesave historike për të gjithë ne, mund të avancojmë edhe më tepër në aleancën e madhe të qytetërimit, shkencës,

dashurisë, paqes dhe tolerancës, e cila njihet me emërtimin shoqëri perëndimore” – tha Prof. Dr. Arbër Çeliku.

Autori i librit, Prof. Dr. Petar Atanasov, tha se ky libër ka për qëllim përkujtimin e argumentimeve në lidhje me modelin maqedonas të multikulturalizmit. “Në këtë drejtim është bërë një përzgjedhje punimesh të publikuara në dekadën e kaluar, të lidhura me elementet kryesore të modelit, me kontestualizimin e tyre dhe theksimin e vështirësive si dhe zgjedhjet eventuale për ardhmërinë e shoqërisë. Ato janë shkrime të cilat në detaje tregojnë se ç’ndodhte pas Marrëveshjes së Ohrit, probleme të ndërlydhura me modelin multietnik maqedonas, me faktorët që ndikojnë në dezintegrimin shoqëror, raportet me të dhëna për përkatësinë e identitetit kombëtar dhe kulturor, për mundësitë që në Maqedoni të ndërtohet demokraci multietnike” – u shpreh autori Prof. Dr. Petar Atanasov.

Për librin në fjalë folën edhe promotorët e tij, Prof. Dr. Gjylmysere Kasapi dhe Prof. Dr. Rubin Zeman. Ata thanë se ky libër vjen para lexuesit në kohën kur



në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë përsëri rishikohen disa nga këto çështje, sidomos debate për përdorimin e gjuhës të bashkësive. Libri “Ny-

jet multietnike maqedonase – beteja për një ose më tepër shoqëri” është botuar në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze.

NË UT U DEBATUA PËR BASHKËPUNIMIN NDËRMJET INSTITUCIONEVE TË LARTA ARSIMORE DHE ORGANIZATAVE JOQEVERITARE NË RITJEN E NUMRIT TË MOBILITETEVE TË STUDENTËVE ME NEVOJA TË POSAÇME

19. 9. 2018. Agjencioni nacional për programe evropiane arsimore dhe mobilitet, sot, në hapësirat e Universitetit të Tetovës organizoi një tryezë të rrumbullakët më temë “Përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të larta arsimore dhe organizatave joqeveritare në rritjen e numrit të mobiliteteve të studentëve me nevoja të posaçme dhe me më pak mundësi”.

Sipas Astrit Rexhepit, përfaqësuesit të Agjencionit nacional për programe evropiane arsimore dhe mobilitet, i vetmi qëllim i kësaj tryeze të rrumbullakët ka qenë që të ngritet numri i mobiliteteve të studentëve, të cilët janë në programin Erasmus +. “Si rezultat i kësaj ngjarjeje duhet që në të ardhmen të rritet numri i studentëve, të cilët janë me nevoja të posaçme dhe me më pak mundësi që të jenë pjesë e mobiliteteve të Erasmus +” - tha Astrit Rexhepi.

Nga ana tjetër Prof. Dr. Buniamin Memedi, Prodekan për Arsim në Fakultetin Pedagogjik, e përshëndeti këtë iniciativë për bashkëpunimin ndërmjet organizatave joqeveritare dhe Universitetit tonë edhe pse si praktikë ajo ka ekzistuar gjithmonë. “Ne gjith-



monë e kemi aplikuar këtë, sidomos me studentët e edukimit special, por jo vetëm. Ne kemi pasur studentë që kanë bashkëpunuar me organizatat joqeveritare, por edhe që kanë qenë pjesë e programit Erasmus +. Me këtë vetëm se përforcohet një bashkëpunim, një mirëkuptim dhe mirëbesim i praktikave të mira”, theksoi Prof. Dr. Buniamin Memedi. Panelistët e kësaj tryeze të rrumbullakët diskutuan edhe për rolin e institucioneve të larta arsimore në rritjen e numrit të mobiliteteve për këtë kategori studentësh.



SEMINARI XII NDËRKOMBËTAR I ALBANOLOGJISË I ZHVILLOI PUNIMET ME TEMË SKËNDERBEU MES HISTORISË DHE LETËRSISË

27.9.2018. Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë ishte tema boshte e Seminarit XII Ndërkombëtar të Albanologjisë që i zhvilloi punimet sot në Universitetin e Tetovës. Ky seminar tani më është bërë një qendër e rëndësishme e studimit të gjuhës, letërsisë, historisë dhe etnokulturës shqiptare pasi që vite me radhë në hapësirat e Universitetit tonë tubon një numër të madh studiuesish shkencorë të fushave eminente nga vendi dhe rajoni, si dhe shumë profesorë e studentë.

Punimet e seminarit i shpalli të hapura Prorektori

për Arsim i Universitetit të Tetovës Prof. Dr. Reshat Qahili. Ai tha se ky seminar i paraprin fillimit të vitit të ri akademik 2018/2019 dhe i njëjti organizohet në Vitin Mbarëkombëtar të Skënderbeut, kryeheroit të kombit tonë. “Bazuar në rëndësinë historike që ka viti 2018 për shqiptarët kudo që jetojnë e veprojnë, në qendër të veprimtarisë së edicionit të dymbëdhjetë me radhë, do të jetë tema boshte: Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë. Përmes sesioneve të veçanta, Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë do të evidentojë problematikat e

ndryshme e të shumëllojshme nga lëmi i gjuhësisë, letërsisë, historisë, etnokulturës dhe medias shqiptare. Ky takim shkencor i albanologëve nga vendi ynë dhe më gjerë, synon jo thjesht t'i tubojë specialistët e sesioneve të lartpërmendura për t'i shprehur pikëpamjet e tyre rreth problematikave të ndryshme, me të cilat përballet shoqëria shqiptare, por i fton studiuesit të pozicionohen shkencërisht dhe të japin kontributin e tyre për çështjet konkrete, të evidentuara tashmë në përdorimin e përditshëm, të folur e të shkruar të gjuhës shqipe, të nxjerrë në pah vlerat e letërsisë shqiptare, t'i afirmojë dhe t'i mbrojnë figurat historike të kombit shqiptar” tha Prof. Dr. Reshat Qahili.

Drejtori i Seminarit të Albanologjisë, Prof. Dr. Salajdin Salju, para pjesëmarrësve tha se në këtë seminar, krahas temës qendrore, do të diskutohet edhe për tema të tjera nga gjuhësia, letërsia, historia, etnokultura apo sfera e medias. “Do të flitet për mundësinë e digjitalizimit të trashëgimisë sonë kulturore, ashtu sikurse veprojnë kombet e qytetëruara, që kanë kujdes ndaj kujtesës. Do të flitet për përplasjen ndërmjet botës së Gutenbergut dhe botës digjitale, si dhe për traumat që na për-

cjellin në këtë meskohë. Gjithashtu, në kuadër të seminarit të sivjetëm, e promovojmë veprën kapitale, siç është “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, i profesorit të respektuar, të ndjerit Kolec Topalli, një mendje e bukur e botës kulturore shqiptare. Në kuadër të seminarit e promovojmë edhe numrin më të ri të revistës ” Albanologjia”, një nga shumë revista shkencore që mbajnë logon e Universitetit të Tetovës. Kjo revistë që sjell studime nga gjuhësia, letërsia, historia, etnokultura dhe mediat, është një kontribut yni modest për kulturën tonë” – theksoi Prof. Dr. Salajdin Salju.

Në kuadër të hapjes solemne të Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë u promovua “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, i autorit tashmë të ndjerë akademik Kolec Topalli. Mbi rëndësinë dhe përmbajtjen e kësaj vepre foli drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë Prof. Dr. Valter Memishaj. “Jam i nderuar që sot në Universitetin e Tetovës po çel seancën paraqitëse për veprën “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, hartuar nga akademik Kolec Topalli. Ka dy veçanti në këtë paraqitje: e para është se promovohet jashtë kufijve të Shqipërisë politike, dhe për këtë, në emër të





institucionit që unë drejtoj falënderoj gjithë organizatorët e veprimtarisë së seminarit dhe veçanërisht autoritetin drejtues të Universitetit, Rektorin Prof. Dr. Vullnet Ameti. Së dyti, vepra po paraqitet pas largimit nga jeta të akademikut të nderuar dhe kjo veprimtari, në një mjedis kaq të ngritur, bëhet shprehëse e vlerësimit serioz e të merituar e të gjithë produktit shkencor që akademiku na la trashëgim. Kolec Topalli është marrë kryesisht me probleme të fonetikës historike dhe të etimologjisë së shqipes” shtoi mes tjerash në fjalën e tij Prof. Dr. Valter Memishaj.



Ndërsa, shefi i katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Tetovës Prof. Dr. Berton Sulejmani duke folur për veprën e akademik Kolec Topallit tha se ai është një personalitet i shquar i shkencave albanologjike të kohës sonë dhe se me rezultatet e punës që ka lënë, shtrihen në fusha të ndryshme hulumtimi të historisë së gjuhës shqipe. “Ai e përmbylli veprimtarinë e tij shkencore me një sintezë të gjerë për historinë fonetike, për historinë gramatikore, për historinë e leksikut, siç është “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe” i cili sapo ka





dalë e, për të cilin po flasim dhe ne sot këtu. Madje, do të kisha thënë se janë të paktë studiuesit e llojit të tij që në një jetë njeriu të rrumbullakojnë një sintezë të tillë siç ka pasur fatin profesor Topalli. Një përvojë kaq e madhe dhe e ngjeshur jetësore e hulumtuese do t'i mungojë gjatë shkencës sonë” – deklaroi Prof. Dr. Berton Sulejmani.

Ndërsa Prof. Dr. Anila Omari nga Qendra e Studimeve Albanologjike në Tiranë, deklaroi se “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe” i profesor Kolec Topallit është vepra e tij e fundit madhore, e cila e kurorëzoi përvojën e një jete kushtuar hulumtimit shkencor në fushën e gjuhës shqipe dhe historisë së

saj. “Studimet për historinë e gjuhës shqipe profesor Koleci i nisi që në vitet e 70’ dhe rezultatet e para të kësaj pune panë dritën e botimit në të vetmen revistë shkencore të Institutit të Gjuhësisë “Studime Filologjike.” – shtoi Prof. Dr. Anila Omari.

Kurse Prof. Dr. Begzat Baliu nga Universiteti i Prishtinës potencoi se, Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe i profesor Kolecit mbetet një nga sintezat më të mëdha dhe një nga korpuset më të thella sintetike të shqipes. “Vepra e profesor Kolec Topallit vjen si një vazhdimësi e traditës së studimeve etimologjike të shqipes, të cilat për fatin e mirë të saj, metodologjikisht dhe konceptualisht përbën në vete edhe arritjet më të mira jo vetëm të zhvillimeve të brendshme të saj, po edhe të shkollës evropiane përgjithësisht” – nënvizoi mes tjerash Prof. Dr. Begzat Baliu.

Në këtë aktivitet drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë Prof. Dr. Valter Memishaj ia dhuroi veprën “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe” të autorit akademik Kolec Topalli Rektorit të Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti.





NË UT FILLOI VITI I RI AKADEMIK 2018/2019

1.10.2018. Në Universitetin e Tetovës, sot në mënyrë festive, të gjithë së bashku, studentë e profesorë, të tubuar brenda hapësirave dhe auditorëve të Universitetit e filluan vitin e ri akademik 2018/2019. Edhe këtë vit në mënyrë simbolike u ndanë 13 indeksat e parë për studentët e rinj të regjistruar për herë të parë në Universitetin tonë, që përkon me numrin e njëjësive akademike brenda Universitetit.

Studentëve indeksat ua ndau Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti. Ai në fjalën e tij drejtuar studentëve dhe stafit akademik tha se kjo ditë është nga më të rëndësishmet për Universitetin e Tetovës, sepse sot i hapim dyert e auditorëve të 13 fakulteteve tona për studentët e rinj.

Sipas tij, kjo ditë për brucoshët, paraqet kthesën e madhe jetësore dhe fillimin e rrugëtimit për një të ardhme më të lumtur, të sigurt dhe me perspektivë. “Ne drejtuesit e Universitetit Tuaj – Universitetit të Tetovës, së bashku me pedagogët dhe punonjësit tjerë, ndihemi krenarë që nga vit në vit Universitetit tonë i bashkohen qindra të rinj nga vendi ynë dhe rajoni për t’u edukuar e arsimuar në degët e

fakulteteve që ofron ky institucion i arsimit të lartë në gjuhën shqipe. Në këtë fillim tetori, mijëra studentë të rinj i fillojnë studimet e tyre universitare, sikundër mijëra të tjerë vazhdojnë betejën e diturisë për të arritur më të mirën për ta dhe për qytetarët tanë. Oferta arsimore – shkencore e Universitetit të Tetovës, kushtet bashkëkohore të studimit, prestigji ndërkombëtar, partneriteti i përhershëm me universitetet e njohura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian, pjesëmarrja aktive në programet ndërkombëtare të arsimit të lartë, bursat për ekselentët e dhjetëra, dhjetëra lehtësime të tjera i nxitën, motivuan mijëra të rinj që përmes





sistemit online të aplikojnë e regjistrohen në programet studimore që ne ofrojmë për vitin akademik 2018 / 2019”. Përcaktimi Juaj për të ndjekur rrugën e edukimit dhe arsimimit, jo vetëm që na e forcon besimin se e ardhmja do të jetë më e mirë, por neve si drejtues institucionesh na obligon që të vijojmë përpjekjet, angazhimin intensiv në ofrimin e shërbimeve bashkëkohore gjatë realizimit të procesit mësimor-shkencor. Ne bashkërisht e kemi dëshmuar se vetëm me punë dhe profesionalizëm e kemi rritur kredibilitetin e këtij institucioni, që edhe në kohët më të vështira e ka dëshmuar se reformimi shoqëror nuk bart emra apo attribute personale, por vendosmëri dhe përkushtim të palëkundur të të gjithëve – stafit akademik dhe studentëve të tij” – tha Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Po ashtu në fjalën e tij Rektori i Universitetit të

Tetovës, shtoi se ai dhe ekipi i tij mbeten të përkushtuar për arsimimin e gjeneratave të reja dhe sigurimin e një të ardhmeje më të begatë për studentët dhe familjet e tyre, në dobi të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. “Universiteti i Tetovës me pedagogët e specializuar dhe programet e shumta studimore, tanimë ofron modelin e arsimimit që shpie drejt njohjeve të reja shkencore në shërbim të zhvillimit, rritjes së kapaciteteve intelektuale dhe përgatitjen e kuadrove me përgjegjësi si qytetarë të denjë të vendit tonë. Po ashtu, ky universitet e ka dëshmuar se është i hapur për të gjithë, ka ndërtuar një mekanizëm profesional të bashkëpunimit të suksesshëm me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë edhe sektorin e biznesit vendor dhe më gjerë. Besoj fuqishëm se kjo praktikë do të vazhdojë të funksionojë edhe në të ardhmen dhe në këtë mënyrë prosperiteti dhe avancimi arsimor dhe edukativ do të arrihen më lehtësisht. Në fund, Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen tuaj në ceremoninë zyrtare të fillimit të vitit akademik 2018/2019, studentëve të rinj, profesorëve, bashkëpunëtorëve të Universitetit tonë Ju uroj një vit të mbarë, të suksesshëm dhe me fitore të reja në këtë vit historik – Vitin Mbarëkombëtar të Skënderbeut” – theksoi mes tjerash Rektori Prof. Dr. Vullnet Ameti Me rastin e fillimit të vitit akademik në Universitetin e Tetovës para studentëve të rinj performoi artistin e popullit Selami Kolonja.



REKTORI I UT-SË PROF. DR. VULLNET AMETI PRITI NË TAKIM ATLETIN BERAT MUSTAFA, PËRFAQËSUESIN E MAQEDONISË NË LOJËRAT OLIMPIKE

3.10.2018. Rektori i UT-së Prof. Dr. Vullnet Ameti priti në takim atletin Berat Mustafa bashkë me trajnerin e tij Prof. Dr. Bexhet Toçi, të cilët do ta përfaqësojnë Maqedoninë në lojërat olimpike për të rinj që do të mbahen në Buenos Aires të Argjentinës.

Në takim, Rektori i UT-së i uroi ata për punën që kanë bërë deri më tani, duke shpresuar se edhe në

garat në vrapim prej 400 metrash, të cilat do të zhvillohen në kuadër të lojërave olimpike për të rinj, në Buenos Aires të Argjentinës të arrijnë rezultate sa më pozitive. “Ishte kënaqësi të pres në takim Berat Mustafën, atletin i cili do ta përfaqësojë Maqedoninë në lojërat olimpike bashkë me trajnerin e tij Prof. Dr. Bexhet Toçi, i përgëzoja për këtë arritje kaq të



madhe, pjesëmarrja e Beratit në këto gara jo vetëm që nderon klubin e atletikës, por edhe Universitetin tonë në veçanti pasi që kemi arritur në mesin tonë të nxjerrim kuadro të mirëfillta. Ne mbështetjen tonë asnjëherë nuk e kursejmë për të gjithë sportistët tanë dhe studentët në përgjithësi” – u shpreh Prof. Dr. Vullnet Ameti, Rektori i Universitetit të Tetovës. Trajneri i Klubit të Atletikës Studenti të UT-së, Prof. Dr. Bexhet Toci, e falënderoi Rektorin Prof. Dr. Vullnet Ametit për përkrahjen që çdo herë i ka dhënë klubit. “Klubi kryesisht është i përbërë nga studentët të Universitetit të Tetovës dhe nxënës së shkollave të mesme të qytetit të Tetovës. Klubi mbështetet dhe financohet nga Universiteti dhe falë ndihmës që na ka dhënë Rektori Prof. Dr. Vullnet Ameti ne sot kemi arritur të marrim pjesë në lojërat olimpike për të rinj që do të mbahen në Argentinë. Shpresojmë që atje atleti Berat Mustafa të ngjitet sa më lart” – deklaroi Prof. Dr. Bexhet Toci.

Atleti Berat Mustafa i falënderoi të gjithë ata të cilët i kanë dhënë mbështetje gjatë periudhës së përgatitjes. “Çdo gjë arrihet me punë dhe ne falë an-



gazhimit tonë ia arritëm që t’ia dalim me sukses. Dua të falënderoj trajnerin tim për përkushtimin e tij që ka treguar ndaj meje, por edhe Rektorin Prof. Dr. Vullnet Ameti, i cili asnjëherë nuk e ka kursyer mbështetjen e tij ndaj nesh.” – shtoi Berat Mustafa. Lojërat olimpike për të rinj do të fillojnë nga 3 tetori dhe do të përfundojnë më 19 tetor.

DEKANI I FAKULTETIT TË FILOLOGJISË, PROF. DR. FATMIR SULEJMANI MORI PJESË NË KONFERENCËN E ORGANIZUAR NGA AKADEMITË SHQIPTARE TË SHKENCAVE

11.10.2018. Më 11 tetor 2018, në Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë organizuan konferencën shkencore me titull: “Romani shqiptar, fillimi i shekullit XXI”, ku morën pjesë studiues të shquar nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës. Në konferencë mori pjesë edhe dekani i Fakultetit të Filologjisë – Prof. Dr. Fatmir Sulejmani nga Universiteti i Tetovës, i cili u prezantua me studimin: “Shpirti shqiptar në petkun e tjetrit”, që ka të bëjë me romanin “Polifonistët”, njëri prej veprave të fundit të mjeshtrit të prozës narrative, Luan Starovës. Në këtë libër trajtohet tema mitologjike e etnogenezës dhe etnopsikologjisë shqiptare dhe ka për hero këngën polifonike – këtë kod të brendshëm të memories së pavdekshme kombëtare. Studimi në fjalë u prit mirë nga studiuesit tjerë dhe nga auditori i zgjedhur, që ndoqi punimet e kësaj ngjarjeje të rëndësishme shkencore.



Përndryshe, kjo ishte konferenca e njëmbëdhjetë e dy akademive shqiptare të shkencave në të cilat merr pjesë aktive Prof. Dr. Fatmir Sulejmani.



NË UT U SHËNUA DITA BOTËRORE E USHQIMIT

17. 10. 2018 Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit i Universitetit të Tetovës, me aktivitete të ndryshme e shënoi 16 tetorin, Ditën Botërore të Ushqimit. Profesorët dhe studentët e këtij fakulteti, përmes këtij manifestimi, përcollën mesazhe sensibilizuese deri te popullata që sa më shumë t'i kushtojnë rëndësi ushqimit dhe mënyrës së të ushqyerit. Dekani i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, Prof. Dr. Xhezahir Idrizi, para të pranishmëve mbajti një ligjëratë tematike kushtuar ushqimit në përgjithësi. Ai, në pika të shkurtra, foli mbi historikun e Ditës Botërore të Ushqimit dhe më pas u fokusua mbi mënyrën e të ushqyerit, kequshqyerjen dhe mbiushqyerjen, ndërsa theks të veçantë i kushtoi urisë në botë dhe në vendin tonë. “Sot ne e

shënojmë 16 tetorin, Ditën Botërore të Ushqimit. Kjo datë përkujtohet nga viti 1981 dhe përkujton themelimin e Organizatës Botërore të Ushqimit. Meqë shënimi i kësaj date është pjesë e studimit tonë, ne e pamë të arsyeshme që të organizojmë një ligjëratë të shkurtër tematike lidhur me ushqimin në përgjithësi si dhe t'i prezantojmë produktet ushqimore të prodhuara në kushte laboratorit nga studentët e fakultetit tonë të vitit të dytë dhe të tretë. Këtë ditë e përkujtojmë për të ndërgjegjësuar opinionin publik mbi problemet e ushqimit në botë, por edhe në vend. Po t'i shohim statistikat e ndryshme, sot në botë vdesin mesatarisht 6 milion njerëz si rezultat i mosushqyerjes, kurse 20 përqind e vdekjeve të fëmijëve në moshë 5-vjeçare është si rezultat i mosushqyerjes

ose kequshqyerjes. E njëjta statistikë flet për ngjarje në rrethana të tilla edhe në Republikën e Maqedonisë. Edhe këtu mesatarisht 500 mijë njerëz brenda ditës nuk e kanë sasinë e nevojshme të ushqimit për t'i plotësuar nevojat ushqyese të tyre. Qëllimi i këtij organizimi ishte të ndërjegjësojmë opinionin publik në lidhje me njerëzit, të cilët kanë nevojë për përkrahje me ushqim, po ashtu edhe për planifikimin e politikave shtetërore në lidhje me këtë kategori të njerëzve” – tha Prof. Dr. Xhezahir Idrizi, dekan i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit.

Gjatë prezantimit dhe degustimit të produkteve ushqimore të përgatitura nga profesorët dhe studentët e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit ishte i pranishëm edhe Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, bashkë me ekipin e tij, dekanë të fakulteteve, profesorë dhe studentë. Në përmbyllje të këtij aktiviteti, dekani i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, Prof.



Dr. Xhezahir Idrizi, konstatoi se për të konsumuar ushqim të shëndetshëm duhet të ndërjegjësohet politikbërja në nivel global, në lidhje me politikat ushqimore si dhe të shfrytëzohen burimet natyrore pa keqpërdorime, duke mbjellë bimë në përputhje me kushtet mjedisore të zonës. Sipas tij, ushqimi duhet të shfrytëzohet në mënyrë racionale si dhe të ndërjegjësohen bizneset që ushqimet e tepërta t'i shpërndajnë për njerëzit në nevojë, ndërsa institucionet qendrore dhe ato lokale të hapin kuzhina edhe kuzhina sociale.



www.unite.edu.mk



UT ORGANIZOI DY KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE KUSHTUAR ZHVILLIMIT EKONOMIK, SHTETIT TË SË DREJTËS DHE SHOQËRISË CIVILE

21.10.2018. “Zhvillimi ekonomik si parakusht për integrimin në Bashkimin Evropian”, si dhe “Shteti i së drejtës dhe shoqëria civile” ishin temat boshte të dy konferencave shkencore ndërkombëtare, që i zhvilluan punimet në Universitetin e Tetovës.

Studiuesit shkencorë nga lëmenjtë e ekonomisë, biznesit, turizmit, administratës etj, në konferencën VI ndërkombëtare që u organizua nga Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Administratës së Biznesit prezantuan punimet e tyre shkencore mbi zhvillimin ekonomik në vendin tonë, rritjen e tregtisë dhe investimeve të huaja si dhe mbi përfitimet që vendi ynë do të ketë me anëtarësimin në strukturat euro-atlantike. Ndërsa studiuesit nga fushat e drejtësisë, medias, shoqërisë civile etj., në konferencën V ndërkombëtare, që e organizoi Fakulteti Juridik i Universitetit të Tetovës në bashkëpunim me

Fakultetin Juridik “Justiniani i Parë” i Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” diskutuan për reformat në sistemin e drejtësisë, rolin e medias dhe shoqërisë civile.

Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, në hapjen e punimeve të konferencave, u shpreh se temat që trajtojnë këto konferenca janë



shumë aktuale pasi që të gjithë jemi dëshmitarë të zhvillimeve të mëdha që ndodhin në vendin tonë, debateve të pafundme në raport me ngjarjet që zhvillohen, pritshmërive të publikut për të ardhmen e vendit dhe orientimin e tij drejt realizimit të aspiratave progresive. Sipas tij, universitetet, si institucione më përfaqësuese të shoqërisë, sigurisht se nuk mund të qëndrojnë indiferente përballë këtyre situatave, aq më tepër që kanë kompetencë profesionale, përgatitjen e duhur, kuadrot e nevojshme dhe vizionin e qartë për të trajtuar çështje nga më të ndryshmet. “Besoj se, bordet drejtuese të konferencave respektive, me përzgjedhjen e këtyre temave aktuale, do të debatojnë në mënyrë shkencore gjithë problematikën me të cilën ndeshet sot shteti i së drejtës dhe alternativat e përshpejtimit të forcimit të ekonomisë. Po t’i referohemi temës së parë, vlerësojmë se një rol të rëndësishëm në nxitjen e institucioneve në respektimin dhe zbatimin e ligjeve, realizimin e angazhimeve të tyre, thellimin e mëtejshëm të reformave institucionale që nxisin pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin, i takon shoqërisë civile. Por, kjo ndodh në shtetet me demokraci funksionale, ku respektohet e drejta e qytetarëve dhe shoqërisë civile për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse, qasjen në informacionin publik, të drejtën për të propozuar ligje, të drejtën e lirisë së fjalës dhe shumë të drejta të tjera që garantohen me kushtetutë. Edhe përkundër mungesës së standardeve të lartpërmendura, në vendin tonë dhe jo vetëm, shoqëria civile ka dhënë kontributin e saj në avancimin e shumë proceseve, si në sektorin e ofrimit të shërbimeve, mobilizimin e komuniteteve lokale, mbrojtjen e grupeve në nevojë, transparencën e institucioneve dhe forcimin e kapaciteteve të tyre” – theksoi Prof. Dr. Vullnet Ameti. Ai më tej shtoi se komuniteti ndërkombëtar bën thirrje për reforma të thella, sidomos në lëmin e



drejtësisë, reformimi i së cilës do të kishte efekte të drejtpërdrejta edhe në sektorë të tjerë me rëndësi, përfshirë këtu edhe shoqërinë civile. “Sa i takon zhvillimit ekonomik edhe këtu kërkohen rregulla që konkurrenca ekonomike të realizohet në kushte të barabarta, brenda një sistemi konkurrues të denjë për një shoqëri demokratike. Vendi ynë dhe fqinjët tanë në rajonin e Ballkanit perëndimor janë orientuar drejt integritimeve euro-atlantike, por për t’i përqafuar vlerat evropiane, demokracinë e konsoliduar dhe shtetin e së drejtës, duhet që të gjithë të angazhohemi fort, të japim kontributin tonë si shoqëri civile, si institucione arsimore dhe si shoqëri përparimtare e shekullit 21” – tha mes tjerash Rektori i UT-së, Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Ministri për investime të huaja në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Prof. Dr. Bardhyl Dauti, tha se opsioni më i qëndrueshëm dhe përcaktimi më i drejtë i Maqedonisë mbetet integrimi në Bashkimin Evropian dhe NATO. “Integrimet euro – atlantike janë përcaktim strategjik i Republikës së Maqedonisë, si garanci për sigurinë, paqen, stabilitetin dhe zhvillimin. Integrimi në BE do të thotë treg më i madh, konkurrencë më e madhe, më shumë mundësi si dhe më shumë siguri për të gjithë qytetarët. Për vende si Maqedonia, nuk është e vlefshme pyetja,





nëse duhet të integrohet në BE dhe NATO, por si të përshpejtohet ky proces” – u shpreh ministri Prof. Dr. Bardhyl Dauti.

Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore theks të veçantë i kushtoi raportit të indeksit global të konkurrueshmërisë, që u publikua ditë më parë nga Forumi Ekonomik Botëror, në të cilin theksohet se gjendja momentale në sferën e ekonomisë, por edhe në sferat tjera nuk është e volitshme në Republikën e Maqedonisë. “Fakt tjetër shqetësues për këtë raport është se institucionet e vendit janë ranguar në vendin e 85-të, gjë që është një tregues se biznesi has në vështirësi për shkak të ngecjes institucionale. Prandaj ne si Odë Ekonomike vlerësojmë se për të arritur qëllimet tona si shtet dhe si sektor i biznesit, duhet që edhe politikbërësit të ndërmarrin iniciativa konkrete për zhvillimin dhe përparimin e shtetit për të arritur në nivelin e shteteve anëtare të BE-së” – deklaroi z. Nebi Hoxha.

Mbi rëndësinë dhe tematikat e sesioneve të këtyre konferencave, vlerësimet e tyre i dhanë edhe dekani i Fakultetit Juridik, Prof. Dr. Qebir Avziu, dekani i Fakultetit Ekonomik, Prof. Dr. Raman Ismaili si dhe dekani i Fakultetit të Administratës së Biznesit, Prof. Dr. Naser Rahimi. Ata u shprehën mjaft të kënaqur edhe me bordet drejtuese të revistave shkencore ndërkombëtare, që botohen nga fakultetet respektive të Universitetit tonë, ajo e Fakultetit Ekonomik, “Vizioni Ekonomik” që sot e përuroi numrin e 5-të me radhë dhe revista shkencore e Fakultetit Juridik “Justicia”, e cila e promovoi numrin e 4-t.

Organizimin e këtyre konferencave në emër të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” e përshëndeti prodekanja e Fakultetit Juridik “Justiniani i Parë”, Prof. Dr. Sc. Irena Rajčinovska Pandeva.



SHEFI I UNICEF E VIZITOI UNIVER

24.10.2018. Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, sot në kabinetin e tij e priti në takim pune përfaqësuesin nacional të UNICEF-it për Maqedoninë, z. Benjamin Perks. Përveç takimit me Rektoren e Universitetit tonë, ai zhvilloi një takim të përbashkët edhe me Prorektorin për Shkencë, Prof. Dr. Hazir Pollozhani, dekanin e Fakultetit Filozofik, Prof. Dr. Ibish Kadriu, atë të Fakultetit Pedagogjik, Prof. Dr. Fadbi Osmani dhe dekanin e Fakultetit Juridik Prof. Dr. Qebir Avziu. Në këtë takim bashkëbiseduesit diskutuan për një bashkëpunim mes UNICEF-it dhe Universitetit të Tetovës në të ardhmen, me qëllim realizimin e disa projekteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe të drejtat e tyre.

Shefi i UNICEF-it në Maqedoni, z. Benjamin Perks, pas takimeve që zhvilloi me drejtuesit e Universitetit të Tetovës para stafit pedagogjik, studentëve dhe disa nxënësve të shkollës fillore “Fan Noli” nga fshati Trebosh, mbajti një ligjëratë me temë: “Ndikimi i dhunës dhe përvojat negative të fëmijërisë



UNICEF-IT NË MAQEDONI UNIVERSITETIN E TETOVËS

në përparimin, sigurinë dhe zhvillimin afatgjatë”. Gjatë kësaj ligjërata ai prezantoi disa statistika mbi dhunën ndaj fëmijëve, që janë zhvilluar kryesisht në Ballkanin perëndimor. “Me ftesën e stafit akademik të Universitetit të Tetovës i bëra vizitë këtij Universiteti për të mbajtur ligjërata të sotme. Fillimisht realizova një takim me Rektorin e Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, dhe me disa dekanë të fakulteteve për të diskutuar gjendjen dhe mbrojtjen e fëmijëve në vend. Më pas zhvillova një ligjërata në lidhje me dhunën. Sa i përket dhunës tek fëmijët kemi zhvilluar një hulumtim në Ballkanin perëndimor dhe statistika e përgjithshme është se një nga tre fëmijë është dhunuar fizikisht, mirëpo në vendin tuaj, në Republikën e Maqedonisë kjo përqindje është pak më e madhe. Pra, do të thotë një nga dy fëmijët është i dhunuar fizikisht. Nëse bëjmë krahasimin mes vendeve në Ballkan, dhuna fizike tek fëmijët në Maqedoni është më e madhe se në Kosovë, por është më e vogël në krahasim me Shqipërinë. Ndërsa, sa i përket mospërfilljes

së fëmijëve nga ana emocionale, është konstatuar se një nga tre fëmijët është i mospërfillur” – tha z. Benjamin Perks.

Dekani i Fakultetit Pedagogjik i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Fadbi Osmani, tha se fakulteti që ai drejton, por dhe disa fakultete tjera të Universitetit të Tetovës kanë potencialin e duhur kadrovik që të bashkëpunojnë me UNICEF-in dhe të bashkëngjiten në projektet e tyre të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna fizike. “Sot patëm një takim shumë të rëndësishëm me shefin e UNICEF-it në Republikën e Maqedonisë dhe ne e informuam atë në lidhje me aktivitetet, të cilat i ndërmarim në drejtim të mbrojtjes dhe edukimit të fëmijëve, si dhe në veçanti u ndalëm në çështjen e arsimimit dhe të përgatitjes së fëmijëve prej institucioneve parashkollore dhe përgatitjen e tyre për në shkollë. Ne e siguroam shefin e UNICEF-it se jemi të gatshëm të realizojmë disa projekte të mëdha që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe të drejtat e tyre. Këto projekte do të jenë të sponsoruara nga UNICEF-i dhe do të realizohen nga disa fakultete të Universitetit tonë, respektivisht Fakulteti Pedagogjik, Fakulteti Filozofik dhe Fakulteti Juridik. Ne si fakultete kemi potencial kadrovik që të ballafaqohemi me këto projekte që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta, sepse Fakulteti Pedagogjik tash ka edhe program studimor të veçantë kushtuar fëmijëve me nevoja të veçanta dhe përgatit kuadër për edukimin e këtyre fëmijëve” – u shpreh Prof. Dr. Fadbi Osmani.

Në shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi për vizitën e tij në Universitetin e Tetovës, Rektori ynë, Prof. Dr. Vullnet Ameti, shefit të UNICEF-it në vendin tonë, z. Benjamin Perks i ndau një dhuratë me portretin e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.



DOC. DR. FATON SHABANI MBAJTI NJË CIKËL LIGJËRATASH NË UNIVERSITETIN E MARIBORIT

29.10.2018. Profesori i Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, Doc. Dr. Faton Shabani, nga 22 deri më 26 tetor zhvilloi një cikël ligjëratah në Fakultetin Juridik të Universitetit të Mariborit. Vizita e tij në këtë Universitet u realizua në kuadër të programit Erasmus +, ndërsa ai para studentëve të ciklit të parë dhe të dytë prezantoi disa ligjërata nga fusha e së drejtës afariste.

Gjatë prezantimit të ligjëratave të tij, Doc. Dr. Faton Shabani, rëndësi të veçantë i ka kushtuar të drejtës afariste në Republikën e Maqedonisë, sfidave me të cilat përballet ajo dhe perspektivës së saj. Ai po ashtu ka ligjëruar edhe për të drejtën e shoqërive tregtare dhe rregullativën ligjore në Republikën e Maqedonisë. Studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Mariborit, gjatë prezantimit të këtyre temave, kanë shprehur interesim të madh për këto çështje juridike në Republikën e Maqedonisë, përfshirë këtu edhe reformën në sistemin e drejtësisë.

Përveç ligjëratave nga fusha e së drejtës, profesori Doc. Dr. Faton Shabani, para stafit akademik dhe studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit të

Mariborit ka prezantuar në tërësi edhe Universitetin e Tetovës, historikun e Universitetit, njësitë akademike që i posedon Universiteti ynë si dhe të gjitha aktivitetet arsimore dhe shkencore që zhvillohen në Universitetin tonë.

Gjatë qëndrimit të tij në Universitetin e Mariborit, Doc. Dr. Faton Shabani ka zhvilluar disa takime edhe me drejtuesit e këtij Universiteti. Atë e priti në një takim miqësor dekania e Fakultetit Juridik, Prof. Dr. Vesna Rijavec. Në këtë takim ata kanë biseduar mbi mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen mes Fakultetit Juridik të UT-së dhe Fakultetit Juridik të Mariborit, duke realizuar disa aktivitete të përbashkëta, të cilat do të ishin në interes të të dy fakulteteve.

Me këtë rast, ai u bëri thirrje drejtuesve të Universitetit, stafit akademik dhe studentëve që të vijnë ta vizitojnë Universitetin e Tetovës që në të ardhmen të dy universitetet të bashkëpunojnë në forma të ndryshme, si shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik, organizimin e simpoziumeve, seminareve dhe konferencave të përbashkëta shkencore etj.



NË UNIVERSITETIN E TETOVËS U PROMOVUA LIBRI “FJALORI POLITIK I BERISHËS ‘90 – ‘92”

30.10.2018. Në Universitetin e Tetovës, sot u bë promovimi i librit “Fjalori politik i Berishës ‘90 – ‘92” i autorit Alfred Lela. Libri në tërësi merret me komunikimin politik të Sali Berishës, i cili me vite e ka dominuar skenën politike në Shqipëri, si ish-president dhe ish-kryeministër i Shqipërisë për dy mandate, duke analizuar se si është vendosur gjuha e tij nga ajo e një intelektualit të angazhuar në udhëheqës politik të shtetit shqiptar për disa mandate dhe shumë vite.

Para studentëve dhe profesorëve të Fakultetit Juridik të programeve studimore të drejtësisë dhe gazetarisë të Universitetit të Tetovës, autori i librit tha se pyetja me të cilën libri merret dhe do të vërtetohet është; a ka qenë i djathtë komunikimi politik i Sali Berishës në periudhën 90 – 92? “Për arsye që janë

të dukshme dhe janë të pashmangshme, është vendi që ka z. Sali Berisha në historinë politike, në historinë e Shqipërisë pas komuniste, pas viteve 90-ta, që nga lëvizja e dhjetorit e deri në vitin 2013, kur dha dorëheqje nga partia (por siç ka thënë ai vetë jo nga politika, sepse edhe sot e kësaj dite vazhdon të jetë një politikan aktiv). Berisha ka qenë sundues në komunikim dhe rrjedhimisht i pashmangshëm. Nëse do të studiosh një udhëheqës politik shqiptar sigurisht që Sali Berisha të vjen në mend, në mos i pari, i dyti. E veçanta e parë do të thoja që është patosi në komunikim i z. Berisha, një lloj energjie fizike që ai e ka, të cilën e ka të formuluar edhe në retorikë. Këto janë gjëra që duken së jashtëmi, por unë kam dashur më shumë të zbuloj sesa të ekspozoj atë që ndërkohë shihet. Kam dashur të zbuloj atë se a flet



Sali Berisha si i djathtë dhe kjo ka qenë arsyeja që më ka çuar drejt studimit, drejt librit” – theksoi autori Alfred Lela.

Analisti dhe drejtuesi i departamentit të gazetarisë në Universitetin e Tiranës, Mark Marku, librin kush-tuar fjalorit politik të Dr. Sali Berishës, e vlerësoi si shumë të rëndësishëm, sepse merret me komunikimin politik dhe analizën e diskursit politik. “Libra të tillë mungojnë. Praktikisht studimet për komunikimin ka, por akoma nuk janë libra që përcaktojnë në një farë mënyre drejtimin e studimeve për komunikim. Unë mendoj që është shumë e rëndësishme që ne të fillojmë të studiojmë diskursin e aktorëve politikë, sepse në thelb, duke analizuar diskursin dhe duke monitoruar diskursin e tyre kemi shkuar në thelbin e politikës, sepse thelbi i politikës është fjala dhe fjala si aksion politik në këtë kuptim libri është shumë i rëndësishëm. Rëndësia është më e madhe sepse merret me një personazh shumë të rëndësishëm politik shqiptar, siç është z. Sali Berisha, merret me një fazë interesante të këtij personazhi pikërisht fazën e kalimit 90 – 92, kur diskursi i tij politik në diskursin e një intelektualit të angazhuar në ndikimin e fortë të propagandës komuniste kalon në një diskurs të një politikani të pluralizmit, të sistemit demokratik dhe kjo si dukuri është shumë e rëndësishme. Pra, ideja është se si një person brenda një kohe shumë të shkurtër brenda, dy vjetëve, kalon nga fusha intelektuale në fushën politike, prandaj bën një kalim nga një fushë ideologjike siç është e majta në fushën tjetër ideologjike siç është e djathta dhe e gjitha kjo realizohet përmes diskursit.



Kjo është e veçanta e këtij libri” – kështu e mbaroi vlerësimin e tij analisti Mark Marku.

Ndërsa zëvendësdekani i Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, profesor Agron Gjekmarkaj, librin e konsideroi absolutisht një risi në studimin e komunikimit dhe ligjërimit politik në hapësirën shqiptare. “Është libri i parë i këtij lloji, një libër që mund t’u shërbejë shumë të gjithë atyre që e kanë zgjedhje të parë bashkëjetesën me politikën dhe ligjërimit politik. Ai mund të jetë shumë interesant për të gjithë studentët e gazetarisë dhe për të gjithë ata që ushqehen politikisht çdo ditë, për të kuptuar se si ndërtohet ligjërimi politik i një lideri, në rastin konkret ligjërimi i Sali Berishës, i cili është një lider që e ka dominuar skenën politike të shtetit shqiptar, por do të thoja se e ka dominuar emocionalisht edhe skenën politike të shqiptarëve në rajonin e Ballkanit” – tha profesor Agron Gjekmarkaj.

Profesoresha universitare, ligjëruese në departamentin e gazetarisë në Universitetin e Tetovës, Prof. Dr. Aurora Ndrio – Karameti, tha se me këtë libër autori Alfred Lela do të shndërrohet në një model për studiuesit e rinj që në të ardhmen të analizojnë diskursin politik të politikanëve të tjerë. “Libri për Sali Berishën është shumë interesant për shkak se me këtë libër hyjmë në fazën kur ne si studiues fillojmë dhe i marrim në analizë, i studiojmë diskursin e politikanëve dhe nxjerrim në dritë çfarë shkon dhe çfarë nuk shkon tek ata. Çfarë ata kanë si ideologji dhe e proklamojnë dhe në këtë mënyrë ne kemi mundësi bashkë me publikun të krijojmë opinionet tona lidhur me atë se sa politikanët janë vërtet politikanë dhe nuk janë thjesht njerëz që dëshirojnë të bëjnë një aktivitet të tillë të merren me politikë, por janë njerëz që kanë pjekurinë e nevojshme intelektuale të shprehur në diskursin e tyre politik. Pra ka shumë nevojë që të analizohet diskursi politik i politikanëve dhe këtë autori i librit z. Alfred e ka bërë më së miri” – u shpreh Prof. Dr. Aurora Ndrio – Karameti.

Autori z. Alfred Lela është themelues i Politko.al dhe komentator politik në Televizionin Top Channel. Në vitin 2012 ka marrë çmimin “Teodor Keko” në gazetari, ndërsa në vitin 2013 ka botuar librin “Secilit Shqipërinë e tij”(UETPress) me të cilin e ka fituar çmimin “At Zef Pllumi” me publicistikë 2014. Ai po ashtu ka qenë drejtor i botimeve MAPO dhe për të njëjtën logo ka punuar si kryeredaktor i revistës MAPO dhe zv/ kryeredaktor i gazetës MAPO.



GJERMANIA OFRON **BURSA** PËR STUDENTËT E UT-SË

31.10.2018. Në Universitetin e Tetovës, më 30 tetor 2018, Qendra për Shërbime Studentore dhe Karrierë në bashkëpunim me Shërbimin për Shkëmbim Akademik Gjerman, DAAD (Deutscher Akademischer Austauschdienst), realizuan prezantimin e bursave gjermane për vitin akademik 2018/2019.

Përfaqësuesja e DAAD-it, Meike Graeser, fillimisht zhvilloi një takim me Prorektorin për Shkencë të Universitetit tonë, Prof. Dr. Hazir Pollozhani, dhe më pas para studentëve dhe profesorëve bëri prezantimin e disa kategorive të bursave. Sipas saj, Shërbimi për Shkëmbim Akademik Gjerman, (DAAD) këtë vit, do të ndajë bursa hulumtuese për doktorantë dhe shkencëtarë të rinj, si dhe do të organizojë qëndrim hulumtues për profesorë universitarë dhe shkencëtarë në universitetet e Gjermanisë.

Veç kësaj, do të jepen bursa për studime pasuniversitare nga të gjitha fushat shkencore, përfshirë këtu edhe bursat për studime pasuniversitare dhe të doktoraturës DAAD/OSI, si dhe bursa verore universi-

tare për kurse të gjuhës për studentë. Po ashtu zonja Meike Graeser tha se është paraparë që të organizohet edhe praktikë për studentët e huaj, të ketë vizita dhe seminare për grupe studentësh, si dhe do të ketë edhe ftesa për ish-bursistët e DAAD-it.

Drejtuesi i Qendrës për Shërbime Studentore dhe Karrierë në Universitetin e Tetovës, Shaban Arslani, apeloj deri tek profesorët dhe studentët që të aplikojnë për këto bursa pasi që janë mjaft të rëndësishme dhe shumë të nevojshme për ta. Ai tha se qendra për karrierë gjithmonë ka qenë dhe vazhdon të jetë në shërbim të studentëve duke ua lehtësuar atyre të gjitha procedurat për aplikim dhe duke i pajisur me informata shtesë kandidatët e interesuar.

Rreth afateve për aplikim dhe informatave më të detajuara të gjithë të interesuarit mund të vizitojnë edhe faqet zyrtare të DAAD-it, si: <http://www.daad.de/stipendien> dhe <http://www.daadskopje.blogspot.com>

STUDENTËT E FAKULTETIT PEDAGOGJIK TË UT-SË FILLUAN FAZËN E DYTË TË TRAJNIMEVE PËR AVANCIMIN E KOHEZIONIT SOCIAL NË MAQEDONI

31.10.2018. Në kuadër të projektit Avancimi i kohezionit social në Republikën e Maqedonisë, sot në Universitetin e Tetovës u mbajt trajnimi i radhës me studentët e Fakultetit Pedagogjik të Universitetit tonë dhe studentët e Fakultetit të Shkencave Arsimore nga Universiteti Goce Dellçev i Shtipit. Ky projekt mbështetet nga USAID-i në Maqedoni dhe implementohet nga Search for Common Ground, organizatë ndërkombëtare me seli në Washington DC.

Menaxheri i këtij projekti, z. Pajtim Saiti, tha se ky trajnim realizohet në kuadër të komponentit të parë të projektit. Në aspektin edukativ, në mes tjerash, parashihet që të realizohen trajnime për edukatorët dhe përkëdhelëset në çerdhe dhe për prindërit e fëmijëve që ndjekin çerdhen. Po ashtu për mësimdhënës të klasave të ulëta në shkollat fillore, studentë të fakulteteve publike, gjegjësisht studentë të fakulteteve pedagogjike nga pesë universitetet publike në Republikën e Maqedonisë dhe përfundon me trajnim të këshilltarëve dhe inspektorëve nga byroja për zhvillim të arsimit dhe inspektoratit shtetëror të arsimit. Trajnimi me studentët është paraparë që të realizohet në tre cikle. Ky është cikli i dytë i trajnimit dhe në këtë cikël të trajnimeve i afrojmë studentët nga fakultete të ndryshme, në rastin konkret sot mysafirë në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin Pedagogjik, janë studentët e Universitetit



Goce Dellçev nga Shtipi, pra studentët e Fakultetit të Shkencave Arsimore të këtij Universiteti” – u shpreh Pajtim Saiti.

Realizimin e këtij projekti e përshëndeti dekani i Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës Prof. Dr. Fadbi Osmani. Ai tha se trajnimet e këtilla do të jenë një ndihmesë e madhe për studentët tanë, të cilët do të përfitojnë njohuri të shumta mbi atë se si duhet në të ardhmen të ushtrojnë profesionet e tyre, qoftë si edukatorë, mësues, pedagogë e kështu me radhë.

Ndërsa prodekania e Fakultetit të Shkencave Arsimore të Universitetit “Goce Dellçev nga Shtipi, Prof. Dr. Despina Sivevska, potencoi se këto njohuri janë shumë të dobishme për studentët pasi që

u përgjigjen sfidave të një shoqërie, pasi që përmes këtyre projekteve studentët tanë do të përgatiten në mënyrë profesionale mbi atë se si të punojnë nesër me nxënësit, fëmijët etj.

Pas përfundimit të trajnimeve studentët përveçse do të pajisen me njohuri të reja, ata do të pajisen edhe me certifikata për pjesëmarrje në trajnim. Sipas realizatorëve të këtij projekti, qëllimi është që përmes këtyre trajnimeve studentët nga universitetet publike të vendit të afrohen sa më shumë mes veti, duke e ditur se ndonëse Tetova dhe Shtipi janë dy qytete gjeografikisht të largëta, por përmes këtyre bashkëpunimeve studentët do të kenë mundësinë të njihen dhe të vazhdojnë bashkëpunimin edhe përkundër largësisë gjeografike.



**UNIVERSITETI YNË
ARDHMËRIA JONË**



UT NDAU 90 BURSA EKSELENTË TË STUDIM

31. 10. 2018. Universiteti i Tetovës sot ndau 90 bursa për studentët ekselentë të studimeve themelore. Në prani të prindërve dhe familjarëve të tyre, studentët më të dalluar nga 13 njësitë akademike të Universitetit të Tetovës, në mënyrë solemne i pranuan vendimet për lirim nga participimi nga Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Në fjalën e tij drejtuar studentëve dhe familjarëve të tyre, Rektori Prof. Dr. Vullnet Ameti, tha se Universiteti ynë, si vatra e arsimit të lartë në gjuhën shqipe dhe qendra e hulumtimit shkencor në vendin tonë e më gjerë, tani më për çdo vit i realizon prioritetet e veprimtarisë akademike dhe në këtë mënyrë shënon rezultatet konkrete në lëmin e arsimit, edukimit dhe kërkimit shkencor. Sipas tij, krahas aktiviteteve të tjera që zhvillohen në Universitet, ndarja e bursave për ekselentët, nga të

gjitha fakultetet, tashmë zë vendin e merituar, dhe si e tillë, paraqet një nga sukseset tona të përbashkëta. “Me këtë rast, në emrin tim dhe në emër të Universitetit, dekanëve të fakulteteve, profesorëve, studentëve, punonjësve të administratës, Ju shpreh urimet e mia për këtë aktivitet që sot e organizojmë, si njëra nga ngjarjet më të veçanta në veprimtarinë e përgjithshme të Universitetit të Tetovës. Me kontributin e përbashkët, përkushtimin dhe angazhimin serioz të secilit prej nesh, kemi arritur t’i përmbushim pritshmëritë në arsim dhe shkencë, ndaj, ndarja e bursave për studentët e dalluar është dëshmia e vërtetë se Universiteti ynë identifikohet si institucioni i garës për dije, i konkurrencës, por edhe i mundësive të mëdha. Më lejoni t’ju njoftoj se në përputhje me Ligjin për arsimin e të lartë, Statutin e Universitetit dhe me vendim të Senatit, ne sot do të



kanë fituar bursat universitare në bazë të punës, aftësisë dhe meritës së tyre dhe njëherit u shpreh mirënjohjen për kontributin që japin dhe nderin që i bëjnë Universitetit të Tetovës. Por, mbi të gjitha, respekt dhe mirënjohje të veçantë për prindërit dhe familjet tuaja, që ju kanë mbështetur në këtë rrugë të suksesshme, sepse pa përkrahjen e tyre, një arritje e tillë do ishte e pamundur.” – tha Rektori Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Po ashtu Rektori në fjalën e tij shtoi se edhe në të ardhmen ai dhe ekipi i tij do të vijojnë të punojnë për avancimin e procesit mësimor – shkencor, forcimin e kapaciteteve universitare të denja për kërkesat dhe sfidat me të cilat përballlet bota bashkëkohore. Studentët ekselentë, pas marrjes së bursave, i falënderuan drejtuesit e Universitetit të Tetovës, për mbështetjen që u japin atyre, sepse këto vlerësime u japin motiv shtesë për të vazhduar studimet me më shumë përkushtim.

PËR STUDENTËT EVE THEMELORE

ndajmë bursat universitare për 90 studentë të ciklit të parë në vitin akademik 2018/2019. Si Rektor i Universitetit të Tetovës, i përgëzoj ekselentët tanë që i kanë plotësuar kriteret e kërkuara arsimore dhe i



PROF. DR. ROBERT KOTE HAPI EKSPOZITËN E TIJ ME VIZATIME NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

5.11.2018. Në hapësirat e Rektoratit të Universitetit të Tetovës sot u hap ekspozita me vizatime e Prof. Dr. Robert Kote, tematika kryesore e të cilës lidhet me kalanë legjendare të Krujës dhe ndërtimin e muzeut historik për Skënderbeun po në këtë kala. Ekspozita e Prof. Dr. Robert Kotes është prezantuar edhe në disa qytete tjera shqiptare, në Shqipëri dhe Kosovë, në kuadër të aktiviteteve të cilat realizohen në agjendën e 550-vjetorit të lindjes së Skënderbeut, i shpallur edhe si viti mbarëkombëtar i tij.

Para hapjes së ekspozitës, Prof. Dr. Robert Kote, në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara të Universitetit tonë zhvilloi një ligjëratë, në të cilën në pika të shkurtra i prezantoi disa fakte rreth punëve gjatë ndërtimit të muzeut të Skënderbeut në kalanë e Krujës. Ai tha se për vite me radhë ka qenë udhëheqës i punëve dhe se gjithçka është realizuar sipas kërkesës së udhëheqësit të atëhershëm të Shqipërisë, Enver Hoxhës.

Ai u bëri thirrje studentëve të Fakultetit të Shkencave të Zbatuara që së bashku me profesorët e tyre ta vizitojnë këtë muze dhe për së afërmi të shohin punët që janë bërë në këtë muze.

Prof. Dr. Robert Kote, pas vizitës në Universitetin e Tetovës, ka realizuar disa vizita edhe nëpër disa vende në Tetovë për të fotografuar dhe skicuar disa objekte me qëllim që të grumbullojë informata dhe detaje. Ai premtoi se në të ardhmen do të vizitojë edhe disa qytete të tjera në Maqedoni dhe të njëjtat materiale do t'i prezantojë në një ekspozitë me vizatime.





UNIVERSITETI I TETOVËS NËNSHKROI DEKLARATËN PËR THEMELIMIN E ASOCIACIONIT TË UNIVERSITETEVE TË EVROPËS JUGLINDORE DHE BALLKANIT PERËNDIMOR

7.11.2018. Në Forumin e Dytë të Rektorëve të Ballkanit Perëndimor, që u mbajt në Universitetin e Zagrebit, më 3 nëntor 2018, Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr Vullnet Ameti, bashkë me 22 rektorë të tjerë, e nënshkruan deklaratën për themelimin e asociacionit të këtyre universiteteve.

Kjo deklaratë u nënshkrua në përputhje me konkluzionet e Forumit të Parë të Rektorëve të Ballkanit Perëndimor, që u mbajt në Universitetin e Novi Sa-

dit më 24 dhe 25 shtator 2018. Sipas protagonistëve të këtij forumi Asociacioni ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndëruniversitar si dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në shkencë, arsimin e lartë, kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive të reja.

Rektori i UT-së, Prof. Dr. Vullnet Ameti, para homologëve u shpreh se Universiteti i Tetovës, si njëri nga pesë universitetet publike në Republikën e



Maqedonisë, në vazhdimësi angazhohet për shtyrjen përpara të proceseve arsimore – shkencore, por edhe në lëmenj të tjerë me rëndësi për shoqërinë në Republikën e Maqedonisë e më gjerë. Sipas tij, pjesë e rëndësishme dhe e përhershme e agjendës së Universitetit të Tetovës është bashkëpunimi dhe forcimi i partneritetit me universitetet nga vendi, rajoni dhe arena ndërkombëtare, duke shtuar se në funksion të këtij qëllimi Universiteti i Tetovës mbështet plotësisht formimin e këtij asociacioni ndëruniversitar. Universiteti i Tetovës, si institucion i arsimit të lartë në Maqedoni, është orientuar drejt vlerave evropiane dhe perëndimore dhe është kyçur në shumë


asociacione ndërkombëtare. Nisur nga kjo Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, në punimet e forumit, kërkoi nga rektorët e Asociacionit të Universiteteve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor, që në deklaratën dhe programin e punës, t'i përfshijnë edhe disa propozime të Universitetit të Tetovës, siç janë: Mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik ballkanik; Themelimi e revistës së përbashkët shkencore; Përgatitja e një programi studimor të përbashkët për ciklin I, II, II; Themelimi i një instituti të përbashkët, që do të studiojë kulturat, gjuhët, historitë e popujve të Ballkanit; Organizmi i konferencës së përbashkët vjetore;



Përgatitja e programeve duale – të dyfishta; Kyçja në programe të përbashkëta me qëllim të qasjes më të lehtë në fondet e Bashkimit Evropian; Organizimi i shkollës verore studentore; Organizimi i turneut vjetor të lojërave sportive; Përgatitja dhe miratimi i rregullores së forumit; Përcaktimi i udhëheqjes së forumit; Përcaktimi i kushteve dhe kohëzgjatjes, etj. Bazuar në deklaratën e nënshkruar, Asociacioni do të vazhdojë të zhvillojë një platformë rajonale për bashkëpunim në hulumtime dhe kërkime shkencore, vëmendje të veçantë do t'i kushtojë përmirësimit të cilësisë së arsimit të lartë në Evropën juglindore dhe Ballkanin perëndimor. Do të krijojë

kushte për ndërtimin e përbashkët të kapaciteteve në fushën e shkencës, arsimit të lartë dhe transferimit të njohurive. Në mënyrë aktive do të angazhohet për përfitimin e interesave të përbashkëta nga institucionet e Bashkimit Evropian me qëllim që të inkurajojnë mobilitetin e mësimeve, bashkëpunëtorëve, shkencëtarëve, studiuesve dhe studentëve. Po ashtu nga BE do të kërkojnë të ndajë fonde për Universitetet e Evropës juglindore dhe Ballkanit perëndimor sa më shumë për ta financuar shkencën, e cila nuk duhet të jetë më pak se 1% e të ardhurave bruto kombëtare. Forumi i radhës i Asociacionit të Universiteteve të Evropës Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor, i treti i këtij lloji pritet të mbahet në Universitetin e Mostarit gjatë periudhës janar – shkurt të vitit 2019.

Pas përfundimit të Forumit të Rektorëve, Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, me ftesë të Rektorit të Universitetit të Zagrebit, Prof. Dr. Sc. Damir Buras, mori pjesë në shënimin e 350-vjetorit të këtij Universiteti.



HISTORIANI I NJOHUR **JUSUF BUXHOVI** LIGJËROI NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

8.11.2018. Jusuf Buxhovi, shkrimtar dhe historian i njohur nga Republika e Kosovës, sot e vizitoi Universitetin e Tetovës. Ai, fillimisht u prit nga Rektori, Prof. Dr. Vullnet Ameti, i shoqëruar nga dekan i Fakultetit Filologjik, Prof. Dr. Fatmir Sulejmani, dekan i Fakultetit Filozofik, Prof. Dr. Ibish Kadriu, si dhe shefi i kabinetit të tij, Doc. Dr. Faton Shabani. Në këtë takim, Rektori Prof. Dr. Vullnet Ameti e përgëzoi historianin nga Kosova për kontributin e vyer intelektual në shërbim të avancimit të proceseve të përgjithshme që zhvillohen në hapësirën gjithëkombëtare, për botimin e një sërë veprash me rëndësi për historiografinë shqiptare, me theks të veçantë veprën kapitale „Kosova“, të përfshirë në tetë vëllime. Rektori, e njoftoi Jusuf Buxhovin me të gjitha etapat e zhvillimit të Universitetit të Tetovës dhe veprimtarinë e begatshme arsimore-shkencore që realizohet në këtë institucion të arsimit të lartë në gjuhën shqipe në vendin tonë. Në përmbyllje të takimit, Rektori i UT-së, studiuesit Jusuf Buxhovi i ndau një dhuratë me portretin e themeluesit dhe Rektorit të parë të UT-së, Prof. Dr. Fadil Sulejmani. Gjatë qëndrimit në Universitetin e Tetovës, Jusuf Buxhovi e promovoi vëllimin VI, VII dhe VIII

të veprës së tij kapitale „Kosova“, si dhe mbajti një ligjëratë, me temë: „Vendi i shqiptarëve në Maqedoni i parë nga këndvështrimi historik, etnik dhe politik, nga antikiteti deri te koha jonë“. Dekani i Fakultetit Filologjik, Prof. Dr. Fatmir Sulejmani, e vlerësoi lartë punën voluminoze të këtij autori, që sipas tij ka bërë shumë dhe të gjitha i ka bërë ashtu siç duhet dhe në këtë aspekt ta kujton Nolin dhe disa studiues të tjerë, njëri që janë marrë me shumë fusha dhe në të gjitha kanë shkëlqyer“. Po ashtu, dekan i Fakultetit Filologjik, para studentëve dhe profesorëve të pranishëm në këtë promovim, e paraqiti biografinë e gazetarit, shkrimtarit dhe historianit nga Republika e Kosovës. „Jusuf Buxhovi u lind në Pejë, më 4 gusht të vitit 1946. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjakovë. Në vitin 1968 u diplomua në Universitetin e Prishtinës, Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe. Në vitin 1979 i kreu studimet pasuniversitare në Degën e Historisë të Universitetit të Prishtinës. Magjistroi në temën: „Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet gjermane“. Karrierën e gazetarit e filloi në gazetën „Rilindja“ të Prishtinës në vitin 1967, fillimisht si gazetar i kulturës, e më vonë redaktor i saj. Nga viti 1976 deri në vitin 2000 ishte korrespon-



dent i përhershëm i gazetës “Rilindja” i akredituar në Bon të Gjermanisë. Ndërsa nga viti 2000-2008, krahas veprimtarisë letrare, u mor me hulumtime historiografike nëpër arkivat gjermane. Ai, nga viti 2008 jeton dhe punon në Prishtinë. Ka vite që me punën e tij prej letrari të shquar dhe historiani të rrallë, Jusuf Buxhovi ka bërë emër të përveçëm në kulturën shqiptare dhe jo vetëm“, deklaroi Prof. Dr. Fatmir Sulejmani.

Për veprën “Kosova” foli edhe redaktori i saj, Ramadan Musliu, i cili këtë libër e cilësoi si projekt kapital i historisë së Kosovës. Ndërkaq, Jusuf Buxhovi u shpreh se ndjehet i lumtur që ndodhet në Tetovë, respektivisht në Universitetin e Tetovës, për dy çështje mjaft të rëndësishme. E para, se Universiteti i Tetovës është ndër universitetet më të rëndësishme shqiptare, meqë historiku i këtij Universiteti lidhet me identitetin kulturor dhe shpirtëror të shqiptarëve të Maqedonisë.

„Ndjehem i nderuar që jam pjesë e Juaja, veçmas që këtu po shoh më shumë femra, dhe kjo tregon se megjithatë emancipimi edhe në këtë ambient i ka përmasat çfarë në të vërtetë do të duhej t'i kishte. Sot u shpreha edhe për medien për themeluesin e këtij universiteti, profesor Fadil Sulejmanin, i cili është njeri prej protagonistëve shumë të rëndësishëm jo vetëm intelektualë por edhe politikë, i cili në ditët shumë të rëndësishme të thyerjeve të mëdha që ndodhën në Kosovë, Maqedoni dhe vise të tjera të ish-Jugosllavisë, në rrethana kur Kosova ndodhej nën kërcënimin që disa vite më vonë e përjetoi, Maqedonia ishte një oazë ku siguronte sado

kudo që kjo çështje mos e përfshijë gjithë botën shqiptare. Në ato rrethana spektri politik i Kosovës, u përcaktua që në Maqedoni të pranohet një gjendje jo e volitshme, por që nuk do të lejonte përhapjen e krizës, kjo ishte arsyeja e pranimit të Maqedonisë si shtet dhe mbi këto rrethana, ajo që ishte e rëndësishme ishte përcaktimi për një Universitet në Tetovë, i cili në një farë mënyre përkonte me organizimin e shtetit paralel në Kosovë, e që mundësonte një pozicionim të shqiptarëve në RM”, theksoi profesor Jusuf Buxhovi. Në vijim të fjalës së tij, ai i falënderoi nikoqirët për mikpritjen dhe u shpreh se libri i gjashtë e fokuson Maqedoninë bukur shumë, si luftën në Maqedoni dhe përpjekjen e shqiptarëve që ta kthejnë pozicionimin si subjekt në një ambient të cilin edhe vetë kushtetuta e vitit 1991, zhvillimet që ndodhën në Maqedoni gjatë atyre dhjetë viteve nuk ua garantuan. Ligjërata e tij, me temë: „Vendi i shqiptarëve në Maqedoni i parë nga këndvështrimi historik, etnik dhe politik, nga antikiteti deri te koha jonë“, tërhoqi vëmendjen e studentëve të një-sive të ndryshme akademike, të stafit akademik dhe veprimtarëve të njohur të çështjes shqiptare.

Përgjatë 46 viteve të krijimtarisë së tij, Jusuf Buxhovi ka botuar 40 vepra të rëndësishme letrare e historike, ku bëjnë pjesë librat me tregime, novelat, romanet, dramat, libri me vështrime letrare dhe ai me shkrime publicistike dhe, natyrisht, perlat e historiografisë shqiptare, që janë të një rëndësie shumë të veçantë.



STUDIUESIT E SHKENCAVE TË MJEKËSISË DISKUTUAN RRETH TRAUMËS DHE KIRURGJISË EMERGJENTE

9.11.2018. Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë i Universitetit të Tetovës, bashkë me Shoqatën e Traumës dhe Kirurgjise Emergjente, organizuan Konferencën e Tretë Ndërkombëtare të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë dhe Kongresin e Dytë të Traumës dhe Kirurgjisë Emergjente.

Në këtë ngjarje shkencore, emra eminentë të fushave të mjekësisë nga Maqedonia, Kosova, Shqipëria, si dhe nga vende të ndryshme evropiane i paraqitën punimet e tyre shkencore, të cilat pritet të sjellin debat të frytshëm, sepse mes vete debatojnë profesorë, ekspertë dhe specialistë të ndryshëm të shkencave të mjekësisë.

Konferencën e Tretë të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë dhe Kongresin e Dytë të Traumës dhe Kirurgjisë Emergjente e përshëndetën rektorët e

disa universiteteve, si dhe drejtues të institucioneve të mjekësisë.

Sipas Rektorit të Universitetit të Tetovës, Prof. dr. Vullnet Ameti, veprimtaritë e kësaj natyre synojnë avancimin shkencor, prurjet e reja dhe tejkalimin e problemeve që paraqesin sfida për shkencat e mjekësisë dhe jo vetëm. „Kjo ngjarje me rëndësi për rajonin do të mundësojë shkëmbimin e ideve, përfitim të njohurive të shumta, krijimin e lidhjeve dhe miqësive të studiuesve vendas dhe të huaj. Ky bashkëpunim i frytshëm shpresojmë të vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim jo vetëm të ngritjes së nivelit të hulumtimeve shkencore nga fushat e ndryshme të mjekësisë, por edhe në zbatimin praktik të rezultateve të arritura nga puna kërkimore-shkencore e këtyre fushave“, u shpreh Prof. dr. Vullnet Ameti.

Rektori i Universitetit të Mjekësisë në Tiranë, Prof. dr.



Arben Gjata, theksoi se për universitetet shqiptare është i domosdoshëm bashkërendimi i aktiviteteve të përbashkëta shkencore. „Kjo ngjarje shkencore na bashkon ne si universitete, ajo që ne si Universiteti i Mjekësisë në Tiranë i kushtojmë rëndësi jashtëzakonisht të madhe është bashkëpunimi ndëruniversitar dhe ne i jemi mjaftë mirënjohës Universitetit të Tetovës për bashkëpunimin e sinqertë që ka me ne, sepse vetëm duke bashkëpunuar në projekte të këtilla mund t'i realizojmë qëllimet tona të përbashkëta që i kemi”, u shpreh Prof. dr. Arben Gjata.

Mendim të ngjashëm për rëndësinë që ka bashkëpunimi mes universiteteve shqiptare dhe jo vetëm, shfaqti edhe Rektori i Universitetit të Elbasanit, Prof.

dr. Skënder Topi. „Vlerësoj se është detyrë e jonë e bashkësisë akademike, që t'i bashkërendojmë punët tona shkencore në nivel universitetesh. Besoj që kjo konferencë dhe ky kongres, duke pasur gjithëpërfshirjen e universiteteve shqiptare, por dhe të atyre ballkanikë dhe evropianë, në të vërtetë bashkërendon të gjitha mundësitë për të realizuar një kërkim shkencor dhe kjo është vazhdimësia e punës tonë që ne të përmirësohemi edhe më shumë në hulumtimet tona shkencore dhe krijimin e ideve të reja inovative”, shtoi Prof. dr. Skënder Topi.

Kryetari i Shoqatës së Traumës dhe Kirurgjisë Emergjente, Prof. dr. Agron Dogjani, tha se qëllimi i Konferencës dhe Kongresit është që të gjithë së bashku, mjekët, kirurgët dhe jo vetëm, të afrohemi rreth një sofre të madhe për të diskutuar, debatuar dhe shpalosur qëndrimet dhe idetë rreth traumës dhe urgjencës kirurgjike.

Drejtori i Spitalit Universitar të Traumës në Tiranë, Prof. dr. Arben Zenelaj, duke iu referuar trajtimit të urgjencave kirurgjike në përgjithësi, e veçanërisht atyre traumatologjike, tha se këto përbëjnë sfida të veçanta të çdoditshme për stafet mjekësore. Sipas tij, reflektimi ose përmbledhja e këtyre problemeve





në punën e përditshme me organizimin e këtyre aktiviteteve shkencore do ta përmirësojë edhe më shumë punën e mjekëve në këtë drejtim dhe do të jëtë një ndihmesë e madhe për ato.

Dekani i Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë i Universitetit të Tetovës, Prof. dr. Kastriot Haxhirexha, tha se Konferenca dhe Kongresi do të përfshijnë sesione të ndryshme dhe simpoziume të lidhura me lajmet e fundit në fushën e traumatologjisë dhe të mjekësisë emergjente. „Ne kemi për qëllim të ofrojmë për të gjithë pjesëmarrësit, si për kirurgët, mjekët, traumatologët, anesteziologët, studentët e mjekësisë, infermierët dhe profesionistët e tjerë të kujdesit shëndetësor, një mundësi për të ndarë përvojën dhe njohuritë e tyre rreth traumatologjisë dhe mjekësisë emergjente dhe për të marrë aftësitë e reja të nevojshme për ofrimin e kujdesit optimal për pacientët. Kongresi i Traumatologjisë dhe Emergjencave është një takim tregëtor, i cili do të përpiqet të sjellë së bashku kirurgë prestigjozë dhe traumatologë dhe t’i jep secilit prej tyre një mundësi për të shkëmbyer informacione dhe aftësi në fushën e traumatologjisë, kirurgjisë dhe specialiteteve të ndryshme mjekësore”, nënvizoi Prof. dr. Kastriot Haxhirexha.

Këtë aktivitet shkencor e përshëndetën edhe Kryetari i nderit i Kongresit të II të Shoqatës së Traumës dhe Kirurgjisë Emergjente, Prof. dr. Rifat Latifi dhe koordinatori i Konferencës së Tretë të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, Prof. dr. Lutfi Zylbehari. Po ashtu, Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. dr. Vullnet Ameti, në shenjë respekti për mbështetjen që i kanë dhënë organizimit të këtij manifestimi shkencor, ndau mirënjohje për sponsorët e konferencës.



NË KUADËR TË PUNIMEVE STUDENTËT E STOMATOLOGJISË OPERACIONIN PËR

11. 11. 2018. Në vazhden e punimeve të Konferencës së tretë shkencore ndërkombëtare të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës, u realizua punëtori (workshop) me studentët dhe profesorët e programit studimor të Stomatologjisë. Qëllimi punëtorisë ishte njoftimi i studentëve për aftësitë orale – kirurgjikale dhe implantologjinë bashkëkohore.

Nën udhëheqjen e specialistit të kirurgjisë orale, dr. spec. Danço Bizevski dhe profesoreshës, doc. dr. Jetmira Alimani Jakupi, studentët u njoftuan me instrumentet elementare kirurgjike dhe pastaj, të ndarë në grupe, ata filluan punën praktike me nofultat e kafshëve për të realizuar implantin e dhëmbit, duke u nisur që nga incizimi, preparimi i vendit të



SE VE TË KONFERENCËS SË TRETË SHKENCORE STOMATOLOGJISË E REALIZUAN ME SUKSES IMPLANTIN E DHËMBIT

implantit, vendosjen e implantit dhe qepjen. Dr. spec. Danço Bizevski vlerësoi lartë punën dhe angazhimin e studentëve të stomatologjisë të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës, të cilët në mënyrë mjaft aktive dhe me shumë sukses e realizuan punën e implantit. Siç u shpreh ai, nga përvojat e tij profesionale në fushën e stomatologjisë, deri më tani implante ka realizuar vetëm me specialistë, ndërsa me studentë për herë të parë. „U ndava mjaftë i kënaqur me punën e studentëve, ishin mjaftë të përgaditur për sa i përket realizimit të implantit. Dua t’i përgëzoj ata për përkushtimin dhe rëndësinë që u japin studimeve, falë punës së pedagogëve të tyre dhe dëshirës së studentëve për punë, ku dalin rezultate efektive. Më bëri përshtypje

jashtëzakonisht të madhe edhe kujdesi i rektorit të Universitetit të Tetovës, prof. dr. Vullnet Ameti, i cili për së afërmi e ndoqi punën e studentëve dhe aty e kuptova se studentët janë më se të motivuar nga se kanë suport të mjaftueshëm nga udhëhqësia e Universitetit dhe sidomos dekani i Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, prof. dr. Kastriot Haxhirexha. Uroj që në konferencat e ardhshme studentët tuaj të sjellin prurje të reja shkencore në fushën e stomatologjisë”, deklaroi dr. spec. Danço Bizevski. Në kuadër të sesioneve të Konferencës së tretë shkencore ndërkombëtare të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë u prezantuan një sërë punimesh nga fusha e stomatologjisë nga studiues eminentë nga vendi dhe rajoni.



ME INICIATIVË TË UNIVERSITETIT U THEMELUA SHOQATA M E MORFOLOGËVE

11. 11. 2018. Me mbështetje të Universitetit të Tetovës, respektivisht Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, si dhe Universitetit të Mjekësisë në Tiranë dhe Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë në Prishtinë, u themelua Shoqata Mbarëshqiptare e Morfologëve dhe Anatomëve. Kjo Shoqatë u themelua pas diskutimeve dhe debateve të shumta që u zhvilluan mes mjekëve, kirurgëve, anatomëve dhe jo vetëm, gjatë punimeve të Konferencës së tretë shkencore

ndërkombëtare të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë së Universitetit të Tetovës, e cila gjatë tri ditëve i zhvilloi punimet në qytetin e Ohrit.

Krijimit të kësaj shoqate i dhanë mbështetje të fuqishme edhe Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. dr. Vullnet Ameti dhe Rektori i Universitetit të Mjekësisë në Tiranë, Prof. dr. Arben Gjata, të cilët në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2018, në





TETIT TË TETOVËS MBARËSHQIPTARE E DHE ANATOMËVE

Ohër, theksuan se do të jenë në dispozicion të kësaj shoqate duke e mbështetur vazhdimisht. „Iniciativa për themelimin e Shoqatës Mbarëshqiptare në nivel rajonal është për t’u përshëndetur dhe përkrahur. Universiteti i Tetovës do të jetë në gatishmëri të vazhdueshme që ta ndihmojë këtë shoqatë, e cila në anëtarësinë e saj do të ketë pedagogë nga të gjithë universitetet shqiptare. Themelimi i kësaj shoqate është dashur të bëhet me kohë, por më mirë vonë se sa kurrë. Kjo do të jetë një mundësi e mirë për stafin akademik, anatomët, fiziologët, kirurgët, por edhe të tjerë nga fusha e mjekësisë, që të bashkëpunojnë, përgatitin dhe realizojnë projekte të ndryshme, me të cilat do të aplikojnë nëpër organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe ne si shoqëri vetëm kështu do ta ndjekim rrugën e popujve të civilizuar“, vlerësoi Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. dr. Vullnet Ameti.

„Kjo iniciativë është e mrekullueshme, ne si institucione shpesh kemi shkëmbyer mendime lidhur me mundësitë e integritimit apo dakordimit të no-

menklaturave të gjithë programeve të lëndëve, të formimit bazë dhe idenë për krijimin e kësaj shoqate mbarëshqiptare të morfologëve, anatomëve bashkë me histologët, apo edhe anatomët patologë. Fundja, bërthamë të fjalës ka morfologjinë dhe si shoqatë mbarëkombëtare për mua është ide e mrekullueshme dhe do ta mbështesim këtë Shoqatë, me të gjitha mundësitë tona, ne si Universitet i Mjekësisë në Tirana, sepse tre Fakultetet tona do të kenë një program të përbashkët dhe kjo do të jetë shumë e dobishme për studentët tonë”, u shpreh Prof. dr. Arben Gjata, rektor i Universitetit të Mjekësisë në Tiranë.

Në mbledhjen e mbajtur për themelimin e Shoqatës Mbarëshqiptare të Morfologëve dhe Anatomëve, me vendim anonim të të gjithë pjesëmarrësve u zgjodh Kryesia e përkohshme e Shoqatës, me kryetar Prof. dr. Sadi Bexhetin dhe dy nënkryetarë, Prof. dr. Artur Hafizin dhe Prof. dr. Hilmi Dautin, nga Universiteti i Prishtinës, ndërsa sekretar u zgjodh dr. med. Selim Çerkezi.

Pas zgjedhjes së kryesisë së përkohshme të Shoqatës, kryetari Prof. dr. Sadi Bexheti u shpreh se brenda një periudhe të shkurtër, ai së bashku me anëtarët do të angazhohet që sa më shpejt të përgatitet statuti i Shoqatës, duke zhvilluar disa mbledhje, si në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, për definimin e statutit, si do të funksionojë kjo shoqatë më tej. „Themelues të shoqatës janë të gjitha shoqatat e tjera që kanë të bëjnë me lëndët e kirurgjisë dhe ne nuk i ndalojmë ata që të mos jenë anëtarë të shoqatës. Qëllimi i themelimit të shoqatës është se anëtarësimi ynë në federatën anatome na mundëson revista shkencore, librat e terminologjive të ndryshme t’i blejme me çmime shumë më të lira, informacionet t’i marrim në kohë, njëkohësisht bëhen edhe ndryshimet e termave të tillë për të informur të gjithë mjekët dhe komunikimi ndërkombëtar bëhet sa më tepër në gjuhën latine dhe të gjitha këto procese t’i shtjellojmë me një punim të cilat do t’i përmbledhim brenda statutit të Shoqatës dhe do t’ua shpërndajmë të gjithë mjekëve dhe kolegëve të cilët dëshirojnë të jenë anëtarë. Pa hatërmbetje, kjo do të jetë një Shoqatë e cila e ka bazën në Universitetin e Tetovës”, tha Prof. dr. Sadi Bexheti, Kryetar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Morfologëve dhe Anatomëve.

Themelimin e shoqatës e mbështetën edhe shumë personalitete të tjerë nga fusha e mjekësisë.



KONFERENCA E TRETË NDËRKOMBËTARE E FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË MJEKËSISË I UNIVERSITETIT TË TETOVËS DHE KONGRESI II I TRAUMËS DHE KIRURGJISË EMERGJENTE I PËRMBYLLËN ME SUKSES PUNIMET

13.11.2018. Profesorë, mjekë, kirurgë, ortopedë, internistë, stomatologë, kardiologë dhe specialistë të ndryshëm të shkencave të mjekësisë nga vendi, rajoni dhe Evropa i shpalosën idetë dhe shkëmbyen mendimet e tyre në lidhje me tematika të ndryshme, që kanë të bëjnë me mjekësinë e përgjithshme. Kon-

ferenca ishte e fokusuar kryesisht mbi zhvillimet dhe prurjet e reja në mjekësinë e përgjithshme, ndërsa thelbi kryesor i kongresit ishin arritjet më të fundit në lëmin e traumatologjisë.

Këto ngjarje të organizuara bashkërisht, përveç sesioneve shkencore në të cilat kishte përplasje mendimesh mes profesionistësh e ekspertësh, u karak-

terizuan edhe me aktivitete të tjera, të cilat ishin në favor të të gjithë pjesëmarrësve, pasi që u hodhën shumë ide për një bashkëpunim më të gjerë në të ardhmen.

Rektorë të disa universiteteve shqiptare, si Prof. Dr. Vullnet Ameti – rektor i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Arben Gjata – rektor i Universitetit të Mjekësisë në Tiranë, Prof. Dr. Skënder Topi – rektor i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhovani” dhe përfaqësues nga universitete tjera ranë dakord për një bashkëpunim më të zgjeruar në të ardhmen mes universiteteve shqiptare me qëllim bashkërendimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe përmes kësaj të arrihen qëllimet si dhe të përmbushen objektivat e universiteteve, që si mision kanë dijen dhe kërkimin shkencor. Si rezultat i kësaj, me iniciativë të Rektorit të Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, u bë edhe themelimi i Shoqatës Mbarëshqiptare Morfologjike të Anatomëve. Themelimin e kësaj shoqate e përshëndetën edhe dekani i Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë së Universitetit të Tetovës -Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha, kryetari i Shoqatës së Traumatologjisë dhe Kirurgjisë Emergjente Tiranë – Prof. Dr. Agron Dogjani, drejtuesi i departamentit të Anatomisë në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë – Prof. Dr. Xheladin Ceka dhe shumë personalitete të tjera.

Dekani, Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha, theksoi se ky aktivitet shkencor është motivues për zgjerimin e bashkëpunimit në të ardhmen mes universiteteve nga rajoni, Evropa dhe bota. “Ishte kënaqësi për ne si Fakultet i Shkencave të Mjekësisë së Universitetit të Tetovës që të bashkonim në një ngjarje të tillë shkencore universitetet, jo vetëm shqiptare, por edhe ato ballkanike dhe evropiane duke ftuar një numër të madh personalitetesh eminente nga shkencat e mjekësisë. Kjo është një arritje mjaft e madhe për Universitetin e Tetovës, por është edhe një mesazh për të gjithë shoqërinë, se çelësi i suksesit është bashkëpunimi. Vetëm duke bashkëpunuar do të hapim dyert e mirëqenies dhe progresit” – tha Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha.



Kryetari i Shoqatës së Traumatologjisë dhe Kirurgjisë Emergjente, Prof. Dr. Agron Dogjani, shprehu gatishmërinë e shoqatës dhe ekipit që ai drejton për të vijuar bashkëpunimin. “Ishte kënaqësi të jemi pjesë e një eventit kaq të rëndësishëm, që u organizua bashkërisht nga Universiteti i Tetovës, pra Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë dhe Shoqata e Traumatologjisë dhe Kirurgjisë Emergjente. Më erdhi mirë që në kuadër të këtij evenimenti u zhvilluan edhe shumë ngjarje të tjera. Po ashtu dua të përshëndes edhe krijimin e Shoqatës Mbarëshqiptare Morfologjike të Anatomëve, shoqatë e cila do jetë një ndihmesë e madhe për të gjithë mjekët, kirurgët, morfologët dhe specialistët e fushave të ndryshme të mjekësisë. Ishte kënaqësi që edhe unë si drejtues i Shoqatës së Traumatologjisë dhe Kirurgjisë Emergjente isha pjesë e themelimit të kësaj shoqate dhe do të jemi gjithmonë në mbështetje të kësaj shoqate” – shtoi më tej Prof. Dr. Agron Dogjani.

Drejtuesi i departamentit të Anatomisë në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë, Prof. Dr. Xheladin Ceka, vlerësoi se ishte mundësi e mirë pjesëmarrja në Konferencën Shkencore të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë së Universitetit të Tetovës dhe Kongresin II të Shoqatës së Traumatologjisë dhe Kirurgjisë Emergjente mes shumë studiuesish shqiptarë dhe jo vetëm. “Ishte ndjenjë e bukur të jesh në mesin e shumë studiuesve shqiptarë dhe atyre shumë personaliteteve të mjekësisë nga Spanja, Italia, Turqia, Kroacia, Bosnja Hercegovina e kështu me radhë. Përveç kësaj ngjarjeje shkencore më bëri krenar edhe ideja për themelimin e një shoqate mbarëshqiptare të morfologëve shqiptarë, e cila tani më u bë edhe realitet. Ne si studiues të kësaj fushe



kemi pasur nevojë për një shoqatë të tillë mbarëshqiptare dhe për këtë u jemi mirënjohës universiteteve tona, e në veçanti Universitetit të Tetovës dhe Rektorit Prof. Dr. Vullnet Ameti për mbështetjen që i dha themelimit të kësaj shoqate. Deri më tani në Tiranë ka një shoqatë të morfologjisë klinike shqiptare, por funksionon vetëm atje. Ajo nuk është mbarëshqiptare por kjo që u themelua së fundmi do të tubojë në gjirin e saj të gjithë studiuesit nga trevat tona” – potencoi Prof. Dr. Xheladin Ceka.

Konferenca Shkencore e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë dhe Kongresi II i Traumatologjisë dhe Kirurgjisë Emergjente, në përputhje me agjendën dhe programin e tyre të punimeve, përveç prezantimeve nga specialistë dhe ekspertë të ndryshëm të fushave të mjekësisë, trajtim të veçantë u kush-tuan edhe studentëve të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës, të cilët para profesorëve eminentë prezantuan punimet e tyre shkencore për. Ndërsa studentët e stomatologjisë zhvilluan punëtori (workshop) me specialistë të stomatologjisë. Specialistët e kirurgjisë orale, në mesin e të cilëve edhe Dr. Spec. Danço Bizevski, vlerësuan lart programin studimor të Stomatologjisë, pasi që aftësitë e studentëve për të realizuar implantin e dhëmbit janë një dëshmi se ky fakultet përgatit kuadro profesionistësh në fushën e stomatologjisë. Vlerësime për organizimin e Konferencës së Tretë të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë të UT-së dhanë personalitete të ndryshme të mjekësisë. Ish-rektori i Universiteti të Tetovës, Prof. Dr. Sadi Bexheti vuri në dukje se kjo ngjarje shkencore i ngre edhe më shumë vlerat dhe cilësitë, jo vetëm të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, por edhe të Universitetit

të Tetovës në përgjithësi. “Kjo ngjarje shkencore bëri që ne studiuesit e këtyre fushave të prezantojmë njohuritë tona rreth tematikave të ndryshme që kanë të bëjnë me mjekësinë. Sigurisht që debati nuk mungoi. Kishte divergjenca mes studiuesish, diskutime të shumta, vërejtje e kështu me radhë. Po ashtu në kuadër të këtij aktiviteti ne e themeluan edhe Shoqatën Mbarëshqiptare Morfologjike të Anatomëve. Kjo shoqatë, pa hatër mbetje, do të jetë pjesë e Universitetit të Tetovës, për arsye se institucioni ynë ka nevojë. Me bashkëpunëtorët nga të gjitha trevat shqiptare do t’i realizojmë qëllimet tona si shoqatë duke realizuar misionin tonë si studiues shkencorë” – deklaroi Prof. Dr. Sadi Bexheti.

Për drejtorin e Klinikës së Traumatologjisë në Shkup, Dr. Ilir Hasani produktiviteti i kësaj ngjarjeje shkencore ka qenë mjaft i madh parë nga të gjitha këndvështrimet. “Ishte një eveniment mjaft i madh. Shpresojmë që evenimente të këtilla ndërkombëtare do të organizohen edhe më shpesh. Produktiviteti ka qenë në nivel mjaft të lartë në të gjitha sesionet, në të cilat unë kam qenë prezent dhe i kam ndjekur. Kanë qenë mjaft efektive diskutimet e nivelit më të lartë. Nga ajo që dëgjoja gjatë prezantimeve dhe diskutimeve më dukej se nuk jam në një konferencë që realizohet në Ballkan. Në çdo seancë të traumatologjisë, por edhe të ortopedisë, ka pasur nga një të ftuar ndërkombëtar dhe kjo tregon se vërtet jemi në rrugë të duhur edhe pse jemi pas në krahasim me botën moderne, por përsëri vlerësoj se jemi në rrugë të duhur. Kjo ngjarje e përbashkët ka bërë që edhe më shumë të rritet produktiviteti për shkak se në çdo vend, ku sinkronizohen forcat, bëhet fuqi dhe ka progres e jo regres. Kjo, përveç produktivitetit, i motivon edhe studentët dhe specialistët e rinj, të cilët morën pjesë në numër shumë të madh” – theksoi drejtori i Klinikës së Traumatologjisë në Shkup, Dr. Ilir Hasani.

Ndërsa kryetari i nderit i Kongresit II të Shoqatës së Traumatologjisë dhe Kirurgjisë Emergjente, Prof. Dr. Rifat Latifi, theks të veçantë në vlerësimin e tij i kushtoi bashkëpunimit mes institucioneve të arsimit të lartë dhe peshës që ato kanë në shoqëri.

“Dua të shpreh mirënjohjen time për organizatorët e këtij eventi. Ashtu siç e filluam kongresin e parë në Tiranë thamë se nga viti në vit këtë kongres do ta bëjmë edhe më të suksesshëm dhe më të rëndësishëm për nga cilësia. Këtë vit kongresi i zhvilloi punimet në Ohër në bashkëpunim me Universitetin e Tetovës dhe Shoqatën e Traumatologjisë dhe Kirurgjisë Emergjente, ndërsa vitin tjetër do të jemi në Prishtinë. Ishte një ngjarje e veçantë. Dua të shpreh mirënjohjen time dhe konsideratën për Universitetin e Tetovës, për gjithë atë organizim madhështor. Shpresoj që ky kongres të lëvizë rreth e përqark gjitha trojeve shqiptare. Në vitin e ardhshëm në Prishtinë synojmë të mbajmë kongresin e parë të kolegjit të kirurgëve shqiptarë dhe të gjitha shoqatat e kirurgëve dhe mjekëve do të mund të jenë pjesë e këtij kolegji që në të ardhmen do të jetë një burim i dijes dhe një forcë jashtëzakonisht e madhe për prurjet e reja në mjekësinë e përgjithshme” – përfundoi vlerësimin e tij Prof. Dr. Rifat Latifi.

Profesori universitar, Prof. Dr. Jordan Savevski, në opinionin e tij rreth organizimit të kësaj ngjarjeje shkencore bëri me dije se dalëngadalë po hapen mundësitë drejt avancimit të shkencës edhe për vendet ballkanike. “Unë isha pjesëmarrës si kirurg, stomatolog, ortoped, i cili punon këtë pjesë të kirurgjisë. Në përgjithësi, të gjitha sesionet në të cilat mora pjesë ishin mirë të organizuara. U zhvilluan shumë diskutime dhe mendoj se jemi në rrugën e duhur që dyert tona të zymta dhe të rënda ballkanike t’i hapim me dije, pasi vetëm në këtë mënyrë shkohet përpara. Kështu që konferenca ishte e dobishme edhe për specialistët edhe për specialistët, por edhe për studentët dhe studiuesit e këtij lëmi. Në disa raste kishte divergjenca gjatë diskutimeve dhe e tëra kjo ishte për të mirën e pacientëve” – nënvizoi Prof. Dr. Jordan Savevski.

Në emër të Universitetit të Prishtinës, Konferencën e Tretë Shkencore dhe Kongresin II të Traumatologjisë i çmoi lart prodekani i Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, Prof. Dr. Ibrahim Rudhani. “Universiteti i Prishtinës gjithmonë ka qenë në krah të Universitetit të Tetovës. Fakulteti i Shkencave të



Mjekësisë në Prishtinë është i gatshëm që të jetë pjesë e të gjitha organizimeve të përbashkëta shkencore. Fakulteti ynë është përkrah rritjes së Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë së Universitetit të Tetovës, edhe pse si fakultet është shumë i ri në moshë për është shumë i pjekur në shkencë. Dua t’ju përgëzoj në emrin tim dhe në emër të dekanit dhe stafit menaxhues të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë së Universitetit të Prishtinës për këtë ngjarje kaq të rëndësishme” – u shpreh Prof. Dr. Ibrahim Rudhani. Vlerësime për konferencën dha edhe studentja e Stomatologjisë, Luljeta Civuli, e cila këtë ngjarje shkencore e konsideroi si një nga përvojat më të bukura që ka përjetuar gjatë gjithë rrugëtimit studimor. “Ajo që kam dëgjuar gjatë sesioneve në fushën e stomatologjisë ka qenë mjaft e vlefshme për profesionin tim dhe më ka motivuar që edhe më shumë të vazhdoj të mësoj, studioj, hulumtoj, por edhe të punoj në këtë fushë. Gjithashtu një vlerësim maksimal dhe falënderim tejet të madh për profesorët si dhe të gjithë ligjëruesit e tjerë, të cilët pa u lodhur në asnjë moment, na kanë ndihmuar dhe na kanë shpjeguar gjithçka rreth asaj që ne kishim nevojë” kështu u prononcua studentja e vitit të pestë të stomatologjisë, Luljeta Civuli.

Të gjithë studentët pjesëmarrës në këtë ngjarje shkencore u shprehën mjaft të kënaqur me ligjëruesit, ngase siç vlerësuan ata, për herë të parë kanë dëgjuar gjëra për të cilat deri më tani nuk kanë pasur njohuri dhe se kjo është një ndihmesë e madhe në rrugëtimin e tyre drejt profesionalizimit në fushën e mjekësisë.



FAKULTETI I MJEKËSISË I UT-SË ME MESAZHE SENSIBILIZUESE RRETH SËMUNDJES SË DIABETIT

14.11.2018. Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë në Universitetin e Tetovës, sot përmes disa aktiviteteve të organizuara nga Grupi Shkencor dhe Parlamenti Studentor i këtij Fakulteti e shënoi 14 nëntorin, Ditën Botërore të Diabetit.

Dekani i Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha, tha se përmes këtij aktiviteti, Universiteti i Tetovës, gjegjësisht Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë bën që edhe qyteti ynë, Tetova, të rreshtohet me të gjitha qytetet e ndryshme botërore, të cilat realizojnë fushata sensibilizuese mbi sëmundjen e diabetit. “Ndiej një kënaqësi të veçantë që mes këtyre vendeve të rreshtohet edhe qyteti i Tetovës, nën organizim të Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë. Kjo fushatë sensibilizuese organizohet për disa vite radhazi. Dihet se diabeti është një sëmundje kronike, e cila nuk mund të parandalohet, por problemet, që mund të paraqiten nga diabeti, mund me shumë

sukses të ngadalësohen ose evitohen tërësisht falë kujdesit që do të kenë pacientët për shëndetin e tyre. Ky është qëllimi dhe motoja e kësaj fushate sensibilizuese, pra të vetëdijesojmë qytetarët tanë se me një kujdes më të madh, duke përdorur terapinë adekuate, shumica e komplikimeve që mund të vinë nga kjo sëmundje mund të parandalohen. Me sa shoh studentët janë shumë mirë të organizuar dhe vërehet interesim nga ana e qytetarëve për t’u konsultuar e për të matur nivelin e sheqerit. Edhe një herë i falënderoj studentët, grupin organizator për punën e mirë që kanë bërë sot” – tha Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha.

Koordinatorja e Grupit Shkencor në Fakultetin e Shkencave të Mjekësisë, Doc. Dr. Arbëresha Bexheti – Ferati, u shpreh mjaft e kënaqur nga ky aktivitet ngase janë realizuar shumë kontrolle falas për qytetarët dhe se pjesa dërmuese e tyre janë informuar në detaje mbi shkaktarët që mund të sjellin



deri te sëmundja e diabetit. “Si çdo vit studentët dhe profesorët e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë i kushtojnë rëndësi të veçantë shënimit të kësaj dite. Ata përmes kontrollove falas për qytetarët në qendër të qytetit të Tetovës dhe shpërndarjes së materialeve propaganduese rreth sëmundjes së diabetit, si një nga sëmundjet kronike më të përhapura, jo vetëm në shoqërinë tonë, por edhe më gjerë, bënë sensibilizimin e opinionit që t’i kushtojnë vëmendje të duhur kësaj sëmundjeje. Studentët apo mjekët e ardhshëm i informuan qytetarët për masat preventive që duhet t’i ndër marrin kundër përhapjes së diabetit. Ne do t’i vazhdojmë aktivitetet tona, të cilat kanë për qëllim vetëdijesimin e qytetarëve mbi sëmundje të ndryshme” – u shpreh Doc. Dr. Arbëresha Bexheti – Ferati.

Studentët e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, të ndarë në disa grupe, fillimisht qytetarët i njoftonin rreth sëmundjes së diabetit, duke bërë edhe kontrolle falas të matjes së glukozës në gjak. Po ashtu ata për qytetarët jepnin edhe rekomandime mbi ushqimet, të cilat duhet konsumuar si dhe i udhëzonin ata që sa më shumë t’u kushtojnë rëndësi aktiviteteve fizike.

UT IU BASHKËNGJIT AKSIONIT PËR DHURIMIN E GJAKUT

16.11.2018. Në hapësirat e fakulteteve të Universitetit të Tetovës u organizua aksioni për dhurimin e gjakut nga ana e studentëve, stafit akademik dhe stafit administrativ.

Aksioni humanitar për dhurimin e gjakut në Universitetin e Tetovës tani më organizohet për disa vite me radhë në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë dhe repartin për transfuziologji të Spitalit Klinik të Tetovës.

Një numër i madh i studentëve dhe profesorëve të Universitetit të Tetovës iu bashkëngjitën iniciativës së Kryqit të Kuq, përmes së cilës ata shprehën humanizmin e tyre. Sipas tyre, vetëm duke dhuruar gjak, në mbështetje të të gjithë atyre të cilët kanë nevojë, mund të shpëtohet një jetë më shumë.

Nga Kryqi i Kuq i Maqedonisë dhe reparti i transfuziologjisë në Tetovë thanë se ky aksion ka pasur jehonë jashtëzakonisht të madhe te vullnetarët, të



cilët pozitivisht iu përgjigjën këtij aksioni për të dhuruar gjak.

Ata po ashtu falënderuan edhe drejtuesit e Universitetit të Tetovës për mbështetjen që i japin gjithmonë këtij aksioni.



KLUBI I VOLEJBOLLIT “UNIVERSITETI I TETOVËS” GARON NË LIGËN E PARË TË VOLEJBOLLIT TË MAQEDONISË

19.11.2018. Klubi i volejbollit për meshkuj KV “Universiteti i Tetovës” vijon me sukses garën në ligën e parë të volejbollit të Maqedonisë. Pas tri xhirove të zhvilluara, KV “Universiteti i Tetovës” renditet i dyti në tabelë. Aktualisht në vend të parë qëndron klubi i volejbollit Liria – Zherovjan.

Në kuadër të javës së tretë (14. 11. 2018), KV “Universiteti i Tetovës” luajti me nënkampionin e Maqedonisë, “Vesna Probishtip”, të cilin e mposhti me rezultat të përgjithshëm 3 – 0 në sete. Me tre pikët e fituara studentët tetovarë japin sinjale se do të jenë konkurrentë kryesorë për të fituar këtë kampionat. Fitorja ndaj KV “Vesna Probishtip” është e dyta me radhë, pasi në kuadër të xhiros së dytë klubi i volejbollit “Universiteti i Tetovës” triumfoi ndaj KV “Dibra Volej”, ndërsa ka shënuar humbje në javën e

parë të kampionatit nga KV “Xhio Strumica”.

Në kudër të javës së katërt, KV “Universiteti i Tetovës”, do të përballet me KV “Studenti Shtip”. Nga klubi i volejbollit të Universitetit tonë shpresojnë se do të triumfojnë edhe kësaj jave dhe se do vazhdojnë të punojnë me më shumë, që deri në përmbyllje të kampionatit të arrijnë të shpallen kampionë në këtë ligë.





KLUBI I VOLEJBOLLIT PËR FEMRA “UNIVERSITETI I TETOVËS” SHËNOI FITORE NDAJ “UNIVERSITETI GOCE DELLCEV”

20.11.2018. Klubi i volejbollit për femra “Universiteti i Tetovës” edhe këtë vit vazhdon garën në ligën e parë të volejbollit për femra të Maqedonisë. Studentet e Universitetit të Tetovës këtë vit kanë zhvilluar pesë xhiro dhe renditen në vendin e tetë në tabelë. Menaxherja e këtij klubi, Doc. Dr. Laureta Abazi, thotë se këtë vit klubi kryesisht ka pësuar ndryshime të mëdha, pasi që ekipi përbëhet nga vajzat të cilat kanë dalë nga shkolla e volejbollit të Universitetit të Tetovës pasi që ka mungesa nga formacioni i sezonit të kaluar.

Ajo shprehet optimiste se në ndeshjet e ardhshme ekipi i saj do të arrijë që të përmirësohet edhe më shumë dhe t'i fitojë ndeshjet e radhës. “Këtë sezon e startuam me një skuadër krejtësisht të freskuar me lojtare të reja, të cilat vijnë nga shkolla jonë e volejbollit dhe normalisht se suksesi mungon, duke marrë parasysh se gati gjithë formacioni i parë i sezonit të kaluar mungon. Këtë sezon, nga 5 xhiro të luajtura, gjithsej kemi katër humbje dhe një fitore. Jemi shumë larg nga suksesi i vitit të kaluar dhe do

të jetë shumë problem të futemi në katër skuadrat në të mira që garojnë në playoff, por ne do të mundohemi të japim maksimumin që të arrijmë kualifikimin në playoff. Kampionati do të jetë i vështirë, por edhe shorti ishte i vështirë. Në xhirot e para u ndeshëm me skuadrën e Rabotniçkit-Shkup dhe Rabotniçki -Vajzat si dhe Nakovski Volej,skuadra të cilat u përforcuan në afatin kalimtar dhe janë pretendente për titullin kampion. Shpresoj që në xhirot e ardhshme ne do të paraqitemi shumë më mirë, pasi u rikthye edhe pasuesja e parë e skuadrës pas një lëndimi të gjatë dhe tash besoj se jemi më të kompletuar dhe do të mundohemi të ngjitemi në tabelë” – theksoi menaxherja Doc. Dr. Laureta Abazi. Klubi i volejbollit për femra “Universiteti i Tetovës” ndeshjen e ardhshme, në kuadër të javës së 6-të të kampionatit do ta luajë në Tetovë dhe përballë do të ketë klubin e volejbollit “Makedonija Maksi”. Nga KV “Universiteti i Tetovës” shpresojnë që edhe këtë ndeshje ta fitojnë.



KËNDI AUSTRIAK NË UT DISKUTOI MBI DALLIMET E GJERMANISTIKËS NË VENDET GJERMANOFONE


21.11.2018. Këndi austriak në Universitetin e Tetovës realizoi një punëtori të radhës me mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme. Gjermanisti nga Vjena, profesori Lukas Mayrhofer, para pjesëmarrësve prezantoi dallimet në gjuhën gjermane midis Gjermanisë, Austrisë dhe Zvicrës, por edhe vendeve të tjera, ku flitet gjuha gjermane si Belgjikë dhe Italinë veriore.

Sipas tij Austria nga fjalori i saj i ka larguar 24 fjalë gjermane dhe nuk i përdor më as edhe si dialekte dhe se po këto fjalë i ka zëvendësuar me fjalë të reja si pjesë të gjuhës standarde që e flasin austriakët.

Profesori Lukas Mayrhofer këtë e ilustroi edhe me disa shembuj konkret të disa fjalëve që në Austri, Zvicër dhe Gjermani përdoren ndryshe. Fjala “qese” në gjuhën shqipe, në Gjermani përdoret si “Tute” në Austri si “Sackerd” dhe në Zvicër si “Sackli”. Kurse fjala shqipe “kajsi” në Austri përdoret si “Marille” ndërsa në Gjermani si “Apricose” e kështu me radhë. Ai tha se në këtë punëtori është përcaktuar kjo temë me qëllim sensibilizimin e opinionit mbi dallimet e gjermanishtes mes Austrisë dhe Gjermanisë, pasi që njerëzit nga vendet e Ballkanit kanë shumë pak njohuri për këtë dukuri.

Mr. Sc. Lazim Ahmedi, përgjegjës i Këndit austriak në UT, tha se aktivitetet e kësaj natyre janë të rëndësishme për studentët dhe profesorët tanë, sepse na ofrojnë informacione të reja në lidhje me zhvillimet që ndodhin në shkencat filologjike.

Mësimdhënësit që morën pjesë në këtë punëtori u pajisën me certifikata nga Ministria e Arsimit të Republikës së Austrisë dhe janë evidentuar në Ministrinë e Arsimit të Maqedonisë.



21.11.2018. Universiteti i Tetovës, sot, përmes një akademie solemne e shënoi 110 -Vjetorin e Kongresit të Manastirit. Kjo datë paraqet një rën nga ngjarjet më të rëndësishme të popullit tonë, e njohur ndër shqiptarët si Dita e Alfabetit, ngjarje kjo në të cilën u bë unifikimi i alfabetit të gjuhës shqipe.

Prodekani për Shkencë i Fakultetit Filologjik, Prof. Dr. Izmit Durmishi, në fjalën e tij, tha se pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kongresi i Manastirit, është kuvendi që mbledhi atdhedashës nga vise të ndryshme shqiptare duke dhënë sinjalin e parë drejt pavarësisë kombëtare të popullit shqiptar. “Historia e alfabetit të gjuhës shqipe është mjaft e vjetër dhe e ndërlikuar, kur dihet që gjuha jonë, që nga dokumentet e para të saj që njohim e deri në Kongresin e Manastirit të vitit 1908 është shkruar në disa alfabetet. Kjo mënyrë e të shkruarit të shqipes, e vështirësonte shumë përhapjen e dijes dhe të kulturës shq-



NË UNIVERSITETIN E TETOVËS U SHËNUA DITA E ALFABETIT

iptare, prandaj njësimi i alfabetit ishte ndër detyrat e shenjta që morën përsipër ta realizojnë ideologët e rilindjes kombëtare shqiptare. Arritja e një marrëveshjeje për një alfabet të vetëm e të përbashkët për të gjithë shqiptarët, veprimtarëve shqiptarë ua ofronte mundësinë që ta ruanin dhe ta afirmnin më lehtë identitetin kombëtar, prandaj Kongresi i Manastirit u quajt edhe Kongresi i Alfabetit të gjuhës shqipe” – theksoi Prof. Dr. Izmit Durmishi. Historiani, Prof. Dr. Zeqirija Idrizi, tha se mundi dhe sakrificat që dhanë veprimtarët e gjuhës shqipe, për të ardhmen e kombit dhe gjuhës, asnjëherë nuk duhet harruar, sepse po nga këto germa janë shkruar shumë akte historike tejet të rëndësishme për popullin shqiptar gjithandej trojeve etnike. “Nuk mjafton përkujtimi i kësaj feste dhe festimi i saj në mënyrë simbolike duke shprehur urata të ndryshme, por duhet shfrytëzuar në maksimum ato shkronja të

shenjta, të cilat i përshtatën për ne të parët tanë, që ne të kemi bazën e shëndoshë për shkrime, studime, zbulime në lëmenj të ndryshëm dhe të praktikojmë shembullin e tyre se të bashkuar mund të arrijmë çdo gjë. Prandaj, ne duhet që këtij mudi t’ia japim hakun, ngase kushedi, një ditë ndoshta do të japim llogari për mosshfrytëzimin efikas të këtij burimi të pashtershëm – Alfabetit Shqip. Sepse, me alfabetin e Kongresit të Manastirit u shkrua dokumenti i Pavarësisë së Shqipërisë, me këtë alfabet u shkrua akti për themelimin e Universitetit të Tetovës, po me këtë alfabet u nënshkrua edhe Deklarata e Pavarësisë së Kosovës” - u shpreh, Prof. Dr. Zeqirija Idrizi. Akademia kushtuar Kongresit të Manastirit u bogua edhe me një program artistik të përgatitur nga studentët dhe profesorët e Fakultetit të Arteve dhe Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës.

REKTORI I UT-SË PROF. DR. VULLNET AMETI: KONGRESI I MANASTIRIT NJËRA NDËR NGJARJET MË TË MËDHA HISTORIKE DHE KULTURORE E SHEKULLIT TË KALUAR

Në emër të Universitetit të Tetovës dhe në emrin tim personal, kam kënaqësinë e veçantë t'Jua uroj 110 Vjetorin e Kongresit të Manastirit – Alfabetit të gjuhës shqipe.

Kongresi i Manastirit është padyshim njëra ndër ngjarjet më të mëdha historike dhe kulturore e shekullit të kaluar për mbarë popullin shqiptar, të cilit i janë referuar dhe i referohen vazhdimisht historianë, gjuhëtarë, etnologë, intelektualë shqiptarë dhe të huaj, duke synuar të hedhin dritë mbi rrethanat komplekse historike, politike dhe kulturore të periudhës së kaluar dhe të sjellin sa më shumë fakte për këtë ngjarje kaq të rëndësishme për mbarë popullin shqiptar.

Rruga, e cila çoi deri në mbajtjen e Kongresit të Manastirit nga data 14-22 Nëntor 1908, ishte e mundimshme dhe përplot vështirësi. Kongresi i Manastirit ishte një kuvend mbarëkombëtar, i cili në gjirin e vet tuboi figurat më eminente të Rilindjes tonë kombëtare si: Mithat Frashërin, Gjergj Fishtën, Luigj Gurakuqin, Gjergj Qiriazin, Nikollë Kaçorrin, Shahin Kolonjën, Fehim Zavalanin, Mati Logorecin, Ndre Mjedën, dhe shumë të tjerë, të cilët dhanë gjithçka për unifikimin e gjuhës shqipe dhe avancimin e çështjes kombëtare.

Ne, sot, përulemi me nderimin më të madh për të gjithë aktorët e kësaj ngjarjeje kaq të madhe historike dhe me dinjitet e nderojmë ditën e Alfabetit shqip në përvjetorin e tij të 110 me radhë.

Gëzuar përvjetorin e shkronjave shqipe, gëzuar festat e nëntorit....

Prof. Dr. Vullnet Ameti
Rektor i Universitetit të Tetovës



PËR KRYEHEROIN E KOMBIT GJER

21.11.2018. Në rektoratin e Universitetit të Tetovës u hap ekspozita e 50 artistëve shqiptarë të udhëhequr nga Prof. Dr. Miftar Memeti. Ai përmes kësaj ekspozite e solli më ndryshe figurativisht dhe stilistikisht figurën e heroit tonë legjendar, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, duke marrë si shkas 550-vjetorin e vdekjes së heroit tonë kombëtar.

Dekani i Fakultetit të Arteve në Universitetin e Tetovës, Prof. Dr. Nafi Jashari, në hapjen e kësaj ekspozite, në të cilën ishte i pranishëm edhe Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, bashkë me dekanë, senatorë profesorë, studentë dhe mysafirë të tjerë, vlerësoi se me këtë ekspozitë, profesori Miftar Memeti edhe një herë pa asnjë hezitim e sprovoi veten e tij me një projekt kompleks artistik, i cili ka shfrytëzuar qoftë si përmbajtje tematike, por edhe si ikonografi vizuale mega figurën historike kombëtare të kryeheroit tonë kombëtar, Gjergj Kas-



EKSPozITË

ERGJ KASTRIOTIN – SKËNDERBEU

triotit Skënderbeut.

Profesoresha Dr. Jëlldëz Asani tha se kjo vepër ka qenë një sfidë, jo vetëm për Miftar Memetin, i njohur për veprat e tij kapitale “Nënë Tereza” dhe “100 Vjetori i Pavarësisë”, por ka qenë një sfidë tepër e vështirë edhe për 50 artistët e rinj pjesëmarrës në finalizimin e portretit gjigand të Skënderbeut. “Tërësia e panelit me kombinimin e ngjyrave të akrilikut në pëlhurë, i përbërë nga 50 copëza, përmban 32 simbole heraldike të modifikuara në mënyra të ndryshme nga ana e artistëve, 5 transformime të figurës së shqiponjës në pamje folklorike, 6 versione të figurës së Skënderbeut, një imazh nga sfragjistika dhe në fund për ta finalizuar me shënimin e një vargu të himnit kombëtar, të lidhur sipas sistemit të mozaikut, përvijon portretin gjigand të Skënderbeut. Portreti shoqërohet edhe me simbole tjera. Vepra e prekshme nga afër e gërshetuar me 50 pik-

turat si copëza të një mozaiku ekzistencial janë me kolorit të fisnikëruar me paletën e gjerë të ngjyrave, që vepron në mënyrë simbolike figurative” – tha Dr. Jëlldëz Asani.

Autori i kësaj ekspozite, piktori Prof. Dr. Miftar Memeti i falënderoi të gjithë piktorët, të cilët kanë qenë pjesë e këtij mozaiku. “Kjo punë nuk është vetëm imja, unë jam koordinator i këtyre punëve. Këto piktura i kanë pikturuar studentët që kanë diplomuar para disa viteve, piktorë, skulptorë, grafistë. Imazhi i këtij mozaiku është Skënderbeu dhe shqiponja. Është ndërtuar nga temat, motivet, siç janë stemat e llojllojshme të kombit tonë, portretet e vetë Skënderbeut, transformimi i shqiponjës nga folklori. Të gjitha 50 motivet kur bashkohen së bashku japin imazhin e Skënderbeut” – u shpreh Prof. Dr. Miftar Memeti.

Piktori Miftar Memeti me këtë vepër unike arriti ta lartësojë artin e tij në majën e një lirie kreative, me një zotërim të përvojave si asnjë artist tjetër bashkëkohor. Vepra e profesor Miftar Memetit nuk është vetëm pjesë e krijimtarisë së tij personale, por një zotërim i jashtëzakonshëm i eklektizmit, të një perfeksioni teknik dhe me dëshirë të papërmbajtur eksperimentimi, të gjitha këto të shoqëruara me vullnet dhe energji për të përdorur më shumë stile përnjëherësh.



UNIVERSITETI I TETOVËS MORI PJESË NË FORUMIN EVROPIAN TË SIGURIMIT TË CILËSISË

23.11.2018. Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, bashkë me përfaqësuesit e Zyrës për Menaxhimin e Cilësisë dhe Evaluim të Universitetit tonë morën pjesë në Forumin XIII Evropian të Sigurimit të Cilësisë, i cili u organizua nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane.

Forum i zhvilloi punimet prej 15 deri më 17 nëntor 2018, në Vjenë të Austrisë. Tema kryesore që trajtoi ky forum ishte “Zgjerimi i fushës së sigurimit të cilësisë” dhe nëpërmjet sesioneve paralele të prezantimeve dhe punëtorive, deri te përfaqësuesit e universiteteve të ndryshme evropiane pjesëmarrës në këtë eveniment u prezantuan zhvillimet aktuale të sigurimit të cilësisë.

Fokusi i Forumit XIII u përqëndrua në mënyrën se si institucionet dhe agjencitë e sigurimit të cilësisë mund të ndërtojnë sisteme që përfshijnë një gamë të gjerë të aktiviteteve, përfshirë mësimdhënien dhe mësim – nxënien, hulumtimet, qeverisjen dhe shërbimin që i jepet shoqërisë, informata këto të cilët do të shërbejnë në rritjen e cilësisë së arsimit në të gjitha universitetet evropiane.

Ky forum, mes tjerash ofroi një platformë diskutimi, zhvillimi profesional dhe shkëmbimi të përvojave për sigurim të cilësisë mes drejtuesve të universiteteve, udhëheqësve për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, si dhe aktorëve të tjerë që punojnë në këtë sektor me rëndësi.

UNIVERSITETI I TETOVËS NDAU BURSA PËR STUDENTËT E DALLUAR NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE

27.11.2018. Në Universitetin e Tetovës, sot u ndanë 22 bursa për librim nga participimi për ekslentët e studimeve të ciklit të dytë. Fillimisht, studentët u pritën në një takim rasti nga Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti dhe bashkëpunëtorët e tij. Gjatë këtij takimi, Rektori Prof. Dr. Vullnet Ameti i uroi studentët për suksesin e tyre që kanë arritur gjatë studimeve dhe i inkurajoi ata që edhe pas përfundimit të ciklit të dytë të vazhdojnë me studimet e ciklit të tretë, ato të doktoraturës, sepse vetëm në këtë mënyrë shoqëria jonë do të arrijë të ketë kadro profesionale, të cilët të gjitha njohuritë, dijet e fituara si dhe përvojat e tyre do t'i vënë gjithmonë në shërbim të shoqërisë.

Prorektori për Arsim i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Reshat Qahili tha se ky është viti i pestë me radhë që Universiteti i Tetovës ndan bursa për studentët e dalluar. Me vendim të Senatit nga viti 2013, që do të thotë, tani më pesë vjet, Universiteti i Tetovës për studentët ekslentë çdo vit ndan bursa. Kështu që, edhe këtë vit është bërë një përzgjedhje e studentëve më të mirë, ku si kriter për ta fituar bursën ka qenë sukcesi i studimeve deridiplomike, si dhe sukcesi i vitit të parë në studimet master, ku i kemi studimet dyvjeçare. Ndër të tjera, kriteri ka qenë që studentit të ketë sukses mesatar prej 9.5, por krahas këtij sukcesi që studentit është dashur të ketë gjatë studimeve, gjithashtu të gjithë ata studentë që kanë konkuruar i janë nënshtruar një interviste, që do të thotë se, numri i studentëve të cilët kanë konkuruar për bursa ka qenë më i madh në krahasim me numrin e këtyre studentëve që sot janë fitues të bursës, por kriteret, bisedat dhe intervista që është zhvilluar, kanë qenë po ashtu një mënyrë për t'i dalluar studentët të cilët kanë qenë më të mirë” – theksoi Prof.



Dr. Reshat Qahili.

Studentëve ekslentë bursat u ndau Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti. Pas marrjes së bursave studentët u ndanë tepër të kënaqur me vlerësimin që Universiteti u bën atyre. „Për mua personalisht kjo është përvoja ime e pestë, domethënë për të pestin vit me radhë shpërblehem nga Universiteti dhe natyrisht nuk më mbetet gjë tjetër përveç se ta falënderoj Universitetin në përgjithësi dhe Rektorin në veçanti“ – u shpreh Beiza Selimi, studente në Fakultetin Juridik.

Studenti i Fakultetit të Shkencave të Zbatuara, Rushan Hoda, e çmoi lartë angazhimin e drejtuesve të Universitetit për kujdesin që tregojnë ndaj studentëve. „Ne jemi shumë mirënjohës për këto bursa të cilat i ndan Universiteti i Tetovës, jemi falënderues ndaj Rektorit, stafit akademik dhe gjithë Universitetit. Kjo tregon se puna jonë po vlerësohet dhe jemi shumë mirënjohës për bursat të cilat i pranuan“, deklaroi Rushan Hoda.

Studentja e Fakultetit Filologjik, Kaltrina Sadiki tha se Universiteti i Tetovës gjithmonë i ka trajtuar në mënyrë të barabartë studentët, duke vlerësuar mundin dhe sakrificën tonë si studenë. „Kjo është një mundësi shumë e mirë që Universiteti ynë ua jep studentëve, që në mënyrë të barabartë dhe të njëjtë me të gjithë studentët e tjerë t'i vazhdojnë studimet, me mundësinë që të mos i paguajnë semestrat. I falënderoj të gjithë ata që janë përkujdesur për t'i inkurajuar studentët në këtë formë“, shtoi mes tjerash Kaltrinë Sadiki.

Universiteti i Tetovës muajin e kaluar gjithashtu ndau 90 bursa për studentët e ciklit të parë, në studimet themelore.



REKTORI I UT-SË PROF. DR. VULLNET AMETI: 28 NËNTO- RI – DITA E REALIZIMIT TË NJË ËNDRRE SHEKULLORE

28.11.2018. Kam nderin e veçantë që në emrin tim dhe në emër të stafit drejtues të Universitetit të Tetovës, t'juaj uroj të gjithëve festën e kombit, 28 Nëntorin – Ditën e Flamurit dhe Pavarësisë së Shqipërisë.

28 Nëntori është dita e realizimit të një ëndrre shumë shekullore, realizim i projektit të madh politik, kulturor dhe shpirtëror. Ky projekt kombëtar pati edhe pararendësit tij, në krye me Heroin tonë kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeun, i cili më 1443, në kryeqytetin e vjetër të Shqipërisë, në Krujë e ngriti flamurin e kuq me shkabën e zezë dykrenore.

Të vetëdijshëm për këtë Mot të madh dhe testamentin e vet evropian, etërit themelues të Shtetit Shqiptar e zgjodhën pikërisht 28 Nëntorin, si Nëntor të Dytë të Rilindjes Shqiptare. Në Vlorë, ditën kur plaku i flamurit, Ismail Qemali e shpalli vendimin e shenjtë, ishin bashkë të gjithë rilindësit shqiptarë, të gjallë e të vdekur, sepse në atë akt u mishëruan bashkë shpirti dhe fryma atdhetare shqiptare.

Vendimi historik i 28 Nëntorit të vitit 1912, i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ishte një kurorëzim i luftërave dhe përpjekjeve të plejadave të tëra të atdhetarëve dhe intelektualëve që shkëlqyen gjatë gjithë periudhës së Rilindjes Kombëtare.

Me urimet e mia më të ngrohta, me dëshirën që kombi ynë të ketë një të ardhme të begatë, të sigurtë dhe të ndritur, Ju uroj të gjithëve, gëzuar 28 Nëntorin- Ditën e Flamurit dhe Pavarësisë!

Prof. Dr. Vullnet Ameti
Rektor i Universitetit të Tetovës



UNIVERSITETI I TETOVËS DHE UNIVERSITETI I ILINOISIT VERIOR E PROMOVUAN RI STUDIMOR PËR ADMINISTRIMIN NË CIKLIN

29.11.2018. Universiteti i Tetovës dhe Universiteti i Ilinoisit Verior, në mënyrë solemne promovuan hapjen e programit të përbashkët studimor për Administrim biznesi, i akredituar nga Këshilli për Akreditim i Maqedonisë. Promovimi i këtij programi studimor u bë në prani të rektorit të Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Maqedoni, z. Jess Baily, ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi, si dhe të përfaqësuesve të tjerë nga të dy universitetet.

Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti theksoi se programi i ri studimor për Admin-



UNIVERSITETI I TETOVËS DHE UNIVERSITETI I TETOVËS PROMOVUAN PROGRAMIN PËR ADMINISTRIM BIZNESI NË DIJEN E DYTË TË STUDIMEVE

Administrim biznesi, në studimet e ciklit të dytë, i akredituar nga Këshilli për akreditim dhe evaluim të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë, është i vetmi i këtij lloji, jo vetëm në rajonin e Evropës Juglindore, por edhe më gjerë, dhe ka për qëllim që studentët të pajisen me njohuri të thelluara në lëmin përkatës dhe i parapërgatit ata të bëhen menaxherë të suksesshëm, për të drejtuar sipërmarrje, kompani të ndryshme që operojnë në tregun global të punës. “Studentët që do të arrijnë me sukses t’i përfundojnë studimet në këtë program të ri do të pajisen me diplomë të përbashkët, e cila do të bart em-

blemat dhe vulat e të dy universiteteve dhe do të fitojnë thirrjen magjistër në shkencat ekonomike nga lëmi i administrimit të biznesit. Promovimi, apo hapja e këtij programi studimor, së bashku me njërin nga universitetet më prestigjioze amerikane është mirënjohje për punën dhe angazhimin e vazhdueshëm të universitetit tonë, por njëkohësisht paraqet një sfidë dhe përgjegjësi të madhe për institucionin tonë, për faktin se për partneritetin e këtij lloji, nga shumë universitete evropiane është përzgjedhur pikërisht Universiteti i Tetovës. Me këtë përparësi edhe njëherë e dëshmojmë se Universiteti i Tetovës po përfshihet në skenën akademike ndërkombëtare, duke u shndërruar në një partner serioz i shumë projekteve arsimore dhe shkencore. Në cilësinë e rektorit, partnerët tanë amerikanë i sigurojnë se do të punojmë përshtur që programi i Administrim biznesit të ketë sukses, të tërheqë vëmendjen e të rinjve tanë dhe në periudhën e ardhshme pesëvjeçare, aq sa është i akredituar, përmes kuadrove cilësore ta ndihmojmë komunitetin e biznesit, të kontribuojmë në eliminimin e barrierave që e sfidojnë këtë sektor të rëndësishëm për shoqërinë”, tha Rektori Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Doc. Dr. Arbër Ademi tha se Universiteti i Tetovës, pas një historie me shumë peripeci mbi 20 vjeçare, sot po e promovon një program studimor me të cilin dëshmon se është i përkushtuar si institucion i arsimit të lartë, për të dhënë kontribut të çmueshëm në ngritjen e cilësisë në arsim në përgjithësi dhe në arsimin e lartë në veçanti, në Republikën e Maqedonisë. “Sigurisht se ky universitet ka një staf tejet të mirë menaxhues, ka një staf tejet të mirë profesional, hulumtues – shkencor, një staf administrativ të shkëlqyeshëm, të cilët u përgjigjen në mënyrë të shkëlqyeshme të gjitha sfidave me të cilat përballlet çdo institucion i arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë. Sigurisht se ky institucion ekziston, funksionon dhe



zhvillon veprimtarinë e vet për shkak të studentëve dhe studentët, pra qytetarët e këtij vendi janë përcaktuar për këtë universitet, duke e pasur parasysh cilësinë që e ofron, ndërsa sot jam më se i kënaqur se studentëve të këtij universiteti, por jo vetëm të këtij universiteti, studentëve të universiteteve publike e private në Republikën e Maqedonisë po ju ofrohet edhe një opsion, ai është programi i ri në ciklin e dytë të studimeve së bashku me partnerët tanë amerikanë, së bashku me një nga universitetet prestigjioz në nivel botëror, duke ofruar këtë program, në fakt ofrohet një program i cili ndikon edhe në ngritjen e cilësisë, pro ndikon edhe në krijimin e kuadrove që do t'u përgjigjen nevojave dhe kërkesave të tregut të punës”, deklaroi Doc. Dr. Arbër Ademi, ministër i Arsimit dhe Shkencës i Republikës së Maqedonisë. Ndërsa ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Maqedoni, z. Jess Baily tha se Universiteti i Tetovës dhe Universiteti i Illinoisit Verior nga Çikago e SHBA-ve ofrojnë mundësinë e parë në Maqedoni që studentët të marrin një diplomë masteri nga një universitet amerikan, duke i ndjekur studimet në Maqedoni. “Është nderi im të jem këtu që të bëjmë promovimin e këtij programi në Universitetin e Tetovës. Arsimi dhe biznesi janë dy mënyrat më të mira për të ndërtuar ura në mes shteteve, pra me këtë program të bërëbashkët do t'i bëjmë të dyja, do të edukojmë gjeneratat e reja të Maqedonisë si liderë të biznesit dhe të ju sigurojmë atyre një perspektivë amerikane, praktikë si dhe përvojë amerikane. Pra, urime për Universitetin e Tetovës dhe Universitetin e Illinoisit Verior për këtë arritje. Ky program është mundësia e parë në Maqedoni që të arrihet një diplomë masteri nga një universitet amerikan duke studiuar këtu në Maqedoni. Pra, ky është një hap përpara për t'i afruar këto dy shtete. Në fakt, ky program i ri është rezultat i bashkpunimit mes dy universiteteve, në nivel të stafit akademik, të studentëve, për të vizituar dhe për të

bashkëpunuar në lëmi të ndryshme, siç kemi pasur edhe konferenca të shumta dhe tash është radha në lëminë e biznesit”, theksoi ambasadori i SHBA-ve në Shkup, z. Jess Baily.

Dekani i Fakultetit të Administrim biznesit të Universitetit të Illinoisit Verior, Prof. Dr. Raxhagopalan Ballazhi tha se me këtë program studimor dy institucionet tona në veprimtarinë e tyre shënojnë një moment të rëndësishëm, duke dëshmuar se jemi të përkushtuar të bashkëpunojnë për avancimin dhe prosperitetin e qytetarëve të vendeve tona. “Dua të falënderoj ambasadorin Jess Baily, rektorin e Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, për mbështetjen që na japin në këtë partneritet. Universiteti i Tetovës dhe udhëheqësia e këtij universiteti, me rektor Vullnet Ametin dhe profesor Arbër Çelikun, me këto hapa që po bëjnë, tregojnë se janë të përkushtuar në ndërtimin e të ardhmes së Maqedonisë. Vizioni i tyre dhe angazhimi për të promovuar paqen dhe prosperitetin e arsimit do të ndihmojë të gjitha gjeneratat e ardhshme. Universiteti i Tetovës dhe lidhshipi i saj janë partnerët tonë strategjikë në Ballkan, dhe ne në Universitetin e Illinoisit Verior besojmë se me Universiteitn tuaj do të krijojmë edhe platforma të tjera të përbashkëta që do të kenë ndikim në zhvillimin e shoqërisë, me fokus për të zgjedhur problemet politike në Ballkan, duke krijuar koekzistencë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme në rajon nëpërmjet Qendrës për Paqe dhe Komunikim Transkulturore. Ne, sot jemi këtu për të inicuar një program të përbashkët studimor të ciklit të dytë dhe ky do të jetë një sukses fenomenal për të dy institucionet tona. Universiteti i Tetovës dhe Universiteti i Illinoisit Verior ndajnë të njëjtat vlera dhe të njëjtin nivel të rëndësisë për mësimnxënien në përmirësim të cilësisë”, u shpreh Prof. Dr. Raxhagopalan Ballazhi.

Në këtë ngjarje, Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, në emër të tij dhe të Universitetit, të stafit akademik dhe të studentëve, i shprehi mirënjohje të thellë Qeverisë së SHBA-ve dhe Ambasadës së tyre në Shkup, që përmes angazhimit të profesorëve eminentë në kuadër të programit Fullbright, çdo vit akademik kontribuojnë për mbarëvajtjen e procesit edukativ – arsimor në Universitetin tonë. Po ashtu, ai falënderoi edhe drejtuesit e Universitetit të Illinoisit Verior për gatishmërinë e tyre për bashkëpunuar me Universitetin e Tetovës në projekte të ndryshme arsimore.



PROF. DR. RAXHAGOPALAN BALLAZHI NGA SHBA LIGJËROI NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

30.11.2018. Dekani i Fakultetit të Administrim – Biznesit nga Universiteti i Illinoisit Verior të Çikagos së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prof. Dr. Raxhagopalan Ballazhi, para studentëve dhe profesorëve të Universitetit të Tetovës, më 29 nëntor 2018, mbajti një ligjëratë profesionale, me temë: „Transformimet dixhitale“.

Ai, fillimisht në pika të shkurtëra e konceptoi modelin amerikan të prezantimit, duke e bërë ligjëratën e tij sa më atraktive për studentët. Sipas tij, transformimet dixhitale në të gjithë botën kanë lëvizur me një intensitet shumë të shpejtë, duke ofruar mundësi të shumëta dhe lehtësime të mëdha në të gjitha poret e jetës dhe se dixhitalizimi është shndërruar në një nxitës të madh të ndryshimit dhe të përparimit të shoqërisë. Siç tha ai, përmes zhvillimit teknologjik, sot njerëzit thuajse tërësisht po kthehen në dixhital, nisur nga fakti se dixhitalizimi nga dita në ditë po shënon rritje shumë të madhe dhe se inovacionet në teknologjinë dixhitale nuk kanë të ndalur. Ai më

tej shtoi se e ardhmja i takon dixhitalizimit, pasi që përmes kësaj teknologjie njerëzit do ta kenë më të lehtë që t’u prijnë proceseve dhe të përparojnë dukshëm në punën e tyre.

Prof. Dr. Raxhagopalan Ballazhi i inkurajoi studentët që sa më shumë të kenë qasje në këto teknologji dhe njehërit u bëri thirrje që të jenë pjesë e proceseve të ndryshimeve të mëdha që ndodhin në botë përmes zhvillimeve teknologjike. Ai apeloi deri te studentët tanë që në të ardhmen ta vizitojnë Universitetin e Illinoisit Verior dhe të jenë pjesë e këtij universiteti duke studiuar në ndonjë program studimor.

Po ashtu, ai para studentëve tha se Universiteti i Illinoisit Verior ka krijuar partneritet strategjik në Ballkan me Universitetin e Tetovës dhe tanimë e menaxhojnë edhe programin e përbashkët studimor për Administrim të biznesit, në ciklin e dytë të studimeve, e që është një mundësi shumë e mirë për secilin që dëshiron t’i vazhdojë studimet në këtë fushë.

NË UNIVERSITETIN E TETOVËS U MBAJT TRIBUNË ME TEMË "DROGA DHE TË RINJTË"

3.12.2018. Fakulteti Juridik dhe Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim dhe Avancim të Jetës Publike organizuan një tribunë me temë "Droga dhe të rinjtë".

Panelistët e kësaj tribune folën për narkomaninë si fenomen, masat preventive si dhe pasojat shoqërore të saj mes të cilave është edhe sëmundja AIDS ose HIV, por edhe sëmundjet tjera infektive, të cilat i shoqërojnë personat të cilët abuzojnë me substanca narkotike.

Dekani i Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha, potencoi faktin se sot narkomania kudo në botë ka përmasa galopante dhe ne si shoqëri nuk mund të pretendojmë se jemi të anashkaluar nga ky fenomen. Me të drejtë narkomania njihet edhe si epidemia e bardhë. "Ky problem mund të prekë çdo familje, çdo institucion edukativ-arsimor, prandaj përpjekjet për minimizimin apo parandalimin e këtij fenomeni bazohen në dy shtylla kryesore. Njëra shtyllë është ajo edukative – arsimore, ku bëjnë pjesë familja dhe shkollat dhe tjetra është ajo penalizuese, në të cilën bëjnë pjesë organet e rendit dhe gjyqësori", tha Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha.

Ndërsa dekanı i Fakultetit Juridik, Prof. Dr. Qebir Avziu, u shpreh se shoqëria jonë është pak e sensibilizuar për këtë çështje, në krahasim me numrin



e përdoruesve të drogës, që është jashtëzakonisht i madh në Komunën e Tetovës dhe të Gostivarit. "Qëllimi i kësaj tribune të sotme që e organizuam ishte që studentët dhe nxënësit e shkollave të mesme që sot ishin të pranishëm të njoftohen me pasojat e drogës në aspektin shëndetësor dhe atë ligjor. Statistikat e fundit tregojnë të dhëna brengosëse për shoqërinë tonë për sa i përket përdorimit të drogës", theksoi Prof. Dr. Qebir Avziu.

Ndërsa koordinatori i Qendrës për Zhvillim dhe Avancim të Jetës Publike, Borislav Pavlovski, theksoi se pjesë e programeve të shërbimit që ofron kjo qendër është edhe programi për personat të cilët konsumojnë drogë. Ai tha se deri më tani numri i personave të cilët janë paraqitur për të marrë shërbime në këtë qendër është jashtëzakonisht i lartë, rreth 493 persona konsumues të drogës, por nuk do të thotë që ky është numri real i tyre.

Fakultetet e lartpërmendura në vazhdimësi kanë organizuar aktivitete të kësaj natyre dhe përmes konferencave shkencore, tribunave të këtilla, kontribuojnë në luftimin, parandalimin e dukurive që e rrezikojnë shëndetin, mirëqenien dhe të ardhmen e të rinjve.



UNIVERSITETI I TETOVËS E SHËNOI DITËN NDËRKOMBËTARE TË PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

3.12.2018. Me moton, “Duam, dëshirojmë, lutemi dhe punojmë për integrimin e plotë të personave me nevoja të veçanta”, Universiteti i Tetovës e shënoi 3 dhjetorin, Ditën ndërkombëtare të personave me nevoja të veçanta. Profesorët dhe studentët e katedrës së Edukimit Special dhe Rehabilitimit të Fakultetit Pedagogjik të UT-së, në bashkëpunim me nxënësit dhe arsimtarët e paraleleve me nevoja të veçanta të shkollës fillore “Liria” në Tetovë, këtë ditë e shënuan me disa aktivitete, me qëllim sensibilizimin e popullatës, që edhe kjo pjesë e shoqërisë të integrohet sa më shumë dhe të ndjehet e barabartë. Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, bëri thirrje deri te të gjithë profesorët e katedrës së Edukimit Special dhe Rehabilitimit që në të ardhmen të krijojnë platforma dhe projekte të ndryshme me qëllim që sa më shumë t’u kushtohet rëndësi këtyre personave. “Në emër të Universitetit të Tetovës dëshiroj t’ju përgëzoj për këtë organizim që keni bërë sot. Universiteti i Tetovës vazhdimisht do të jetë në përkrahje të aktiviteteve të këtilla dhe për këtë ju premtoj. Ashtu siç e keni organizuar këtë



eveniment ju ftoj dhe ju inkurajoj që të vazhdoni me aktivitete të këtilla, po ashtu profesorëve dhe studentëve të Katedrës së Edukimit Special dhe Rehabilitimit të Universitetit tonë do ju kisha propozuar që të ndërtojnë dhe të ngrenë projekte të ndryshme rreth ndihmesës që mund t’i japin këtij programi studimor” – tha Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Dekani i Fakultetit Pedagogjik i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Fadbi Osmani, u shpreh se kjo



ngjarje, përveç tjerash, ka rëndësi për informimin e opinionit për një qasje më gjithëpërfshirëse në identifikimin dhe trajtimin e personave me nevoja të veçanta, kur kemi parasysh faktin se numri i tyre sa vjen e rritet me fëmijët autikë dhe hiperaktivë. Prodekani për Arsim i Fakultetit Pedagogjik i Universitetit tonë, Prof. Dr. Bunjamin Memedi në fjalën e tij para auditorit tha se sot është shumë e rëndësishme që secili të jetë i vetëdijshëm se personat me aftësi të kufizuara janë anëtarë të barabartë të shoqërisë dhe se mund të kontribuojnë në përpjekjet e tyre më të mira dhe të pasurojnë jetën politike, sociale, ekonomike dhe kulturore.

Në këtë manifestim para profesorëve, studentëve dhe një numri të madh të prindërve, fëmijët me nevoja të veçanta shfaqën disa këngë dhe poezi me ndihmën e studentëve të Katedrës së Edukimit Special dhe Rehabilitimit. Nxënësit e paraleleve me nevoja të veçanta të shkollës fillore “Liria” në Tetovë, Rektorit të Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ametit, i ndanë një dhuratë me simbol Lule Diellin të punuar nga vetë ata.

Po ashtu për nder të 3 dhjetorit, Ditës ndërkombëtare të personave me nevoja të veçanta u realizuan edhe disa aktivitete sportive të organizuara nga Klubi i Atletikës “Studenti” i Universitetit të Tetovës.



KLUBI I VOLEJBOLLIT PËR FEMRA I TETOVËS” SHËNOI FITORËSI

4.12.2018. Klubi i volejbollit për femra i Universitetit të Tetovës në kuadër të xhiros së tetë (30. 11. 2018), të kampionatit të volejbollit për femra në ligën e parë të Maqedonisë, luajti si mysafir kundër klubit të volejbollit “Uskana” nga Kërçova.

Ndeshja përfundoi në favor të studenteve të Universitetit të Tetovës, të cilat shënuar fitore me rezultat të përgjithshëm 1: 3 në sete. Me këtë fitore KV “Universiteti i Tetovës” arrin kuotën e 10 pikëve dhe plasohet në vendin e gjashtë në renditjen tabelare. Menaxherja e klubit, Doc. Dr. Laureta Abazi, tha se edhe përkundër vështirësive me të cilat u ballafaquan në fillim të kampionatit si pasojë e mungesës së lojtareve, ekipi dalëngadalë po rikthehet në formë dhe se shpresojnë që të shënojnë fitore në tri ndeshjet e ardhshme, dy prej të cilave do t’i zhvillojnë në terren vendas dhe vetëm një në terren mysafir.



ËR FEMRA “UNIVERSITETI TORE NË TERREN MYSAFIR NDAJ KV “USKANA”

“Shpresojmë që të shënojmë fitore dhe po e realizuam planin atëherë mendoj se ngelim të katërtat në kampionatin vjeshtor. Është i patjetërsueshëm përforsimi i skuadrës pasi në mesin tonë mungojnë lojtare më me përvojë, të cilat do të na ndihmojnë që në sezonin pranveror të përsëritim rezultatin e vitit të kaluar. Ndeshja në Kërçovë ishte derbi mes dy ekipeve të vetme shqiptare në ligë. Edhe pse ne udhëtonim si favorit nuk e patëm të lehtë këtë ndeshje. Ne e startuam ndeshjen mjaft mirë, prandaj gjithçka funksionoi ashtu si duhet, duke shënuar fitore” – tha menaxherja Doc. Dr. Laureta Abazi.


Ndeshjen e ardhshme të xhiros së nëntë të kampionatit vendor të volejbollit për femra, KV “Universiteti i Tetovës” do ta luajë në terren vendas, të shtunën, më 8 dhjetor 2018, kundër KV “Viktori Volej – Strumicë”.

DEKANI I UT-SË PROF. DR. FATMIR SULEJMANI SHPALLET “KRENARIA E MIRDITËS”

4.12.2018. Më 2 dhjetor 2018, në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë, Shoqëria Kulturore Artistike – “Mirdita”, organizoi përrurimin e numrave të fundit të organit të saj – revistës kulturore “Mirdita”, zgjodhi fituesit e çmimit “Yjet e Arbrit” (fituesi i parë i të cilit, më 2015 ishte Prof. Dr. Fatmir Sulejmani) dhe ndau disa çmime e mirënjohje për zërat e spikatur të fushës së kulturës dhe të letërsisë shqiptare.

Në këtë ngjarje kulturore, ku ishin prezentë personalitete të shquara të fushave të ndryshme, për shkrimet e botuara ndër vite në revistën kulturore “MIRDITA” dhe për kontributin e dhënë për zhvillimin e kulturës kombëtare, SHKA – “Mirdita”, dekanit të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Fatmir Sulejmanit, ia akordoi titullin e lartë “Krenaria e Mirditës”, i cili sivjet u nda për herë të parë.

Krahas Prof. Dr. Fatmir Sulejmanit, ky titull iu nda edhe akademikut Mark Tirta, gjeneralit Ded Prenga dhe gazetarit Frrok Çupi.





KLUBI I VOLEJBOLLIT PËR MESHKUJ “UNIVERSITETI I TETOVËS” E FITOI BINDSHËM KV “VARDARI”

4.12.2018. Në kuadër të xhiros së gjashtë në kampionatin vendor të volejbollit për meshkuj, më 1 dhjetor 2018, KV “Universiteti i Tetovës” vazhdon të shënojë fitore. Në ndeshjen e zhvilluar në Tetovë përballë Vardarit, studentët tetovarë arritën të shënojnë fitore me rezultat 3 – 1 në sete.

Pas humbjes së setit të parë nga Vardari, djemtë e KV “Universiteti i Tetovës” arritën që të rikthehen fuqishëm në tri setet e radhës, duke shënuar fitoren e pestë në kampionat dhe deri më tani kanë pësuar vetëm një humbje nga kryesuesi i tabelës Strumica, që ka gjashtë fitore.

Nga KV “Universiteti i Tetovës” shprehen të kënaqur me rezultatet të cilat deri më tani i ka arritur klubi dhe presin që të vazhdojnë me këtë paraqitje edhe në ndeshjet e ardhshme. Kapiteni i klubit, Hamza Veseli, u shpreh tepër i kënaqur me bashkëlojtarët e tij dhe shpreson se deri në përfundim të kampionatit të arrijnë të shpallen fitues të kampionatit të volejbollit vendor.

KV “Universiteti i Tetovës” aktualisht renditet në vendin e dytë në tabelë me 15 pikë, tri më pak se kryesuesi i tabelës KV “Strumica”. Në ndeshjen e ardhshme në kuadër të xhiros së shtatë, KV “Universiteti i Tetovës” do të luajë kundër KV “Velesi”.



AMBASADORI I BE-SË E VLERËSOI LART PËRPARIMIN

5.10.2018. Ambasadori i Bashkimit Evropian në Maqedoni, ekselencia e tij, z. Samuel Zhbogar, më 4 dhjetor 2018, e vizitoi Universitetin e Tetovës. Gjatë qëndrimit të tij në Universitetin tonë, i fillimisht zhvilloi takim me Rektorin, Prof. Dr. Vullnet Ameti, dhe bashkëpunëtorët e tij.

Pas këtij takimi, ambasadori i Bashkimit Evropian, z. Samuel Zhbogar, mori pjesë në një debat të hapur me studentët me temë “Vizioni i të rinjve për ardhmërinë në BE”.

Ai tha se po e ristartojnë fushatën, të cilën delegacioni i Bashkimit Evropian e realizon me qytetarët në shtator për një të ardhme të përbashkët në Bashkimin Evropian, duke filluar nga Universiteti i Tetovës dhe se në kuadër të kësaj fushate në fokus kryesor janë vetë studentët dhe të rinjtë në përgjithësi. “Ne



Z. SAMUEL ZHBOGAR

N E UNIVERSITETIT TË TETOVËS

me delegacionin e Bashkimit Evropian menduam gjatë dhe kemi vendosur që të dalim më shumë jashtë Shkupit, me qëllim që të lidhemi më mirë me qytetarët e vendit, t'i dëgjojmë mendimet e tyre. Sikurse e kemi të njohur, në shtator delegacioni i Bashkimit Evropian organizon fushatë me moton: 'Ta imagjinojmë të ardhmen së bashku'. Në kuadër të kësaj fushate kemi realizuar shumë takime me qytetarë nëpër shumë komuna të vendit tuaj dhe në një mënyrë vizita e sotme në Universitetin e Tetovës e ristarton dhe paraqet një rifillim të kësaj fushate. Mirëpo kësaj radhe do të fokusohemi te vetë studentët, që të bisedojmë dhe të dëgjojmë mendimet e tyre, komentet dhe vizionet që ata kanë për Bashkimin Evropian. Po ashtu do të dëgjojmë edhe këshillat që ata kanë dhe unë si ambasador i Bashkimit Evropian do të jem gjithmonë në dispozicion

të studentëve dhe vetë qytetarëve, që të shpjegoj se cilat janë qëndrimet e Bashkimit Evropian për vendin tuaj" – u shpreh z. Samuel Zhbogar, ambasadori i BE-së në vend.

Ai po ashtu u shpreh se momentalisht të rinjtë nuk shohin kurrfarë ardhmërie në vend dhe se pikërisht për këtë e lëshojnë vendin. Ne si Bashkim Evropian, së bashku me qeverinë e Maqedonisë, jemi duke u munduar që të krijojmë ardhmëri për të rinjtë që të mbesin në vendin e tyre. Kjo mund të bëhet me implementimin apo realizimin e reformave, të cilat do të sjellin ndryshime të nevojshme me qëllim që t'i mbajmë njerëzit apo të rinjtë në vend dhe mendoj se kjo është shumë me rëndësi, sepse nëse ata shohin ardhmëri në vendin e vet atëherë nuk do ta ndiejnë nevojën që ta lëshojnë atë. Shpresojmë që me hapjen e mundshme të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian të rinjtë do të mund të shohin ardhmërinë e tyre përsëri në vend dhe pikërisht për këtë Bashkimi Evropian u kushton rëndësi të madhe të rinjve këtu. Vitin e kaluar përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për siguri dhe politikë të jashtme znj. Frederika Mogerini, në kuadër të vëmendjes që ne ua shprehim të rinjve, realizoi takime edhe me studentët, në të cilat u theksua se Bashkimi Evropian realizon shumë projekte për studentët dhe të



rinjtë në përgjithësi, që kanë të bëjnë me vetëpunësimin e tyre. Gjithashtu ka shumë grande të BE-së që janë për të rinjtë me qëllim që ata të mbeten në vend dhe ta shohin të ardhmen në vendin e tyre” – shtoi mes tjerash ambasadori i BE-së, z. Samuel Zhbogar. Në cilësinë e bashkëbiseduesit nga ana e nikoqirit të këtij debati, Doc. Dr. Shefik Shehu paraqiti përfitimet e shumta dhe mundësitë që Universiteti i Tetovës i ka shfrytëzuar vite me radhë, si pjesëmarrës në shumë platforma hulumtuese dhe zhvillimore të financuara nga Bashkimi Evropian. Ai mes tjerash e potencoi edhe vendosmërinë e treguar të Universitetit në ndjekjen e kursit euroatlantik, të dëshmuar në disa momente vendimtare si dhe angazhimin maksimal për zbatimin e reformave që rrjedhin nga procesi i Bolonjës e që kanë synim përafrimin me Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Ky përkushtim i Universitetit në azhurnimin e vazhdueshëm të ofertës akademike në të tri ciklet e studimeve universitare dhe jo vetëm, paraqet vetëm një nga masat e shumta në përgatitjen adekuate të të rinjve për sfidat e punësimit dhe fuqizimin e tyre në vendimmarrje si dhe aktivizim shoqëror. Ngjashëm, motivimi i studentëve ekselentë për vazhdimin e studimeve të mëtejme si dhe mundësinë e punësimit brenda komunitetit akademik ndihmon në përpjekjet tona për të parandaluar ‘ikjen e trurit’ nga vendi. Z. Shehu po ashtu vëri në dukje zbrazëtinë e kornizës ligjore që përcakton të rinjtë si një kategori e veçantë shoqërore, që dukshëm do të ndihmonte në fuqizimin dhe përfshirjen e tyre aktive në jetën shoqërore. Ekzistimi i një strategjie për të rinjtë, është vetëm një hap drejt përmirësimit të gjendjes apatike të të rinjve në shoqërinë tonë, theksoi z. Shehu.

Gjatë debatit studentët shtruan çështje nga më të ndryshmet, duke filluar nga sfidat me të cilat përballen shumë vende të rajonit në rrugëtimin drejt BE-së, si ato politike, burokratike, ekologjike, arsimore e shëndetësore. Për tejkalimin e pengesave të këtylla ambasadori foli për nevojën e seriozitetit të vendit në zbatimin e reformave, por nga ana tjetër edhe për përkushtimin dhe mbështetjen e vazhdueshme

që BE-ja duhet ta tregojë ndaj shteteve kandidate. Në këtë kontekst, profesor Shehu nënvizoi edhe rëndësinë e aktivizimit social, përfshirjes në nivel individual të të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë, e me theks të veçantë të studentëve, në të gjitha aspektet që dalin nga përpjekja e vazhdueshme e vendit për t’u bërë pjesë e familjes evropiane.

Pas takimit, ambasadori i Bashkimit Evropian në Maqedoni z. Samuel Zbogor, në një konferencë për shtyp shprehu fjalë miradije për arritjet që ka shënuar Universiteti i Tetovës pas gjithë atyre vështirësive me të cilat është përballur që nga themelimi e deri në ditët e sotme. “Jam shumë i lumtur që sot ndodhem në Tetovë, sidomos në Universitetin e Tetovës. Më duhet të them se është vizita ime e parë. Sot në mëngjes kisha një takim me Rektorin e Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, dhe mësova diçka më tepër në lidhje me historikun e Universitetit. Njeriu mund vetëm të komentojë mënyrën se si ky Universitet u zhvillua prej vitit 1994, kur ishte një Universitet ilegal dhe u rrit në një Universitet shtetëror, në një Universitet i cili sot ka një kampus të ri, ndërtesa të reja, të cilat ofrojnë kushte më të mira për vetë studentët. Po ashtu më duhet të them se kam fjalë miradije për progresin e bërë nga ana e këtij Universiteti gjatë viteve të kaluara” – tha Ambasadori i BE-së në vendin tonë z. Samuel Zhbogar. Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, e falënderoi Ambasadorin e BE-së për vizitën e tij që bëri në Universitetin e Tetovës dhe fushatën e ndërmarrë për vetëdijësimin e të rinjve rreth sfidave të Bashkimit Evropian. “Sot kishim për vizitë ekselencën e tij, z. Samuel Zhbogar, në Universitetin e Tetovës. Ne si udhëheqësi e Universitetit e njoftuam ambasadorin për të arriturat e Universitetit, historikun e Universitetit dhe peripecitë që ka kaluar institucioni ynë deri në ditët e sotme. Ky projekt që sot realizohet ndërmjet Universitetit tonë dhe Ambasadës së Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë tash më ka hapur fushatën për të vetëdijësuar opinionin e gjerë që të jenë më optimistë rreth proceseve që kalon vendi ynë dhe ne të gjithë së bashku mundemi, duhet të jemi këmbëngulës dhe shumë optimistë se edhe ne një ditë do të jemi pjesë anëtare e Bashkimit Evropian” – theksoi Rektori i UT-së Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Pas përfundimit të ligjëratës së tij, në shenjë mirënjohjeje dhe respekti për bashkëpunimin me Universitetin e Tetovës, Rektori Prof. Dr. Vullnet Ameti, ambasadorit të Bashkimit Evropian në Maqedoni, ekselencës së tij, z. Samuel Zhbogar i ndau një dhuratë me figurën e heroit tonë kombëtar Gjergj Kasriotit Skënderbeut.



UT MORI PJESË NË SIMPOZIUMIN III TË REVISTAVE SHKENCORE

7.12.2018. Nën organizim të Universitetit të Trakisë nga Republika e Turqisë dhe Asociacionit Evropian të Hulumtuesve Shkencorë, prej 4 deri më 6 dhjetor, u mbajt Simpoziumi III i revistave shkencore. Në këtë simpozium morën pjesë përfaqësues nga të gjitha universitetet evropiane, në mesin e të cilëve edhe përfaqësues nga Zyra për Hulumtime Shkencore dhe Inovacion e Universitetit të Tetovës. Këtë vit simpoziumi trajtoi temën: “Si të bëhemi autorë dhe redaktorë të suksesshëm të revistave shkencore”. Të ftuara speciale të këtij simpoziumi ishin presidentja e Asociacionit Evropian të Hulumtuesve Shkencorë, znj. Pippa Smart nga Oxfordi – Britani e

Madhe dhe Prof. Dr Ana Marushic, profesoreshë e anatomisë dhe përgjegjëse e departamentit për hulumtime në fushën e biomedicinës dhe shëndetit në Universitetin e Splitit – Kroaci, të cilat para pjesëmarrësve në këtë simpozium ndanë përvojat e tyre rreth mënyrës se si përgatitet një punim shkencor dhe cilat metoda i kanë praktikuar ato.

Ky simpozium, rëndësi të veçantë i kushtoi edhe nëntemave: Si të publikojmë në revista shkencore me impakt faktor, 10 arsyet e refuzimit dhe pranim-it të punimeve shkencore, komunikimi ndërmjet redaktorëve dhe recensentëve si dhe hapat deri te redaktimi i suksesshëm.



PRURJET E REJA PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN DHE PRAKTIKAT PEDAGOGJIKE NË KOHËN E NDRYSHIMEVE KRYESORE TË KONFERENCAVE

8.12.2018. Në Universitetin e Tetovës i filluan punimet dy konferencat shkencore ndërkombëtare. Tema boshte e Konferencës I të Fakultetit Pedagogjik ishte “Teoria dhe praktika pedagogjike në kohën e ndryshimeve” ndërsa Konferenca V e Fakultetit Filologjik këtë vit trajton temën “Prurje të reja për gjuhën, letërsinë dhe kulturën”. Në këto konferenca marrin pjesë mbi 100 studiues nga fusha e pedagogjisë, gjuhësisë dhe letërsisë.

Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, në fjalën e tij, tha se njësitë akademike të Universitetit tonë, si vatra të arsimit dhe edukimit të mijëra studentëve, me punën e tyre hulumtuese, tanimë janë kualifikuar si qendra kryesore të studimeve në fusha të ndryshme shkencore. Jemi tubuar të gjithë së bashku për t’i hapur zyrtarisht punimet e Konferencës së Pestë Shkencore të Fakultetit

Filologjik me temë “Prurje të reja për gjuhën, letërsinë dhe kulturën”, sikundër do ta zyrtarizojmë vepërimtarinë shkencore të fakultetit më të ri, Fakultetit Pedagogjik, i cili hap siparin me organizimin e Konferencës së Parë Shkencore, me temë “Teoria dhe praktika pedagogjike në kohën e ndryshimeve”. Sikurse e dimë, albanologjia, me theks të veçantë filologjia, është tërësia e studimeve që janë bërë dhe bëhen për historinë, gjuhën, folklorin dhe kulturën e popujve tanë, të cilat kanë tërhequr vëmendjen edhe të studiuesve të huaj. Ato janë bërë objekt kërkimesh dhe studimesh nga dijetarë të shquar të vendeve të ndryshme të botës. Një kontribut të veçantë për tërësinë e studimeve të lartpërmendura jep edhe Universiteti i Tetovës përmes katedrave të Fakultetit Filologjik. Rrethanat e njohura historike, politike dhe socio-kulturore në Ballkanin Perëndi-



KULTURËN, SI DHE TEORITË NDRYSHIMEVE ISHIN TEMAT E TË ORGANIZUARA NË UT

mor që kanë përjetuar popujt, kanë përcaktuar faktin që filologjia ka qenë dhe mbetet në epiqendrën e studimeve shkencore. Gjuha dhe letërsia, me gjithë sfidat e tyre, kanë vijimësi historike dhe përmes tyre kuptohen më qartë vlerat historike të kombeve, zhvillohet vetëdija e përbashkët, psikologjia dhe morali kombëtar” – tha Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Për sa i përket konferencës tjetër të Fakultetit Pedagogjik, Rektori Prof. Dr. Vullnet Ameti, deklaroi se edhe kjo është po aq e rëndësishme, sidomos për tematikën që ka paraqitur para studiuesve dhe auditorit të gjerë. “Vlerësoj se ka në fokus të programit të saj një temë të qëlluar, alternimin e teorisë dhe praktikës pedagogjike në kohën e ndryshimeve që ne i jetojmë çdo ditë. Pedagogë të njohur, pas shumë e shumë studimeve në këtë lëmë, kanë konstatuar se një nga forcat që e shtojnë individin drejt formimit intelektual, kulturor dhe social është edukatori.

Edukatori është motivim, është qelizë e konstrukcionit mendor, individual dhe social njëkohësisht. Universiteti ynë përgatit edukatorë shembullorë, që edukojnë breza të tërë dhe në këtë mënyrë i shtyn përpara proceset edukative, arsimore, shkencore dhe kulturore në vendin tonë dhe më gjerë” vlerësoi mes tjerash Rektori i UT-së, Prof. Dr. Vullnet Ameti. Dekani i Fakultetit Pedagogjik, Prof. Dr. Fadbi Osmani, tha se konferenca e fakultetit që ai drejton do të trajtojë çështjet aktuale në sferën e arsimit, të rëndësishme për ardhmërinë dhe zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi. “Qëllimi i kësaj konference, mes tjerash, është që t’i bashkojë sot dhe këtu ekspertët e rajonit, të cilët merren e i diskutojnë çështjet aktuale dhe të rëndësishme për ardhmërinë e arsimit, në zhvillimin e shoqërisë dhe individit. Në këtë drejtim, bëjmë përpjekje maksimale që të ballafaqohemi me sfidat më aktuale, edhe atë: cilat njohuri dhe shkathtësi duhet zhvilluar te nxënësit dhe studentët, të cilat do të jenë në funksion të zhvillimit të sistemit arsimor dhe shoqërisë në përgjithësi. Ne si nikoqirë të këtij tubimi shkencor dëshirojmë të hapim dhe të diskutojmë disa nga çështjet, të cilat mendojmë se do të prodhojnë dhe sigurojnë cilësi në mësimdhënien universitare dhe jo vetëm” – theksoi Prof. Dr. Fadbi Osmani.

Ndërsa koordinatorja e konferencës së Fakultetit Pedagogjik, Prof. Dr. Rabije Murati, u shpreh se vetë emërtimi i konferencës “Teoria dhe praktika pedagogjike në kohën e ndryshimeve” tregon për nevojën, relevancën dhe domosdoshmërinë e trajtimit të problemeve të ndryshme pedagogjike, arsimore me të cilat përballemi pikërisht në kohën e kërkesave të shumta për ndryshime. “Arsimi është shtylla e shoqërisë dhe kombit dhe si e tillë mund të pranojmë se ka ngecur, stagnuar dhe se nuk është në pozitën dhe vendin ku duhej të jetë. A thua kjo ngecje dhe ky stagnim është si rrjedhojë e problemeve të shumta pikërisht në këtë “shtyllë” shoqërore?

Kjo dhe shumë pyetje të tjera kërkojnë trajtime, hulumtime dhe përpunime shkencore nga ekspertë të ndryshëm. Edhe përkundër tentativave të shumta për reformim të arsimit, mund të themi se akoma nuk kemi arritur ta ndryshojmë dhe adaptojmë atë në tendencat evropiane” – shtoi mes tjerash Prof. Dr. Rabije Murati.

Sa u përket organizimeve të konferencave shkencore, Fakulteti Filologjik i Universitetit të Tetovës, përveç konferencave të rregullta shkencore ndërkombëtare, deri më tani ka organizuar edhe tri simpoziume tjera shkencore kushtuar jetës dhe veprës së Rektorit të parë historik të UT-së, Prof.

Dr. Fadil Sulejmanit, veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçit, dhe humanistes shqiptare, shenjtores Nënë Tereza. Sipas dekanit të Fakultetit Filologjik, Prof. Dr. Fatmir Sulejmani, organizimin e konferencave vjetore në nivel programesh studimore, Universiteti i Tetovës edhe pse e ka nisur para 5-6 vitesh deri më tani ka arritur të mbajë ritmin, pavarësisht të dhënës se aktivitetet e këtilla kërkojnë shumë punë dhe shumë mjete financiare, aq më tepër kur dihet se kumtesat që lexohen nëpër sesionet e konferencave shkencore botohen nëpër revistat përkatëse, duke u bërë kështu pronë kohësh dhe gjeneratash që vijnë pas nesh. “Natyrish, e gjithë kjo arrihet në sajë të përkrahjes së gjithanshme të drejtuesve të Universitetit, që synon përparimin e vazhdueshëm të procesit mësimor akademik, stimulimin e veprimtarisë hulumtuese dhe ngritjen e nivelit të vlerave të përgjithshme universitare. Falë kësaj, Fakulteti Filologjik organizon sot Konferencën e 8-të Shkencore Ndërkombëtare, në të cilën kemi ftuar studiues nga të gjitha viset shqiptare, që, sigurisht do të sjellin prurje të reja në fushën e studimeve albanologjike” -komunikoi Prof. Dr. Fatmir Sulejmani.

Koordinatori i Konferencës së Fakultetit Filologjik, Prof. Dr. Izmit Durmishi, njoftoi se gjatë punimeve të konferencës në sesionet e gjuhësisë do të trajtohen nëntemat: Gjuhësia bashkëkohore dhe trendet e reja në rrafshin krahasimtar; Gjuhësi teksti dhe përkthim, ndërsa në sesionet e letërsisë do të shtjellohen nëntemat: Pikëpamjet e reja të studimeve letrare; Simbolet mitike në letërsi etj. “Konferenca do të ketë objekt studimi dhe promovimi vlerat identitare të kombit (gjuhës, letërsisë e kulturës) dhe do të jetë zëri afirmues i UT-së këtu e më gjerë. Në sesionet e konferencës do të marrin pjesë afro 40 studiues dhe hulumtues nga disa qendra universitare nga vendi dhe jashtë, të cilët me praninë e tyre dhe temat që do të shtjellojnë, do ta çojnë përpara këtë veprimtari fisnike dhe do të nxisin te brezi i ri idenë e mendimit shkencor rreth shumë temave të pastudiuara sa duhet. Konferenca i ka vënë detyrë vetes t’i diskutojë e t’i trajtojë njëkohësisht në mënyrë të hapur, shumë çështje të gjuhës, letërsisë e kulturës që llogariten risi për mënyrën e trajtimit dhe studimit” – njoftoi Prof. Dr. Izmit Durmishi.

Në hapjen solemne të punimeve të konferencave shkencore u promovuan edhe numri i tetë i Revistës Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Filologjik, “Filologjia” dhe numri i parë i Revistës Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Pedagogjik “Edukimi”.



NË UT U MBAJT TRIBUNË 70 – VJETORIT TË DEKLARATËS PËR LIRITË DHE TË DREJTAT

10.12.2018. Me rastin e 70 – vjetorit të Deklaratës universale për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, Fakulteti Juridik i Universitetit të Tetovës, në bashkëpunim me Qendrën për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional organizoi tribunë shkencore kushtuar të drejtave të njeriut.

Dekani i Fakultetit Juridik i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Qebir Avziu, tha se vlera që ka bota demokratike është respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut. Ai bëri thirrje që sa më shumë të respektohen dhe t’u kushtohet rëndësi të drejtave dhe lirive të çdo individi. “Nëse njeriu ka bërë diçka të mirë për vetveten dhe njerëzimin, padyshim që është ligji. Asgjë më të mirë se ligji nuk ka për njeriun dhe nëse ka diçka të mirë në shtetet demokratike, atëherë ato janë konceptet për liritë dhe të drejtat themelore të



TRIBUNË SHKENCORE KUSHTUAR DEKLARATËS UNIVERSALE PËR LIRITË DHE TË DREJTAT E NJERIUT



akoma njihet dënimi me vdekje. Dua të ndaj me Ju vetëm një rast: mbi 350 persona presin që të ekzekutohen në vitin 2019. Në Kinë ky numër ndoshta është edhe më i madh, andaj nisur nga këto shifra ne të gjithëve bashkërisht na takon që të bëjmë edhe më shumë për liritë dhe të drejtat e njerëzve. Vetëm në këtë mënyrë do të arrijmë që të kontribuojmë në mbrojtjen e qytetarëve”- tha Prof. Dr. Qebir Avziu. Kryetari i Qendrës për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional, Prof. Dr. Afrim Osmani, apeloj për sensibilizim të opinionit mbi liritë dhe të drejtat që duhet t’i gëzojnë njerëzit, duke mos lejuar që ato t’u cenohen në asnjë mënyrë. “Për ne si Qendër për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional është kënaqësi që të jemi bashkorganizatorë të këtij debati kushtuar lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo ditë është më e veçantë për arsye se është edhe vit jubilar, pra 70-vjetori i Deklaratës universale për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Liritë dhe të drejtat e njeriut vazhdimisht shkelen dhe do të shkelen edhe në të ardhmen, por ne jemi ata që do ta ngremë zërin për vetëdijesim për të gjithë që paraqiten si shkelës të lirive dhe të drejtave të njeriut. Besoj se bashkëpunimi ynë në këtë drejtim do të vazhdojë edhe në të ardhmen me qëllim informimin e qytetarëve rreth këtyre tematikave që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e qytetarëve” – theksoi Prof. Dr. Afrim Osmani.

Në këtë tribunë shkencore, qëndrimet e tyre mbi të drejtat dhe liritë e njeriut i paraqitën edhe profesorët universitarë, Prof. Dr. Ali Musliu, Prof. Dr. Jusuf Zejneli, Prof. Dr. Judythanne McLauchlan nga Florida e SHBA-ve, zëvendësministri i Mbrojtjes i RM-së, Doc. Dr. Bekim Maksuti, Doc. Dr. Bujar Ameti, kryetari i Gjykatës Administrative të Maqedonisë, z. Burim Sejдини dhe anëtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Sali Murati.

njeriut, që dallon nga shtetet të cilat nuk janë këtë vit. Ne jemi dëshmitarë se më shumë se 77 shtete nuk i respektojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, ashtu siç i parashihet Deklarata universale për liritë dhe të drejtat e njerëzve. Në shumë shtete



STUDENTËT E FAKULTETIT JURIDIK TË UT- SË MORËN PJESË NË GARAT SHTETËRORE “DITËT E GJYKIMIT TË SIMULUAR”

10.12.2018. Në garat shtetërore “Ditët egjykimit të simuluar” që u mbajtën më 6 dhjetor 2018, në Fakultetin Juridik të Universitetit “Goce Dellcev” në Shtip, studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës e fituan vendin e dytë. Këto gara u organizuan me mbështetje të Ambasadës Amerikane në Shkup dhe pjesëmarrës ishin pesë universitete nga Maqedonia. Studentja Albina Beluli u shpërblye si avokatja më e mirë e garës. Paraqitja e studentëve të Fakultetit Juridik nga ana e komisionit vlerësues publikisht u vlerësua si paraqitja më e saktë dhe

originale.

Po ashtu mentorja e studentëve pjesëmarrës në garë, Prof. Dr. Arta Bilalli- Zendeli u shpreh shumë e kënaqur me mënyrën se si studentët e përfaqësuan Fakultetin Juridik si dhe Universitetin e Tetovës. Sipas saj, në gara të tilla studentore, studentët mësojnë nga praktikat gjyqësore, të cilat janë të zbatueshme në profesionin e gjyqtarit, prokurorit publik, avokatit mbrojtës etj.

Vitin e kaluar, në po të njëjtat gara, studentët e Fakultetit Juridik u vlerësuan me çmimin e parë.



NË 24 VJETORIN E THEMELIT, UT ORGANIZOI AKTIVITETE LETRARE – ARTISTIKE

13.12.2018. Në hollin e Rektoratit të Universitetit të Tetovës, sot u prezantuan ekspozitat me motive historike të artistit të njohur, Prof. Dr. Miftar Memetit. Në vazhden e aktiviteteve që realizohen për nder të 24 – vjetorit të themelimit, profesorë, studentë, dashamirë të artit dhe kulturës shqiptare, morën pjesë në shpalosjen e ekspozitave të lartpërmendura, ku të pranishëm ishin rektori bashkë me drejtuesit tjerë të Universitetit të Tetovës. Për të nderuar krijimtarinë artistike të Prof. Dr. Miftar Memetit, Rektori, Prof. Dr. Vullnet Ameti, artistit të njohur i ndau mirënjohje bashkë me logon e UT-së. Ai u shpreh se mirënjohja bashkë me logon, Prof. Dr. Miftar Memetit i jepen për kontributin e dhënë për themelimin e Universitetit të Tetovës, të arriturat për arsimin e lartë në gjuhën shqipe si dhe përkushtimin e veçantë për artin dhe kulturën shqiptare.

Ndërsa piktori, Prof. Dr. Miftar Memeti, e falënderoi Rektorin Prof. Dr. Vullnet Ameti për vlerësimin që ai dhe ky institucion u bëjnë veprave të tij. Në kuadër të kësaj veprimtarie artistike u zhvillua edhe ceremonia e ndarjes së çmimeve për esenë më të mirë, kush-tuar themelimit të Universitetit të Tetovës. Konkursi letrar u organizua nga Fakulteti Filologjik, ku me esetë e tyre aplikuan një numër i konsiderueshëm

studentësh nga të gjitha njësitë akademike.

Komisioni përkatës, në përbërje: Prof. Dr. Salajdin Salihu – kryetar, Prof. Dr. Emine Shabani – anëtare dhe Prof. Dr. Ejup Ajdini – anëtar, përzgjedhën gjashtë esetë më të arrira. Prof. Dr. Salajdin Salihu tha se komisioni gjatë vlerësimit është udhëhequr nga ndjenja e përgjegjësisë dhe profesionalizimit, duke u fokusuar te shkrimet që janë brenda zhanrit të esesë. Fituese e esesë më të mirë në këtë konkurs letrar u shpallë studentja Adelina Xhaferi nga katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe e Fakultetit Filologjik. Asaj, çmimin si fituese e vendit I, ia ndau Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Për vendin II, komisioni vlerësues zgjodhi dy esetë e studentëve, Blerona Brao nga katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe Besarta Aliji nga katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, të cilave çmimet ua ndau dekani i Fakultetit Filologjik, Prof. Dr. Fatmir Sulejmani.

Me vendin III, u shpërblyen esetë e studentëve, Emine Dervishi nga Fakulteti i Juridik, Zulkade Nuhui dhe Lulzim Selimi nga katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Për fituesit e vendit III, çmimet i ndau kryetari i komisionit, Prof. Dr. Salajdin Salihu.



UNIVERSITETI I TETOVËS E

14.12.2018. Me homazhe te varri i themeluesit, Rektorit të parë dhe historik të Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Fadil Sulejmanit, dhe busti i dëshmorit të arsimit, Abdylselam Eminit, Universiteti i Tetovës e filloi agjendën për shënimin e 24-vjetorit të themelimit. Në nderim të sakrificës së popullatës shqiptare të këtyre trevave për të pasur Universitet në gjuhën shqipe si dhe rrugëtimin e Universitetit ndër vite, që nga themelimi e deri më sot, në amfiteatrin e Rektoratit u mbajt akademi solemne, në të cilën morën pjesë rektorë dhe drejtues universitetesh, akademikë, senatorë, dekanë, profesorë, studentë si dhe shumë personalitete nga jeta politike, diplomatike, kulturore dhe shoqërore.

Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, fjalën e tij në këtë akademi e filloi me falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për të gjithë studentët, të cilët, 24 vjet më parë, me guximin shembullor dhe pa asnjë hezitim, u bënë shtylla më vitale e çerdhes së parë të arsimit të lartë shqip në këto hapësira. “Ata u bënë protagonistët, misionarët, pishtarët dhe bartësit kryesorë të platformës së Universitetit të Tetovës, të themeluar nga intelektualët shqiptarë në krye me Rektorin e parë dhe historik, Prof. Dr. Fadil Sulejmanin. Dua ta shpreh respektin tim të thellë edhe për dëshmorin e arsimit shqip, Abdylselam Eminin, gjaku i të cilit u bë dritë e diturisë në rrugën e ndërtimit të Universitetit të Tetovës. Nderim të veçantë meritojnë dhe vëllezërit



SHËNOI PËRVJETORIN XXIV TË THEMELIMIT

tanë, që i shërbyen Universitetit, duke i shndërruar shtëpitë në auditore universitare, ku u edukuan, fituan dije dhe u aftësuan profesionalisht studentët e parë të këtij institucioni. Nuk i harrojmë kurrë as përpjekjet e familjeve shqiptare, që dhanë kontribut për ngritjen në këmbë të shëndosha të Universitetit tonë. Pas 24 vjetësh punë të pandalshme, Universiteti i Tetovës është shndërruar në qendër të mirëfilltë edukimi e arsimimi, jo vetëm në Maqedoni, por edhe në rajon. Në të sot studiojnë të rinj e të reja nga vendi ynë, Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës, Lugina e Preshevës dhe nga mbarë diaspora shqiptare. Ata, bashkë me profesorët e tyre të vyeshëm, kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në proceset më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar Universiteti

i Tetovës, që nga themelimi, fillimi i ligjëratave të para e gjer te periudha pas zyrtarizimit, integritit dhe përparimit të Universitetit. Me pietet të veçantë i kujtojmë edhe kontribuesit, të cilët nuk janë më në mesin tonë, duke uruar përjetësi për veprat e tyre"-tha Rektori, Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Ai po ashtu në fjalën e tij shtoi se gjatë këtij viti akademik Universiteti ynë ka shënuar rezultate të konsiderueshme në të gjitha fushat dhe ka arritur t'i realizojë qëllimet kryesore si institucion i arsimimit sipëror në vendin tonë. "Në përfundim të vitit të shkuar akademik, me ceremoni solemne promovuam rreth një mijë absolventë të gjeneratës 2017/2018. Diplomimi i absolventëve tanë është një ngjarje e madhe në kalendarin e aktiviteteve tona,



është dëshmi e një progresi të vazhdueshëm të institucionit tonë, është dëshmi e fortë se të gjithë ne i kemi qasur me seriozitet arsimin dhe hulumtimeve shkencore. Platforma e Universitetit, oferta e pasur arsimore e shkencore, bashkëpunimi profesional, korrekt e intensiv me institucionet shtetërore, me universitetet tjera të vendit dhe jo vetëm, me sektorin joqeveritar, komunitetin e biznesit etj., e kanë shndërruar Universitetin e Tetovës në epiqendër të frekuentimit të të rinjve, të intelektualëve, shkencëtarëve dhe shkrimtarëve e poetëve të njohur brenda dhe jashtë vendit. Si rezultat i këtij imazhi, ne kemi arritur t'i plotësojmë synimet tona me afimin e studentëve të rinj, që për çdo vit regjistrohen në programet studimore të 13 fakulteteve tona. Në vitin akademik 2018/2019, në ciklin e parë, të dytë dhe ciklin e tretë kemi regjistruar rreth 3000 stu-

dentë të rinj. Kemi vijuar me mbështetjen për studentët duke u ofruar lehtësime në disa kategori pagesash, ndërsa një numër të konsiderueshëm e kemi liruar plotësisht nga detyrimet e pagesave të semestrave. Këtu vlen të theksojmë se, për vitin akademik 2018/2019, Universiteti i Tetovës ka ndarë 90 bursa për studentët ekselentë të ciklit të parë dhe 22 bursa për ata të ciklit të dytë. Gjatë këtij viti akademik kemi arritur edhe një sukses tjetër, sepse, bashkë me Universitetin e Ilinoisit Verior, e konkretizuar veprën arsimore-shkencore me hapjen e programit të ri studimor për Administrim biznesi në studimet e ciklit të dytë. Ky program studimor do të funksionojë në bashkëpunim dhe koordinim të plotë mes njësisive tona akademike: Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tetovës dhe Fakultetit të Administrim Biznesit të Universitetit të Ilinoisit Verior.



Rëndësi të posaçme i kemi kushtuar bashkëpunimit ndëruniversitar me universitetet shqiptare, universitetet nga rajoni dhe ato ndërkombëtare, duke intensifikuar marrëdhëniet ndërinstucionale me universitetet nga Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës, universitetet prestigjioze nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglisë, Austrisë, Gjermanisë, Italisë dhe nga shtetet tjera perëndimore” – u shpreh Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Në pjesën e fundit të fjalimit të tij, Rektori theks të veçantë u kushtoi edhe aktiviteteve me karakter arsimor -shkencor dhe kulturor, të cilat janë realizuar në Universitetin e Tetovës. “Gjatë këtij viti kemi organizuar dhjetëra aktivitete me karakter arsimor, shkencor dhe kulturor, siç janë: Konferenca e Pestë e Fakultetit të Kulturës Fizike; Konferenca e Katërt e Fakultetit të Shkencave të Zbatuara; Konferenca

e Dytë e Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, në të cilën me pjesëmarrjen e tij na nderoi nobelisti ynë, Doctor Honoris Causa i Universitetit të Tetovës – Prof. Dr. Ferid Murad; Kongresi Ndërkombëtar i Turizmit, Ekonomisë dhe Biznesit; Implementimi i projektit shkencor “Arritja e ruajtjes së biodiversitetit përmes krijimit dhe menaxhimit efektiv të zonave të mbrojtura dhe përfshirjes së biodiversitetit dhe planifikimit të përdorimit të tokës” nga Instituti Ekologjik; Konferenca Shkencore Ndërkombëtare në përvjetorin e 10-të të pavarësisë së Kosovës, me temë: “Konsolidimi i shtetit dhe sfidat euro-integruese”; Konferenca e Katërt e Asociacionit të Universiteteve Ballkanike, me temë: “Bashkëpunimi midis universiteteve dhe bashkëjetesa kulturore – një premisë për një platformë të qëndrueshme në të gjithë Ballkanin”, ku morën pjesë mbi 40 rektorë të universiteteve ballkanike dhe shumë studiues. Në punimet e kësaj konference u realizua edhe pranim-dorëzimi i Presidencës së Asociacionit të Universiteteve Ballkanike. Pas Universitetit të Tetovës, me presidencën e këtij Asociacioni gjatë vitit akademik 2018/19, udhëheq Universiteti “Aristoteli” nga Selaniku; Konferenca e Tretë Ndërkombëtare e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë dhe Kongresi II Mbarëshqiptar i Traumës dhe Kirurgjisë Emergjente; Konferenca e Dytë Vjetore e Qendrës për Paqe dhe Komunikim Transkulturore e mbajtur në Çikago të SHBA-ve; Seminari XII Ndërkombëtar i Albanologjisë; Organizimi i Ditës së Hapur dhe Panairit të Dytë të Industrisë Ushqimore “Food Expo 2018”; Organizimi i përbashkët i projektit artistik, “Ura me tri harqe”, me Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin e Tiranës; Hapja e ekspozitës tradicionale e studentëve të Artit Figurativ; Koncerti vjetor i studentëve të Fakultetit të Arteve; Organizimi i tribunes, me temë: “Vizioni i të rinjve për ardhmërinë në BE” me pjesëmarrjen e ambasadorit të Bashkimit Evropian në vendin tonë, z. Samuel Zhbogar; Kemi marrë pjesë në Forumin e Dytë të Rektorëve të Ballkanit Perëndimor, që u mbajt në Universitetin e Zagrebit, me ç’rast e kemi nënshkruar deklaratën për themelimin e Asociacionit të Universiteteve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor, e cila e zhvillon platformën rajonale për bashkëpunim në hulumtime dhe kërkime shkencore, me theks të



veçantë përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë në Evropën Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor. Ishim pjesë e Forumit XIII Evropian të Sigurimit të Cilësisë, i cili u organizua nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane që u mbajt në Vjenë të Austrisë; Studentët e fakulteteve të ndryshme të UT-së, me pjesëmarrjen e tyre në garat e vendit dhe më gjerë kanë fituar disa çmime duke konfirmuar kapacitetet e tyre profesionale. Jemi shumë të kënaqur edhe me performancën dhe sukseset e njëpasnjëshme të klubeve tona të volejbollit, veçanërisht me suksesin e klubit të volejbollit për femra, pjesëtarët e të cilit u shpërblyen me trofe, duke e fituar vendin e dytë në kampionatin vendor. Me rëndësi është dhe pjesëmarrja e studentit tonë, atletit Berat Mustafa, në lojërat olimpike 2018 në disiplinën e atletikës për të rinj, që u organizuan këtë vit në Buenos Aires të Argjentinës. Me akademi solemne i kemi shënuar disa prej datave kryesore, sikurse janë: 7 Marsi – Dita e Mësuesit; 9 Maji – Dita e Evropës; 22 Nëntori – Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe; 28 Nëntori – Dita e Flamurit dhe e Pavarësisë së Shqipërisë, Ditën Botërore të Librit, Ditën Ndërkombëtare të Person-

ave me Nevoja të Veçanta, 70 – Vjetorin e Deklaratës Universale për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, Ditën Botërore të Diabetit, shënimin e Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut, përmes hapjes së ekspozitës së 50 artistëve shqiptarë të udhëhequr nga Prof. Dr. Miftar Memeti, duke mos harruar edhe realizimin e dhjetëra debateve arsimore, botimin e revistave shkencore të fakulteteve tona, botimin dhe promovimin e librave, sikurse janë: Vëllimi VI, VII dhe VIII i veprës kapitale „Kosova“, të shkrimtarit dhe historianit të njohur Jusuf Buxhovi; “Fjalori politik i Berishës ‘90 – ‘92” i autorit na Shqipëria Alfred Lela; “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, i autorit, akademik Kolec Topalli; Promovimin e 12 numrave të revistës letrare të Tiranës „Illz”, kushtuar personaliteteve të letërsisë shqipe, si: Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Ismail Kadare, Luan Starova, Teki Dervishi, Zija Çela, Xhevahir Spahiu, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu; Promovimin e revistës studentore “Përtej”, të botuar nga Parlamenti Studentor i Universitetit tonë; Ridizajnimin e ueb – faqes zyrtare të Universitetit tonë. Vëmendje të posaçme i kemi kushtuar bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes sonë në

projektet dhe programet arsimore ndërkombëtare, si: Erasmus + MEVLANA, FULBRIGHT. Nëpërmjet tyre ne realizojmë: Shkëmbimin dhe mobilitetin e studentëve dhe profesorëve tanë si dhe vizitingun e profesorëve eminentë në Universitetin tonë; Zgjerimin e bashkëpunimit me 5 rrjete te reja në kuadër të programit Ceepus III, i cili parashikon: Hulumtimin, zhvillimin dhe edukimin në proceset jokonvencionale”; Përfitim të njohurive dhe shkëmbimin e përvojës në CFD; Njohjen me kufijtë dhe pikat kufitare në antropologjinë kulturore në arsimin universitar; Studimin ekologjik dhe menaxhimin e ekosistemeve ujore në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore; Evaluimin e brendshëm dhe të jashtëm nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane dhe shumë e shumë veprimtari të tjera. Andaj Ne, të gjithë së bashku – studentë dhe profesorë, hapërojmë të sigurt drejt të ardhmes me vendosmërinë dhe vizionin që këtë vatër të dritës dhe diturisë ta shndërrojmë në Universitet bashkëkohor, në qendër model të arsimit të lartë, këtu dhe më gjerë”, e përmbylli fjalimin e tij Rektori i Universitetit të Tetovës Prof. Dr. Vullnet Ameti.

Ndërsa ministri i Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë, Doc. Dr. Arbër Ademi, vlerësoi se sa herë që Universiteti i Tetovës shënon përvjetorë, ne shqiptarët e këtyre trevave shënojmë edhe fillimin e realizimit të idesë për të pasur një institucion të arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë. “Sot e shënojmë sakrificën e gjithë atyre familjeve shqiptare dhe gjithë qytetarëve të vendit për të pasur një institucion siç është UT-ja dhe çka përfaqëson ajo sot. Dua të shpreh mirënjohjen dhe përlujen tonë të thellë për të gjithë ata të cilët kontribuuan në konsolidimin e këtij Universiteti, duke shprehur falënderime për të gjithë ata profesorë nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, të cilët kanë dhënë kontribut të çmueshëm duke respektuar të gjitha standardet profesionale që ky Universitet të punojë dhe të funksionojë ashtu siç duhet në përputhje me kornizën e atëhershme dhe të sotme juridike e ligjore. Unë si ministër i Arsimit dhe Shkencës e mbështes dhe sa herë që të jetë nevoja do ta mbështes Universitetin e Tetovës dhe shpresoj se sikur që ditë më parë prezantuar bashkë programin e ri studimor me një

nga universitetet më prestigjioze amerikane edhe në të ardhmen të kemi projekte të këtilla, të cilat do jenë në interes të studentëve dhe qytetarëve tanë” – deklaroi Doc. Dr. Arbër Ademi, ministër i Arsimit dhe Shkencës në vendin tonë.

Në emër të Kuvendit të Maqedonisë, akademinë e përshëndeti nënkryetari, Prof. Dr. Vesel Memedi, i cili theksoi se çdo universitet botëror e ka historinë e vet, mirëpo Universiteti i Tetovës e ka tërësisht një histori tjetër. “Rrallë mund të gesh institucion akademik, shkencor në botë që e ka ndërtuar populli dhe ky popull ka dhënë sakrificë, ka ndarë bukën e gojës për këtë vatër të shenjtë arsimore dhe është dhënë edhe jetë, për krijimin, ndërtimin dhe zhvillimin e kësaj vatre të shenjtë arsimore. Misioni fillëstar i këtij institucioni ka qenë të zhvillojë mësimin dhe dijen në gjuhën shqipe dhe ky mision tani më është realizuar dhe jo vetëm që ka arritur këtë qëllim, por sot ky institucion e ka hapur rrugën për krijimin e shumë universiteteve tjera shtetërore e private që zhvillojnë mësim në gjuhën shqipe” nënvizoi në fjalën e tij, Prof. Dr. Vesel Memedi, nënkryetar i Kuvendit.

Kurse në emër të kryeministrit të Maqedonisë, në këtë akademi solemne fjalë përshëndetëse mbajti këshilltari i tij, z. Ismet Ramadani. “Më lejoni që në emër të kryeministrit të Republikës së Maqedonisë z. Zoran Zaev, që nuk është sot prezent për shkak të agjendës dhe angazhimeve që ka gjatë këtyre ditëve, t’ju përshëndes dhe t’ju uroj për shënimin e përvjetorit të njëzetekatërt të Universitetit të Tetovës. Kryeministri z. Zoran Zaev gjithmonë është interesuar edhe për Universitetin e Tetovës. Me admirim dhe kënaqësi i përcjell sukseset e Universitetit të Tetovës dhe në të shumtën e rasteve e merr si shembull se si Universiteti i Tetovës bashkëpunon jo vetëm me universitetet nga vendi, por edhe ato ndërkombëtare, dhe ky duhet të jetë një shembull se si edhe Republika e Maqedonisë duhet të ndjekë rrugën e integritit drejt anëtarësimit në Unionin Evropian dhe Aleancën Veri-Atlantike të NATO – së” – theksoi këshilltari i kryeministrit të Maqedonisë z. Ismet Ramadani.

Kjo akademi u begatua edhe me një program të pasur artistik të përgatitur nga profesorët e Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës.



UT-JA E SHËNOI 50 VJETORIN E DEMONSTRATAVE TË FLAMURIT TË VITIT 1968

23.12.2018. Në nderim të sakrificës, vuajtjeve dhe rezistencës së veprimtarëve shqiptarë në vendin tonë e më gjerë, në shenjë përkujtimi për veprën patriotike të organizatorëve dhe pjesëmarrësve të demonstratave të flamurit të vitit 1968 në Tetovë, Universiteti i Tetovës në vitin jubilar, 50 – vjetorin e tyre, sot e organizoi Simpoziumin shkencor, me temë: “1968-ta, sfidë e identitetit kombëtar të shqiptarëve në Maqedoni”.

Në hapjen zyrtare të punimeve të simpoziumit, Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve tha se të marrësh pjesë në këtë ngjarje historike është privilegj, aq më tepër kur mes nesh janë të pranishëm personalitete të dëshmuara që kanë ardhur nga të gjitha trojet tona etnike për shënimin e kësaj date të rëndësishme kushtuar 50-vjetorit të demonstratave të flamurit në Tetovë.

Dekani i Fakultetit Filozofik i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Ibish Kadriu, demonstratat e Tetovës të



cilat shpërthyen me 22 dhjetor të vitit 1968, i vlerësoi si një prej ngjarjeve më të shënuara të rezistencës së shqiptarëve, të cilat ishin në mbrojtje të flamurit kombëtar nga dhunimi që e kishin kurdisur dhe provokuar shovinistët sllavo-maqedonas.

Koordinatori i këtij simpoziumi shkencor, Prof. Dr. Musa Musai, tha se ky eveniment me karakter shkencor – përkujtimor, organizohet mbi aurorën e



një kontributi të një plejade njerëzish që kanë sakrifikuar për kombin shqiptar.

Referatin tematik kushtuar demonstratave të vitit 1968 e paraqiti profesori Fadil Lushi, i cili këto demonstrata i karakterizoi me katër palë histori.

Në këtë aktivitet, Prof. Dr. Zeqirija Rexhepi e lexoi telegram – urimin e Organizatës Panshqiptare “Va-tra”.

Për nder të veprimtarisë kombëtare, Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti ndau disa dhurata me portretin e themeluesit – Rektorit të parë e historik të UT-së, Prof. Dr. Fadil Sulejmanit, për veprimtarët, Fadil Lushin, Shpëtim Pollozhanin, Hydajet Hysenin dhe Çun Lajçin. Po ashtu, Rektori,

me rastin e shënimit të 50-vjetorit të demonstratave të flamurit, pjesëmarrësve dhe organizatorëve u ndau mirënjohje për kontributin kombëtar në organizimin dhe përkrahjen e demonstratave të vitit 1968 në Tetovë.

Hapja solemne e këtij simpoziumi u përmbyll me një recital nga artisti i popullit, Çun Lajçi dhe interpretimi i këngës “Fryn murrilani me stuhi” nga studentët e Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës. Në këtë veprimtari shkencore, morën pjesë studiues të njohur nga vendi ynë, Republika e Kosovës, Republika e Shqipërisë dhe nga trevat tjera etnike shqiptare.

UNIVERSITETI I TETOVËS E PUBLIKOI PLATFORMËN ONLINE STUDENTORE “KUJDESI PËR TY”

28.12.2018. Në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë mësimore – shkencore, forcimit të lirisë akademike, transparencës institucionale, artikulimit të të gjitha nevojave, kërkesave dhe shqetësimeve të ndryshme, Universiteti i Tetovës, sot e publikoi platformën online studentore “Kujdesi për ty”. (<https://kujdesiperty.unite-services.com>)

Platforma është zyrtarizuar në përputhje me kodeksin etik të Universitetit të Tetovës si dhe Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve në Republikën e Maqedonisë.

Drejtuesit e Universitetit të Tetovës thonë se përmes funksionalizimit të platformës “Kujdesi për ty” kemi për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e mirëqenies së procesit mësimor-shkencor, mbrojtjen e të gjithë të përfshirëve në veprimtarinë e Universitetit (studentëve, stafit akademik, stafit administrativ dhe teknik) si dhe sigurimin dhe avancimin e cilësisë në Universitet, duke ofruar mundësi për paraqitjen e dukurive problematike, të cilat mund të jenë hetuar



në mjedisin e Universitetit ose janë në lidhshmëri me aktivitetet që realizohen në Universitet.

“Kujdesi për ty” do të trajtojë vetëm çështjet që lidhen me studentët, stafin akademik, stafin administrativ dhe stafin teknik të Universitetit të Tetovës.

Udhëheqësia e Universitetit është përkushtuar në forcimin e këtij institucioni të arsimit të lartë në gjuhën shqipe, i ka shërbyer dhe do t'i shërbejë vazhdimisht interesit studentor, edukimit të tyre dhe përparimit shoqëror.



UT I NDAU INDEKSAT PËR GJENERATËN E KATËRT TË DOKTORANTËVE

28.12.2018. Me një ceremoni solemne, sot Rektori i Universitetit të Tetovës, Prof. Dr. Vullnet Ameti, ua ndau indeksat doktorantëve të gjeneratës së katërt të vitit akademik 2018/2019, të cilët do t'i ndjekin studimet e ciklit të tretë në fakultetet e UT-së.

Përgjegjësi i Zyrës për Studime të Doktoraturës, Doc. Dr. Kushtrim Ahmeti, para doktorantëve bëri prezantimin e strukturës së programeve studimore, duke i njoftuar ata me obligimet që i presin gjatë semestrave të studimeve.

Ai shtoi se organizimi i studimeve të doktoratës, që nga fillimi e deri më tani, në nivel universiteti siguron kualitet të lartë, konkurs të përbashkët me kritere të unifikuara pranimit dhe procedurë administrative dhe cilësi të unifikuar.

Sipas tij, studimet organizohen në përputhje me standardet evropiane për arsim të lartë dhe sigurimin e cilësisë, gjithnjë duke pasur në konsideratë komunikatën e Berlinit të vitit 2003, në të cilën thuhet: “Studimet e doktoraturës janë kontribut i univer-



siteteve për të zhvilluar një shoqëri të bazuar në dije” dhe komunikatën e Bergenit të vitit 2005, sipas së cilës: “Pjesëmarrësit në ciklin e tretë të studimeve jo vetëm që janë studentë, por janë edhe hulumtues të rinj shkencorë dhe urë lidhëse mes edukimit dhe hulumtimit shkencor”.

KLUBI I VOLEBOL



UNIVERSITET

LIT PËR FEMRA



TI I TETOVËS

UNIVERSITETI YNË ARDHMËRIA JONË

